

**TITULLI I DISERTACIONIT:
VLERËSIMI I PROCESIT TË RIINTEGRIMIT DHE I
NEVOJAVE SPECIFIKE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKUARA
NË SHQIPËRI**

Emri Mbiemri i doktorantit : Alisa Biçoku

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Antropologji-Sociologji, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Aleksandër Dhima

Numri i fjalëve: 50,065

Tetor 2015, Tiranë

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

Tema: “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”

Studimi “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” **synon** të dëshmojë sesa i rëndësishëm në thelb është procesi i riintegritit. Një proces ky i gjatë e kompleks. I gjatë, sepse duhet shumë kohë punë direkte me vajzën e trafikuar që të arrijë të përshtatet me ambientin ku do të jetojë. Por edhe kompleks, pasi, pasojat që lë ky fenomen tek vajzat e trafikuar nuk mund të rikuperohen lehtë.

Studimi **përpiqet të nxjerrë në pah** efikasitetin e politikave të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve sociale nga vendi ynë për përmirësimin e kushteve të jetesës së vajzave të trafikuar. Në qendër të këtij studimi janë vendosur ofruesit e shërbimeve, vajzat e trafikuar që janë në proces riintegriti si dhe ato që janë riintegruar në shoqëri.

Qëllimi i këtij studimi është kuptimi e analizimi i përvojave, emocioneve, vështirësive sociale e ekonomike që u duhen vajzave të trafikuar për t’u përballur gjatë procesit të riintegritit në shoqëri.

Objektivi specifik i këtij studimi është :

- Eksplorimi i burimeve, mundësive, sistemeve dhe strukturave mbështetëse që mund të ndihmojnë për një riintegrit të suksesshëm të vajzave të trafikuar në Shqipëri
- Rëndësia e procesit të riintegritit dhe faktorët që ndikojnë në realizimin me sukses të këtij procesi në jetën shoqërore të viktimave të trafikimit
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për vajzat viktime trafikimi për të patur një riintegrit të suksesshëm si dhe analizimi i sfidave në këtij procesi.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo cilësore, si një metodë efektive që ofron një informacion sa më të detajuar e specifik si dhe një kuptim të thelluar në eksplorimin e subjekteve. Instrumentat që u përdorën janë fokus-grupet me ofruesit e shërbimeve (me përfaqësuesit e institucioneve joqeveritare), intervistat gjysëm të

strukturuara me grupin e synuar, si dhe informacioni ekzistues që i referohet të dhënave të kryera nga institucionet përkatëse, të cilat trajtojnë problemet e vajzave të trafikuar.

Nga analiza e të dhënave kemi dalë në përfundimin se janë një sërë faktorësh të cilët kushtëzojnë që një vajzë e trafikuar të riintegrohet suksesshëm në shoqëri. Fillimisht duhet të hartohen politika sociale për t'u ardhur në ndihmë viktimave të trafikut, duke nisur që me punësimin, meqenëse ai konsiderohet si një nga faktorët parësorë të një riintegrimi të suksesshëm. Pushteti qendror/ lokal duhet të ndihmojë viktimat për strehimin e tyre falas ose, minimumi, të reduktojë kostot e shtëpive të tyre. Të zbatohen ligjet, strategjia kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore ndaj trafikanteve.

Studimi dëshmon se, në qoftëse vajzat VeT kanë një banesë të sigurt, një punësim të përshtatshëm, arsimim dhe formim profesional, mbështetjen nga familja dhe shoqëria, ato kanë premisa më të mëdha për ta realizuar me sukses procesin e riintegrit. Aspekti ekonomik dhe ai social mbeten dy komponentë shumë të rëndësishëm të riintegrit të viktimave të trafikuar në shoqërinë tonë.

"Evaluation of the reintegration process and the specific needs of trafficked victims in Albania"

The study "Assessment of the reintegration process and the specific needs of trafficked victims in Albania" intends to testify how important is the process of reintegration basically. A process that is lengthy and complex. It is a long process because it should take a lot of time on directing work with the girl trafficked to arrive adapting of surrounding environment where they live. It is complex because the consequences that this phenomenon leaves to trafficked women can not be recovered easy.

The study tries to bring the effectiveness of policies followed by the providers of social services from our country to improve the living conditions of trafficked girls. At the center of the study are setting the service providers, trafficked girls who are in the process of reintegration, and those who are reintegrated into society.

The aim of this study is to analyze the meaning of experiences, emotions, social difficulties, economic, that needs to face trafficked women during reintegration into society.

The specific objective of this study is:

- Exploration of resources, opportunities, support systems and structures that can help a successful reintegration of trafficked women in Albania.
- Importance that have for trafficked victims, this complex process and difficult in social life.
- Improvement of provided services to a successful reintegration as well as to analyze the challenges in the reintegration process

The methodology used in this study is that qualitative, as an efficient method that offers more detailed and specific information and a deep understanding of subjects explored. The instruments that were used are focus groups with service of providers (with representatives of non-government institutions) and semi-structured interviews with the target group, as well as existing information that refers to data that are performed by the relevant institutions, which address the problems of trafficked girls.

From the data analysis it is concluded that there are several factors that influence a trafficked girl to successfully reintegrate into society should first design social policies to help trafficked victims, related to employment. Given that it is considered as the primary factors to a successful reintegration. The central / local level should help to accommodate their victims free or at least to reduce their housing costs. It should be applied locally, national strategy against trafficking in human beings from traffickers. The study shows that if VeT girls have a safe house, suitable employment, education and professional formation, support from family and friends they have more premises to achieve successful reintegration process. Economic and social aspects still remain that are important components of reintegration of victims trafficked in our society.

Këtë dizertacion ia kushtoj babait tim,

Arian Biçoku!

FALENDERIME

Studimi “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” nuk do të ishte i plotë pa falenderuar të gjithë personat që me kontributin e tyre ndihmuan në realizimin e tij. Falënderimi im shkon për të gjitha vajzat (viktima trafiku) , të cilat pranuan të ndanin problemet e jetës së tyre, eksperiencat personale, si dhe problematikën që shoqëron jetën e tyre të vështirë.

Gjithashtu dëshiroj të falënderoj në veçanti udhëheqësin shkencor të këtij punimi, Prof. Dr. **Aleksandër DHIMA**, i cili ka mbështetur dhe inkurajuar në mënyrë të vazhdueshme realizimin e këtij kërkimi. Udhëzimet, rekomandimet dhe sugjerimet e tij e kanë ndjekur hap pas hapi këtë studim në përpjekje për ta bërë atë sa më gjithëpërfshirës dhe për t’ia drejtuar një publiku sa më të gjerë.

Mirënjohje dhe për koleget e mia të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Elbasan, të cilat kanë dhënë një ndihmë të pakushtëzuar për realizimin e disa hapave profesionalë të këtij punimi dhe më kanë lehtësuar, duke mbështetur punën time në këtë proces.

Mirënjohja ime personale është për mikeshat e mia, specialiste në fushën e shërbimeve sociale, Alketa ALLA dhe Arjola PROGNI, të cilat më kanë mbështetur në çdo hap të këtij punimi shkencor.

U jam shumë mirënjohëse dhe të gjithë përfaqësuesve e drejtuesve të organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime të drejtëpërdrejta për viktimat e trafikuar, përfaqësuesve të Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror në Elbasan, të cilët dhanë kontributin e tyre, duke u përfshirë në këtë studim dhe duke dhënë informacione të gjera për realizimin e tij në mënyrë sa më të plotë.

Një falënderim të veçantë për familjen time, bashkëshortin e djalin tim Brajan, i cili, me durimin e një të rrituri ka tejkaluar mungesën e herëpashershme të vëmendjes, kur prindi i tij binte në kurthet e shkencës.

Faleminderit!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....13

Kapitulli I: Panorama historike e trafikimit në Shqipëri e në rrafsh botëror.

1.1.Një panoramë historike botërore e trafikimit të qënieve njerëzore.....	17
1.2.Trafikimi në Shqipëri, një vështrim historik.....	25
1.3.Trafikimi i qënieve njerëzore dhe kuadri ligjor.....	27
1.3.1.Evoluimi i legjisllacionit shqiptar mbi fenomenin e trafikimit.....	27
1.3.2.Legjisllacioni shqipëtar kundër trafikimit të qënieve njerëzore.....	29
1.3.3.Kuadri ligjor e përmirësimet në polici.....	34
1.4.Modelet e asistencës që ofrohen për VeT	36
1.4.1.Shërbimet rezidenciale	37
1.4.2.Shërbimet jorezidenciale	45
1.4.3.Institucionet qeveritare e masat e marra për VeT.....	46
1.4.4.Institucionet për riintegrimin e masat e marra për VeT.....	50
1.5.Praktikat më të mira të vendeve të tjera në lidhje me viktimat e trafikimit.....	50
1.5.1.Shërbimet riintegruese.....	52

Kapitulli II: Metodologjia e kërkimit

2.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	55
2.2.Hipoteza dhe pyetjet kërkimore	56
2.3.Hartimi i kërkimit.....	56
2.4.Procesi i realizimit të studimit.....	57
2.5.Metoda kërkimore e përdorur	61
2.6.Përdorimi i metodës cilësore në studim.....	65
2.7.Popullatat e përfshirë në studim dhe kampioni i përzgjedhur	66
2.8.Shtrirja në hapësirë e studimit	68

2.9.Kriteret e përzgjedhjes së të intervistuarve.....	69
2.10.Vështirësitë e studimit	71
2.11.Kampionimi	71
2.12.Numri i intervistave	73
2.13. Hartimi i instrumentave të kërkimit	74
2.14.Hartimi i intervistës së focus grupit.....	77
2.15.Intrumenti mates.....	82
2.16.Mbledhja dhe analiza e të dhënave.....	82
2.17.Analiza e të dhënave	89
2.18.Kufizimet e kërkimit	97

Kapitulli III: Sfidat e hasura nga ofruesit e shërbimeve dhe faktorët që ndikojnë në procesin e riintegrit të viktimave të trafikimit

3.1. Perspektiva e ofruesve të shërbimeve mbi procesin e riintegrit.....	98
3.1.1 Mungesa e mbështetjes së vajzave të trafikuar nga familja e origjinës.....	99
3.1.2 Arsimiti, formimi profesional e punësimi i vajzave të trafikimit	100
3.1.3 Mungesa e mbështetjes nga Institucionet Shtetërore në procesin e riintegrit të viktimave të trafikimit	102
3.1.4 Përputhshmëria e shërbimeve të ofruara me nevojat specifike të viktimave të trafikimit	104
3.1.4 Mbrojtja ligjore e viktimave të trafikimit.....	105
3.1.5 Trajtimi i rasteve të vështira të viktimave të trafikimit.....	106
3.1.6 Qëndrueshmëria në financimin e strehëzave për viktimat e trafikimit.....	109

Kapitulli IV: Faktorët që ndikojnë në riintegritin e viktimave të trafikimit si dhe sfidat e hasura gjatë realizimit të këtij procesi

4.1. Të dhënat e nxjerra nga intervistat me viktimat e trafikimit	110
4.2.Informacioni rreth gjeneraliteteve të viktimave të trafikimit	112

4.3.Faktorët që ndikojnë në një riintegrim të suksesshem të viktimave të trafikimit në Shqipëri	115
4.3.1.Punësimi, situata ekonomike e profesionale e viktimave të trafikimit.....	120
4.3.2. Strehimi i sigurt dhe i përshtatshëm i viktimave të trafikimit.....	124
4.3.3 Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore të viktimave të trafikimit.....	128
4.3.4 Mirëqënia psikologjike e fizike e viktimave të trafikimit.....	132
4.3.5 Siguria e viktimave të trafikimit.....	133
4.3.6 Edukimi dhe zhvillimi profesional i viktimave te trafikimit.....	135
4.3.6. Përceptimi për një riintegrim të suksesshëm	136

Kapitulli V : Diskutime

5.1 Diskutime	137
---------------------	-----

Kapitulli VI : Përfundime e Rekomandime

6.1 Përfundime.....	143
6.2 Rekomandime	136

Shtojca	151
----------------------	-----

Bibliografia	160
---------------------------	-----

AKRONIMET

1. MB Ministria e Brendshme
2. MKR Mekanizmi Kombëtar i Referimit
3. AP Autoriteti Përgjegjës
4. ZKKA Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik
5. VeT Viktimë e Trafikimit
6. MPCSSHB Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
7. USAID Agjensia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-së
8. OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
9. ILO Organizata Ndërkombetare e Punës
10. IOM Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
11. D&E Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”
12. TV Organizata “Tjetër Vizion”
13. OJF Organizatë Jofitimprurëse
14. KVKTNJ Nisma Shqipëtare: Koordinimi i Veprimeve Kundër Trafikimit Njerëzor
15. TIMS Sistemi i Manaxhimit Total të Informacionit – Një bazë e integruar të dhënash për policinë e Shtetit

HYRJE

Trafikimi është një fenomen me të cilin Shqipërisë i është dashur të ndeshet që në vitet e para të tranzicionit. Pozicioni gjeografik i vendit tonë është tepër i favorshëm për t'u përdorur nga trafikantët si burim origjine për trafikimin e qenieve njerëzore e si kalim tranzit nga vende të tjera. Ne do të kujtojmë gjithmonë vitet e tmerrshme '90-'91 të nisjes së një tregtie të re, asaj të mishit të bardhë.

Ndryshimet politike të regjimit të asaj kohe spikatën individë apo grupe individësh që kërkonin të pasuroheshin në mënyra dhe forma të paligjshme, duke rekrutuar, trafikuar e shfrytëzuar vajza, gra e fëmijë në mënyra nga më çnjerëzore. Fenomeni i shfrytëzimit të femrave për industrinë e seksit mori përmasa gjigande dhe kjo edhe për shkak të mosfunksionimit të një shteti ligjor, i cili nuk po arrinte të kontrollonte “rrugët e tregëtisë” e të mbronte të drejtat e këtyre viktimave. Trafikimi i vajzave ishte biznesi më i madh dhe fitimprurës për njerëz e grupe kriminale të pamëshirshëm dhe ordinerë.

Përballë këtij realiteti të hidhur të shoqërisë shqipëtare dhe këtij fenomeni degradues për shoqërinë, e cila pretendon të arrijë standartet europiane. organizatat jofitimprurëse, me shërbimin e strehëzave ju bashkangjiten nismës së Qeverisë për zbatimin e strategjisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Pritja e viktimave të para në strehëz shënon vitet 2002-2003. Viktimat priteshin në qendër për një periudhë të përkohshme, duke siguruar kështu pritjen e parë pas riatdhesimit. Më pas u paraqit nevoja e nisjes së një programi me ndërhyrje më afatgjatë, ku viktimat të mund të asistoheshin dhe monitoroheshin për një periudhë afatgjate akomodimi. Edhe në ditët e sotme Shqipëria vazhdon ende të konsiderohet si vend origjine për trafikimin e grave për qëllime të shfrytëzimit seksual.

Këto të dhëna na serviren nga tre strehëza që ofrojnë shërbime rezidenciale për viktimat e trafikut dhe që janë aktualisht anëtare të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik. Këtu përfshihen:

1. Qendra Psiko-sociale “Vatra” që ndodhet në qytetin e Vlorës
2. Organizata “Të ndryshëm & Të barabartë” që ndodhet në qytetin e Tiranës
3. Qendra “Tjetër Vizion” që ndodhet në qytetin e Elbasanit

Këto janë strehëza që ofrojnë shërbime rezidenciale për vajza viktimë trafiku.

Po t'i referohemi studimet të bëra rreth fenomenin të trafikimit të qënieve njerëzore dhe procesit të riintegrit, vihen re se studimet janë te pakta. Studimi i parë në Shqipëri, që trajton fenomenin e trafikimit është: "Trafikimi, Rasti i Shqipërisë" (Lekë Sokoli, Ilir Gërdeshi;2006) ku në këtë studim kombëtar jepet një pasqyrë e të gjithë komponentëve që ndikojnë në trafikimin e vajzave. Studimi paraqet në mënyrë të detajuar faktorët social-ekonomik që kanë ndikuar që një vajzë të bëhet pjesë e procesit të trafikimit, shkaqet e pasojat e këtij fenomenit, si dhe mënyrat e trafikimit. Në këtë studim pasqyrohen disa nga format që përdornin personat trafikantë , sic ishin premtime për martesë apo martesë e rreme ku në këtë mënyrë kanë patur edhe bashkëpunimin e viktimave për të kaluar kufirin. Studimi deshmon se trafikantët në shumicën e rasteve ishin persona të njohur si bashkëshorti, familjarët, fqinji, i fejuari etj.

Të dhënat më të shumta për trafikimin e qënieve njerëzore vijnë nga pesë strehëzat të cilat bëjnë pjesë në Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik :

- 1."Të ndryshëm & Të barabartë"
- 2."Tjetër Vizion
- 3.Qendra psiko-sociale " Vatra"
4. "Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit"
- 5.Qendra komunitare "Jetë dhe Shpresë".

Çdo strehëz trajton raste të ndryshme brenda saj dhe në bazë të rasteve të trajtuara nxjerrin të dhëna të cilat i raportojnë tek Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, në bazën e të dhënave të krijuara nga ZKKA për regjistrimin e rasteve të viktimave të kthyer të trafikimit, të referuara e të mbrojtura në Shqipëri. Informacioni që mblidhet nga rastet e vajzave të trafikuar është i larmishëm.

Sipas Raportit Vlerësues të CAHHT "Situata e përpjekjeve në Shqipëri për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore 2007-2008" dalin në dritë disa faktorë të cilët i pengojnë institucionet në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të vajzave të trafikuar. Sipas

raporteve të nxjerra nga strehëzat rezulton se në muajt gusht-nëntor numri i viktimave të trafikimit është më i lartë kjo vjen si pasoje e lëvizjeve të individëve në vende të ndryshme. Në këtë raport përmenden një mori faktorësh sic janë: mungesa e të dhënave nga autoritetet e vendeve dërguese apo të ambasadës shqipëtare në këto vende, pamjaftueshmëria kohore për të bërë një identifikim të saktë, mungesa e punonjësvë socialë në pikat kufitare apo të punonjëseve femra të policisë për të marrë në intervistë viktimat në ambiente të përshtatshme.

Nga një raport të USAID në vitin 2008, vihet re një rritje e trafikimit të brendshëm. Në këtë raport konstatohet se rreth 27% e viktimave të cilat trajtoheshin në katër strehëzat e koalicionit janë trafikuar brenda vendit. Nga analiza e një pyetësi të bërë nga qendra "Vatra" (Tetor 2008) të realizuar në qarkun e Vlorës rezultoi se 87% e të rinjve e pranojnë ekzistencën e fenomenit, 79% prej tyre e pranojnë që vajza dhe gra shfrytëzohen për prostitucion në vend, 57% prej tyre njihnin raste konkrete, 50% dinin hotelet dhe motelet që shfrytëzohen për këtë punë, dhe 33% prej tyre mendojnë që për ushtrimin e prostitucionit përdoren edhe shtëpitë e marra me qera nga grupe vajzash e grash, të ardhura nga zonat rurale ose qytete të tjera më të vogla, si dhe 69% e të intervistuarve kishin pranuar që grup-mosha më e prekur është 15-20 vjeç dhe gjithashtu vetëm 33% prej tyre kanë pranuar që edhe grup-mosha 21-25 vjeç ishte e përfshirë në prostitucion.

“Studimi mbi riintegrimin social-ekonomik të viktimave të trafikimit në Shqipëri” (Të ndryshëm e të barabartë; 2009) bën një prezantim të detajuar të komponentëve kryesor të këtij procesi të kushtueshem. Ky studim nxjerrë në pah, koston që procesi i riintegrit mbart në vetvete, duke marrë si shembull viktimat që kalojnë në fazat e këtij procesi.

Përvec raporteve vjetore që strehëzat raportojnë çdo fundviti në Ministrinë e Brendshme. Këto raporte lidhen kryesisht me numrin e identifikimit të viktimave të trafikimit; me numrin e Vet që asistohen në strehëza; më numrin e Vet që largohen nga shërbimi i strehëzave, me numrin e Vet që identifikohen nga institucioni i policisë si raste riciklimi.

Studimi i fundit “Beyond trafficking, The re/ integration of trafficking victims in Balkans 2007 to 2014” (Rebecca.Surtees; Korrik 2015) na jep një panoramë të detajuar të fenomenit

të trafikimit në Ballkan nga viti 2007-2014. Studuesja nxjerr në pah rëndësinë e ofruesve të shërbimeve për vajzat Vet. Studiuesja dëshmon rastet e VeT që janë asistuar në strehëzat “Vatra”; “Të Ndryshëm e të Barabartë” e “Tjetër Vizion” përgjatë viteve 2007-2014, rastet e Vet të pajisura me kurse profesionale ndër vite, programet e shërbimit që i janë ofruar. Një element i rëndësishëm i këtij studimi mbetet mungesa e bashkëpunimit që ekziston midis institucionve shtetërore në Ballkan me OJF në identifikimin e viktimave të trafikimit.

Në Shqipëri ende nuk janë realizuar studime me fokus ofruesit e shërbimeve dhe viktimat e trafikuar në proces riintegrimi e të riintegruara. Ndaj punimi ynë paraqet një përpjekje modeste për të sjellë kontribute në këtë fushë. Studimi do të analizojë sfidat me të cilat përballen vajzat Vet gjatë procesit të riintegrimin në Shqipëri.

Ky punim është një dritare për të gjithë studiuesit e fushës, lidhur me analizimin e kuadrit ligjor, dimensioneve të mbështetjes sociale dhe aktorëve të ndryshëm që veprojnë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në vendin tonë, duke ofruar për herë të parë një tablo gjithëpërfshirëse të evoluimit të procesit të riintegrimin deri në ditët e sotme.

Studimi është ndër kërkimet e pakta, i cili përpiqet të nxjerrë në pah efikasitetin e politikave të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve sociale nga vendi ynë, për përmirësimin e kushteve të jetesës së vajzave të trafikuar. Ndërsa studimet e mëparshme janë përqendruar në raportimin e raporteve që organizatat nxjerrin në lidhje me numrin e asistimit të viktimave të trafikuar në qendra, me sasinë e kurseve profesionale që u ofrohen, me moshën e tyre, nivelin e edukimit, etj. Ndërsa ky punim raporton dhe teston faktorë rreziku të tjerë, të tillë si riciklimi i VeT në jetën shoqërore. Përveç këtyre arritjeve, për herë të parë studimi ynë nxori në pah opinionet e pjesëmarrësve lidhur me procesin e riintegrimin dhe sfidave me të cilat përballen VeT.

➤ KAPITULLI I

1.1 NJË PANORAMË HISTORIKE BOTËRORE E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJEREZORE

Shfrytëzimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore është shndërruar sot në një fenomen global. Shoqëria në botë e ka njohur këtë fenomen përgjatë gjithë kohërave. Po ta shohim nga një vështrim historik, trafikimi ka ekzistuar që nga shoqëria e lashtë greke , romakët e Mesjetës dhe deri në ditët tona. Në bazë të periudhës kohore në të cilën qenia njerëzore ka jetuar, edhe trafikimi ka qenë i përshtatur dhe i zhvilluar në bazë të emancipimit të shoqërisë njerëzore në ato periudha.

Trafikimi i qenieve njerëzore në periudha të ndryshme kohore të zhvillimit të tij është shfaqur në periudhat më të hershme të zhvillimit historik, siç është lindja dhe zhvillimi i skllavërisë, tregëtia me skllavër. (Mandro A. 2011, shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi i personave për shërbime të tjera etj.) Periudha më e hershme e trafikimit të qenieve njerëzore ka filluar me skllavërinë prandaj dhe historiku i trafikimit fillon duke analizuar dhe kuptuar skllavërinë dhe tregtinë me skllavër.

Pika kyçe që çoi në zhvillimin e tregtisë me skllavër (Tolstoj. L.N, 2010) ishte vetë skllavëria e përkufizuar si mohimi i të drejtave bazë të njeriut. Tregëtia e skllavëve ka ekzistuar që në kohët e lashta (Leskoviku M., 2006) dhe ka arritur deri në ditët e sotme. Periudha e zhvillimit më të madh të tregtisë së skllavëve lidhet me periudhën e lashtësisë ku në të cilën tregtia e skllavëve ka qenë më e përhapur. Zhvillimi i saj, si në lashtësi, ashtu edhe në periudha të tjera kohore, ka në themel të tyre përfitimet që u solli kjo tregti . Skllavërit shiheshin vetëm si objekte dhe në mënyrë të tillë edhe trajtoheshin. Kjo u hiqte atyre një sërë të drejtash, ku parësore ishte mohimi i së drejtës për të qenë i lirë (Sokoli. L; Gerdeshi. I. 2006) . Skllavëve nuk u njihej asnjë e drejtë, prandaj ata shiteshin dhe bliheshin njësoj si një objekt apo sende të ndryshme. Kjo llojë tregtie ka qenë e përhapur më shumë nga shekulli XV-XIX (Mandro A. 2011) . Zanafillina e tregtisë me skllavërit nisi me krijimin e perandrive, siç ishte perandoria e Romës, viti 753 ^(p.e.s) deri në shek.II ^(p.e.s). Po t'i referohemi periudhave më të hershme, termi "skllav" nuk ka pas ekzistuar, por

kjo dukuri është shfaqur nga luftërat që kanë ndodhur dhe nga trofetë e fituara në to. Këto kanë ndikuar në rritjen e numrit të skllavëve dhe në zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë me ta.

Personave që ishin kthyer në skllavë nuk u njihej asnjë e drejtë por ata konsideroheshin si sende që vetëm flasin, por ishin të varur komplet nga e drejta që u jepte pronari apo i ashtuquajtur "padroni".

Në këtë periudhë skllavërit (Mandro A. 2011) ndaheshin në disa kategori:

1. Fëmijët e lindur nga një nënë skllave, pra nga një person jo i lirë. (Mandro A. 2011)
2. Robërit e luftës, të gjithë ata persona që kanë humbur betejën në luftë dhe ktheheshin në robër, të cilët përbënin numrin më të madh të skllavëve. (Mandro A. 2011)
3. Personat që shkelnin një ligj dhe që i përkisnin një komuniteti të huaj, pra ishin ata persona të cilët nuk ishin romakë por, nëse bënin një shkelje në Romë, ktheheshin në skllavë (Mandro A. 2011)
4. Personat të cilët ishin romakë por ktheheshin në skllavë për shkak të marrjes së borxheve dhe mos shlyerjes së tyre. (Mandro A. 2011)
5. Personat të cilët humbisnin në frontin e luftës, ktheheshin në skllavë. (Mandro A. 2011)
6. Në skllavë ktheheshin edhe ata persona të cilët nuk pranonin të regjistroheshin në regjistrat e popullsisë. (Mandro A. 2011)

Romakët e kthyer në skllavë nuk qëndronin në Romë por shiteshin tek pronarët e huaj, sepse, një romak i kthyer në skllav nuk mund të qëndronte në Romë. Periudha e lashtësisë është kulmi i skllavërisë dhe ata përdreshin për punë të ndryshme. Përfitimet nga ky sistem ishin monetare. Përgjatë viteve, një dukuri që ka ndikuar në tregëtimin njerëzor (Mill. J, 2011) është edhe prostitucioni.

Trafikimi dhe prostitucioni janë dy fenomene të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin që duhen trajtuar së bashku. Prostitucioni ndikon në trafikim por jo si trafikim i mirëfilltë (Mill. J,

2011). Femrat skllave nuk përdoreshin vetëm për punë të ndryshme por ato përdoreshin nga padronët e tyre edhe për shërbime seksuale, karshi edhe personave të tjerë që paguanin për to. Nga kjo na rezulton se fenomeni i prostitucionit ka ekzistuar që herët. Ai është një sjellje shoqërore e kryer në kundërshtim me rregullat e çdo lloj shoqërie, si ato morale ashtu dhe etike.

Fjala "prostitucion" e ka origjinën nga gjuha latine dhe në shqipë do të thotë "çoje në rrugë të keqe", pra, me këtë kuptohet dhënia e nderit për qëllime fitimi. Kjo vlen jo vetëm për atë që e ushtron, por edhe për ata që e organizojnë e që e përfitojnë si shërbim. (Sokoli. L; Gerdeshi. I. 2006). Fenomeni i prostitucionit është cilësuar si zakon dhe është shfaqur që në periudhat e lashta. Por në disa shoqëri prostitucioni kishte veshje normale dhe prezantohej si situatë normale, si në Greqi e Kinë ku shoqëria i detyronte vajzat e reja të pamartuara, si një formë zakonore e të sjellurit, të kryenin marrëdhënie seksuale me miqtë që vinin për vizitë, si një mënyrë për të nderuar praninë e tyre dhe kjo konsiderohet si një nga format e prostitucionit. (Sokoli. L; Gerdeshi. I. 2006) Te kjo lloj forme e prostitucionit futej edhe "e drejta e natës së parë", e cila përfaqësonte të drejtën që ka pronari apo feudali që të provonte çdo grua që martohej me një bujkrob. Këtë mënyrë e hasim edhe në kohën e lashtësisë dhe konsiderohej si ritual religjioz. Me kalimin e kohës këto lloj sjelljesh (Mill. J. Stuart. 2011) sidomos me evoluimin e rilindjes, patën një stepje të tyre, sepse filluan të konsideroheshin si të pamoralshme. Më i përhapur ishte prostitucioni profesional, i cili zhvillohet edhe në ditët e sotme, ndërsa në kohët e lashta përfaqësohej nga shtëpitë publike.

Prostitucionin në jetën e përditshme e etiketojmë më fjalën "zanati më i vjetër në botë", i cili është një fenomen negativ dhe ka njohur zhvillim në të gjitha kohërat. Ai është një prej fenomeneve të shfrytëzimit seksual të gruas, ku trupi i saj shndërrohet në një send shitblerjeje, pra bëhet objekt tregtimi shërbimi i ofruar. Në shumicën e rasteve më të shfrytëzuara janë femrat nga shtresa sociale të ulëta. Ato që zakonisht përfundojnë si prostituta vijnë nga kjo shtresë. Këto femra e ushtrojnë këtë profesion sepse kanë alternativa të pakta ose nuk kanë asnjë alternativë tjetër që të mbijetojnë apo të realizojnë të ardhurat jetësore për veten e tyre, fëmijët apo familjarët dhe këto femra shihen me urrejtje

nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Prostitucioni është një dukuri e përhapur në të gjithë shoqëritë e botës, madje, fatkeqësisht konsiderohet edhe si normale. Kjo vlen për ato shoqëri të cilat e kanë legalizuar ushtrimin e këtij profesioni. Mënyrat për të ushtruar këtë profesion janë dy: të vullnetshme dhe ajo e dhunshme, ku më e përhapur është mënyra me dhunë por, në disa raste, njihet edhe e para.

Format e prostitucionit që ka njohur shoqëria njerëzore janë :

1. Tregëtia me femra për shkaqe seksuale

Femrat bliheshin në rrugë të ligjshme dhe jo të ligjme, sidomos në vendet e zhvilluara, nga persona të pasur. Para disa viteve numri më i madh i tyre sigurohej nga Azia dhe Amerika Latine, dërs a kohët e fundit ky fenomen është zhvilluar edhe në vendet postkomuniste, ku femrat më të shitura janë nga ish vendet socialiste (Mill. J. Stuart. 2011) të Evropës Lindore, ku përfshihet edhe Shqipëria.

2. Prostitucioni në shtëpitë legale publike

Kjo lloj veprimtarie është e ligjëruar dhe i nënshtrohet një kontrolli nga institucionet qeveritare. Femrat që dëshirojnë të merren me këtë profesion e ushtrojnë atë vullnetarisht, kundrejt një pagese dhe kjo njihet si veprimtari në formë legale. Kjo lloj veprimtarie kryhet në objekte të përcaktuara dhe është më e përhapur në qendra të mëdha botërore të biznesit, për arsye përfitimi. Ky lloj shërbimi bashkëpunon dhe me paketat turistike, ku një hotel, përveç ofertës turistike, ka të alternuar dhe këtë shërbim. (Mill. J. Stuart. 2011)

3. Prostitucioni ushtarak

Kjo formë prostitucioni është e përhapur më së shumti në zona të ndyshme të konflikteve ndërkombëtare. Bëhet si shërbim me pagesë për kënaqjen e dëshirave seksuale të ushtarëve. (Mill. J. Stuart. 2011)

Duke qenë se trafikimi i qënieve njerëzore është shndërruar në një fenomen global, kjo ka bërë që të vihen në lëvizje organizma të ndryshëm ndërkombëtar, si OKB-ja, të cilat

kanë vepruar duke hartuar konventa antitrafikim për t'u ratifikuar edhe nga shtete të tjera. SHBA-të publikojnë vazhdimisht, nëpërmjet Departamentit të Shtetit, raportet vjetore mbi trafikimin e qënieve njerëzore. Trafikimi zhvillohet në disa forma ku më i përhapuri dhe më i studiuar është trafikimi për qëllime shfrytëzimi seksual.

Shumica e autorëve e konsiderojnë tregun e grave si biznes global. Në *Globalized Female Slavery* më shumë se 4 milionë gra janë shitur si skllave të seksit (Eilson.O, 2000). Vlerësime të shumta të bëra nga OKB-ja tregojnë se vetëm në SHBA hyjnë çdo vit mbi 50 mijë gra të shitura. SHBA-të nuk janë, siç pohojnë studiuesit, vendi me përmasat më të larta të grave dhe vajzave të trafikuar. Izraeli, sipas tyre, ka ritme më të larta të trafikimit të grave. Në një libër të botuar nga Instituti izraelit "Toda'ah", thuhet se mbi 4 milion gra dhe vajza i shtohen çdo vit botës së prostitucionit. Afërsisht 1/5 e tyre hyjnë në tregun e prostitucionit të SHBA-ve dhe, të paktën 3 mijë në atë të Izraelit, të ardhura nga Ukraina, Shqipëria, Filipinet, Tailanda, Meksika dhe Nigeria. Por, nëse krahasojmë popullsinë e SHBA-ve me popullsinë e Izraelit, vijon libri i Toda'ah, del se përmasat e problemit në Izrael janë 2.5 herë më të mëdha se në SHBA. Të tjera femra të trafikuar vijnë nga Kina, Malejzia, Indonezia, Korea e Jugut, Kolumbia, Vietnam, etj, dhe shiten në Australi e vende të tjera për shfrytëzim seksual dhe pornografi.

Sipas studiuesve, trafiku i grave për shfrytëzim seksual është shndërruar në një biznes me përfitime të larta multi-bilion dollarësh. Gratë trafikohen prej vendit të origjinës, për në vendet e destinuar të viktimave të trafikimit dhe përmes vendit të tranzitimit, me qëllimin e vetëm për t'u skllavëruar.

Trafikimi është një tregti e cila konsiderohet më fitimprurësja dhe më pak e rrezikshme, krahasuar me tregun e drogës apo të armëve ku vlera e "mallit seks" arrin deri në 12 bilion dollarë në vit. (Sokoli. L; Gerdeshi. I. 2006) Parabërësit kanë arritur të krijojnë rrjete transnacionale të trafikantëve e tutorëve, të cilët mashtrojnë femrat duke u premtuar atyre punë dhe një të ardhme më të mirë dhe kështu që vajzat bien pre e trafikimit të tyre. Ky lloj rrjeti kërcënon si mirëqenien dhe statusin social të grav,e ashtu edhe mirëqenien e stabilitetin social, politik dhe ekonomik të vendeve ku ata zhvillojnë aktivitetin e tyre .

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem i mprehtë edhe për vendet Evropiane ku, sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), llogariten mbi 2.45 milion njerëz të trafikuar dhe përqindjen më të lartë e zënë gratë dhe fëmijët. (Këshilli i Evropës, Konventa mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Tiranë, 2006). Rusia paraqitet si vendi më problematik për sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo sepse Rusia ende nuk ka një ligj kundër trafikimit. (Bush-Putin,2003). Trafikimi i qenieve njerëzore është një realitet i hidhur për të gjitha vendet Evropiane (Drobler, 1991). Për këtë, shumë organizata si ato të grave apo të të drejtave të njeriut, kanë kërkuar legalizimin e prostitucionit në të gjithë Komunitetin Evropian. (Komiteti i Grave të Parlamentit Evropian, për shëmbull, u ka kërkuar shteteve anëtare që të dekriminalizojnë prostitucionin, duke nënvizuar që “realiteti i zymtë në të cilin punojnë prostitutat, në kushtet e prostitucionit ilegal apo gjysëm legal, inkurajojnë abuzimet, si shtrëngimi e detyrimi, degradimi i kësaj veprimtarie si punë, kushtet e vështira të jetesës së prostitutave, keqtrajtimet, dhunimet deri vrasjet e tyre ”(*Nursing Times ‘Into Europe’ Oct. 24, 1990*). Sipas tyre, kjo do të çonte në uljen e trafikimit dhe “punonjësit e seksit “ nuk do të jenë më të diskriminuar e do të kenë të drejtën e vetvendosjes apo të drejtën private për t’u përfshirë ose jo në prostitucion. Por edhe në vendet ku është legalizuar prostitucioni, si p.sh Hollanda, Gjermania etj, numri i të trafikuarve është mjaft i lartë. Sipas Këshillit të Evropës, 43% e njerëzve trafikohen për shfrytëzim seksual dhe 32% e tyre përfundojnë në punë të papaguara, në punë të paligjshme, nëpër ferma, punishte, shtëpi private etj. Sipas Këshillit të Evropës, trafikimi i qenieve njerëzore është i lidhur ngushtë edhe me krimin e organizuar, prandaj ai duhet të luftohet me të njëjtin intensitet si fenomeni i drogës apo pastrami i parave. Trafikimi i qenieve njerëzore është i përhapur edhe në Ballkan. Vendet e Ballkanit janë vendet e origjinës të tranzitimit të të trafikuarve. Pra, janë vende të destinacionit të trafikimit. Një formë tjetër e trafikimit që zhvillohet në këto vende është dhe trafikimi i brendshëm.

Siç e përmenda edhe më sipër, trafikimi i qenieve njerëzore ka qenë dhe mbetet një plagë e hapur e shoqërisë. Ai konsiderohet problem social (Horton B. Paul, Leslie R. Gerald, Larson F. Larson. 1991). sepse:

1. Ka prekur një numër të konsiderueshëm personash

2. Është bërë i papranueshëm nga shoqëria
3. Kundrejt këtij fenomeni mund të reagohet në forma të ndryshme
4. Forma kryesore e reagimit është veprimi kolektiv i organizuar

Sipas studiuesve socialë, këto përfaqësojnë katër kriteret që një problem të quhet "social" (Horton B. Paul, Leslie R. Gerald, Larson F. Larson. 1991). Nga krahasimi që mund t'i bëjmë këtij përkufizimi të problemeve sociale me atë të trafikimit, del se trafikimi i qënieve njerëzore nuk ka qënë gjithmonë problem social në periudha kohore të ndryshme. Gjatë periudhave kohore të histories, në disa raste, të ishe skllav, për shembull, ishe "njesoj normal" si të ishe pronar skllavësh. Fenomeni i trafikimit është konsideruar si problem social në kohën e shembjes së sistemit skllavo-pronar dhe më tej e hasim në fazat e qytetërimit të iluminizmit, sidomos me daljen në skenë të shtetit të së drejtës, ku zbatohet ligji dhe rendi .

Reagimet e para ndaj trafikimit që morën tiparet e një veprimi kolektiv të organizuar ishin gjatë shekullit të XX, kjo sepse në atë periudhë kemi krijimin e institucioneve ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës, BE dhe OKB-ja. (Në fakt Shqipëria, për shembull, ka aderuar në Konventën Ndërkombëtare për zhdukjen e tregtisë së grave e të fëmijëve, para Luftës së Dytë Botërore, qysh në tetor të vitit 1937)

Shfrytëzimi seksual është më i zakonshmi dhe më i studiuar nga format e trafikimit të qënieve njerëzore. Kjo sepse prej tij mund të nxjerrim përfundime mbi trafikimin në përgjithësi. Studiues të ndryshëm e studiojnë dukurinë e prostitucionit për të nxjerrë përfundime rreth mënyrave të rekrutimit të grave dhe vajzave përgjatë gjithë historisë së njerëzimit. Studiuesit që kanë shkruajtur për historinë e Romës, për shembull, me shkëlqimin dhe rënien e saj, (Robinson,1963; Monteskie, 2004 etj) kanë folur dhe e kanë trajtuar skllavërimin e grave me terma e aspekte të veçanta të trafikimit. (Beard & Henderson, 1997; Fantham, 1975; Houser, 1998 ; Brown, 1990 e 1993; Bagnall, 1962; Edëards, 1997;) Dukuria e prostitucionit mbetet më e studiuar nga pikëpamja antike greke. (Beard & Henderson, 1997; Fantham, 1975; Houser, 1998 ; Brown, 1990 e 1993; Bagnall,

1962; Edwards, 1997;)

Studiuesit socialë kanë argumentuar se lindja e prostitucionit lidhet drejtpërdrejtë edhe me skllavërimin e grave për shfrytëzim seksual, së pari lidhet me përmbysjen e raporteve midis burrave dhe grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amëtare në të drejtën atërore. Sipas Engels (1974) ky hap shënoi disfatën e madhe historike të seksit femëror. Gruaja humbi kështu pozitën e vet të respektuar e u kthye në shërbëtoare, në skllave të epsheve të burrit. Kjo pozitë poshtëruese e gruas shfaqet më shumë te grekët, p.sh. tek Homeri robinat bëheshin viktima të epsheve të fitimtarëve. Këtë situatë e shikojmë edhe në epokën "viktoriane" (Montesjè. Sh .2004) në Angli, ku studiuesit (Judith R. Walkowitz,1983) studiojë përmasat që kishte marrë prostitucioni në këtë periudhë e i krahasojnë me ato të Babilonisë. Ata e vënë theksin në faktin se viktimat e para të prostitucionit ishin vajzat e rrëmbyera, çka me terminologjinë e sotme nënkuptohen vajzat e trafikuar.

Nga kryerja e marrëdhënieve të pambrojtura seksuale me partnerë të ndryshëm, prostitutat ishin të infektuara nga sifilizi ende pa mbushur moshën 18-vjeç (Rush 1980). Qëndrat publike të kësaj kohe ishin kthyer në qendra dhunimi dhe trafikimi për femrat. Edhe në ditët e sotme gjenden gjurmët e trafikimit të minoreneve të epokës viktoriane. Një nga format më të shpeshta dhe më të qarta të trafikimit është ai i fëmijëve, sepse është moshë delikate dhe nuk janë në gjendje e nuk dinë ende të vendosin për jetën e tyre. P.sh. vlen të përmendet se, nga 2600 prostituta të arrestuara në Paris, 1500 ishin minorene (Bebel, cituar nga Rush). Epoka viktoriane njihet si periudha më e bujshme e viktimave të trafikimit, sidomos të shfrytësimit në mënyrë më çnjerëzore të fëmijëve, pasojat e të cilave i shohim edhe në ditët e sotme.

1.2. TRAFIKIMI NË SHQIPËRI, NJË VËSHTRIM HISTORIK

Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri është një fenomen i cili nuk konsiderohet si tipik shqiptar, kjo për faktin se, nga studime që janë bërë nga studiues të ndryshëm, ka rezultuar se trafikimi në vendin tonë për qëllime prostitucioni apo forma të tjera të tij, nuk i ka rrënjët në historinë shqiptare. Duke qenë se shoqëria jonë është një shoqëri patriarkale dhe tradicionale, ajo karakterizohet nga disa faktorë që kanë ndikuar në mospërhapjen e prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Ndër këto faktorë evidentojnë :

- zakonet dhe traditat tona shqiptare
- mënyra e jetesës në shoqërinë tonë
- pozita e dobët dhe e ulët e gruas në shoqërinë shqiptare

Po të krahasojmë vendin tonë me vëndet fqinje apo dhe ato të Europës, dalim në përfundimin se ky fenomen nuk ka qenë i përhapur dhe i zhvilluar aq sa ka qenë në këto vënde. Ky fakt bazohet tek librat e historisë së Shqipërisë, në folklor apo edhe në ato libra të cilët flasin për zakonet dhe traditat shqiptare. Meqë vendi ynë ka qenë një udhëkryq historik e gjeografik, (Leskoviku M. 2006) është bërë "pre" e kësaj plage që lëndon dhe shkatërron të drejtat dhe parimet e shoqërisë. Meqënëse Shqipëria ka një pozitë gjeografike të favorshme, ka tërhequr pushtues të vendeve të tjera, së bashku me kulturat e tyre të ndryshme, si greke, italiane, gjermane, austro-hungareze, sllavo-bullgare, turke, etj.

Një shembull që e pasqyron këtë është rruga "Egnatia" me historinë e saj, e cila përshkon Shqipërinë. Në këtë rrugë ka pasur motele dhe "hane" ku ofroresh seksi si shërbim. (Sokoli L.; Gerdeshi I. 2006)

Në këto "hane" prostitucionin e kanë ushtruar kryesisht vajzat jetime dhe prostitutat vullnetare. Por edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore ka ekzistuar një shtëpi publike në Tiranë, e cila ndodhej në zonën e Zogut të Zi. Nuk vërtetohet se trafikimi i vajzave të ketë ekzistuar në gjysmën e parë të shek XX, kohë në të cilën vërtetohet përhapja e prostitucionit në

Shqipëri, madje dhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944) (fletorja zyrtare, nr.30, gusht 1922.), në atë kohë e vlerësuar si masë për ruajtjen e shëndetit dhe moralit publik.

Nga dokumentat arkivore (Sokoli, Lekë.2006a "Babai dhe vajza e trafikuar", 2006; "Integrimi dhe morali tradicional") del se në Shqipërinë e kësaj periudhe vajzat e ushtronin profesionin e punonjësës së seksit me dëshirën dhe "vullnetin" e tyre të lirë (Sokoli, Lekë. 2006 "Trafikimi, rasti i Shqipërisë").

Edhe gjatë kohës së komunizmit (Alia, Ramiz. 1986) prostitucioni ka ekzistuar por ushtrohej në mënyrë të fshehtë për shkak të dënimeve të rënda që jepeshin në atë kohë por, gjithsesi, është zhvilluar në shkallë të ulët në krahasim me vendet e tjera të botës. Megjithëse Shqipëria ka qenë e pushtuar dhe ka jetuar me pushtuesit e saj nga shumë vende me kultura të ndryshme, ajo ka ruajtur gjuhën, zakonet, kodin moral të saj, por edhe ndikimi i kulturave pushtuese është i pamohueshëm .

Vajzat shqiptare që trafikoheshin, në atë kohë dërgoheshin edhe si dhuratë nga trafikantët e tyre në haremet e Stambollit. Shqipëria për këtë fenomen ka aderuar në 1937 në konventën ndërkombëtare për zhdukjen e tregtisë së grave dhe fëmijëve. Karakteristikë kryesore që e dallon këtë periudhë me ditët e sotme, është se lëvizja e prostitutave, të cilat në pjesën më të madhe ishin vullnetare, bëhej nga jashtë-brenda. Por, me ardhjen e sistemit komunist në Shqipëri, (Leskoviku M., 2006 Punim i cituar) i erdhi fundi ushtrimit të këtij profesioni të krijuar deri në atë periudhë.

Një gjë tjetër që e shikojmë në këtë kohë është se ky sistem nuk e lejoi fare trafikimin e grave dhe adoleshentëve, përgjithësisht e ndaloi trafikimin e qenieve njerëzore. Regjimi komunist e ndaloi trafikimin e qenieve njerëzore pa pasur një ligj të shkruar për këtë. Ishin pikërisht vitet '90-'91 kur në Shqipëri u hap një tregë i ri, ai i trafikimit të qenieve njerëzore. Ndryshimet politike pas regjimit patën një impakt të dukshëm mbi vlerat e shoqërisë, duke sjellë etje të madhe për para. Kishte nga ata persona që kërkonin të pasuroheshin përmes formave të paligjshme, (edhe pse shteti shqipëtar në atë kohë nuk kishte një kuadër ligjor antitrafik) duke trafikuar, rekrutuar, shfrytëzuar vajza e gra në mënyre ç'njerëzore. Fenomeni i shfrytëzimit të vajzave në industrinë e seksit mori përmasa galopante për shkak të një shteti mosekzistues në jo pak raste, i cili nuk arrinte të

kontrollonte rrugët e “tregtisë” apo të mbronte të drejtat e vajzave që trafikoheshin jashtë territorit Shqiptar. Edhe në ditët e sotme ky fenomen është shqetësues për shoqërinë shqiptare dhe duhet akoma shumë punë dhe bashkëpunim midis organizmave të shtetit për reduktimin sadopak të këtij fenomeni me përmasa të mëdha.

1.3.TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE DHE KUADRI LIGJOR

1.3.1 Evoluimi i legjislacionit shqiptar mbi fenomenin e trafikimit

Gjatë viteve 90-91 në Shqipëri u hap një treg i ri, ai i trafikimit të qenieve njerëzore. Ndryshimet politike pas regjimit, patën një impakt të dukshëm mbi vlerat e shoqërisë duke sjellë etje të madhe për para .Kishte nga ata persona që kërkonin të pasuroheshin përmes formave të paligjshme (edhe pse shteti Shqiptar në atë kohë nuk kishte një kuadër ligjor antitrafik) duke trafikuar, rekrutuar, shfrytëzuar vajza, gra në mënyre c`njerëzore. Fenomeni i shfrytëzimit të vajzave në industrinë e seksit mori përmasa galopante për shkak kjo të një shteti shqiptar (mos ekzistues) I cili nuk arrinte të kontrollonte rrugët e “tregtisë” apo të mbronte të drejtat e vajzave që trafikoheshin jashtë territorit Shqiptar.

Vetëm në vitin 1995 u miratua ligji i parë (Nr. 7895, datë 27.01.1995) mbi trafikimin në shtetin shqiptar.

Vetëm pas vitit 2000 Shqipëria fillon të ndërmarrë ligje e instrumenta të luftës dhe parandalimit kundër trafikimit në njerëz. Në vitin 2001, me iniciativën e qeverisë shqiptare është përpiluar strategjia e parë e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e cila përfshinte aktorë nga qeveria lokale e nga organizata të ndryshme jofitimprurëse. Gradualisht, në këtë mënyrë forcimi i legjislacionit shqiptar bëri që fenomeni i trafikimit të reduktohej, por jo të eliminohej plotësisht. Por edhe pas këtyre masave, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore ka ndryshuar vrullshëm, duke u kthyer në këta vitet e fundit në më i padukshëm e më i organizuar. Për herë të parë trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar si krim në Kodin Penal të Shqipërisë, duke vendosur dispozita të veçanta me Ligjin Nr. 8733, viti 2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë

27.01.1995, Kodi Penal i Shqipërisë” ku, pas nenit 110, u shtua neni 110/a, “Trafikimi i njerëzve”. Po me këtë ligj, pas nenit 114, u shtua neni 114/a, “Trafikimi i femrave për prostitucion”. Po në këtë periudhë (vitit 2001) trafikimi filloi të pranohej si një plagë e shoqërisë dhe shteti shqiptar filloi ta godiste seriozisht këtë fenomen, nëpërmjet zbatimit të reformës ligjore, duke përfshirë në kodin penal dispozita ligjore të cilat parashikonin dënime shumë të ashpra ndaj këtij fenomeni. Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar që krijoi bazën për të luftuar Trafikimin e Njerëzve, është Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional si dhe dy protokollet e saj shtesë të ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8920, dt. 11.07.2002. Me ndryshimet e ligjit nr. 9188, datë 12.02.2004, në Kodin Penal janë parashikuar 3 nene për trafikimin. (Nenet 110/a, “Trafikimi i personave”; 114/b, Trafikimi i femrave” dhe neni 128/b, “Trafikimit i të miturve”).

Për të qenë në përputhje të plotë me Protokollin e Palermos, me Ligjin Nr. 9188, datë 12.2.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Shqipërisë i ndryshuar”, neni 110/a u ndryshua si më poshtë (Ky ndryshim është bërë në përputhje të plotë me Nenin 3 të Protokollit të Palermos, i cili përkufizon si vijon):

“Trafikim personash” nënkupton rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”

Elementët e Trafikimit të Personave sipas përkufizimit të Protokollit të Palermos, ndahen në 3 grupe:

- **Veprimi (aktiviteti, procesi):** rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave

- **Mjetet:** kërcënimi, përdorimi i forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vunerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve

- **Format e shfrytëzimit:** shfrytëzimi seksual, për punë ose shërbime të detyruara, skllavëria ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqja e organeve ose servitutet

1.3.2. LEGJISLACIONI SHQIPTAR KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJEREZORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përbën ligjin më të lartë në hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Ajo sanksionon disa të drejta në parandalimin dhe mbrojtjen e qenieve njerëzore nga fenomeni i trafikimit.

Neni 3 i Kushtetutës sanksionon se “..., dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij,...janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojtë”.

Në Kushtetutë disa dispozita sanksionojnë garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe mbrojtjen nga dhuna: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 15, pika 1) ; “Jeta e personit mbrohet me ligj” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 21); “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 25) .

Kushtetuta sanksionon se, askujt nuk mund ti hiqet liria, përveç se në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (neni 27).

Në kushtet e rrëmbimit, shfrytëzimit të torturave, si elementë të një veprë të rrezikshme për shoqërinë, e cila është e përafërt me fenomenin e trafikimit, paraqet rëndësi për garantimin e të drejtës për të qenë i lirë.

Gjithashtu, neni 26 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e individit për të mos kryer punë të detyruar (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8417, datë 21.10.1998, Neni 26): “Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve”

Ky sanksionim ka një rëndësi të vecantë për sa kohë që shfrytëzimi për punë të detyruar është një element i trafikimit të vajzave e grave për qëllime prostitucioni.

Një dispozitë kuptimplote e Kushtetutës është ajo që sanksionon se fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 52) Ky sanksion ka një rëndësi të madhe sepse, në pjesën më të madhe të rasteve, vajzat e gratë e trafikuar janë shoqëruar me dhunë fizike e psikologjike.

Ligjet

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Shteti shqiptar ka bërë ndryshime legislative në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore në Kodin Penal të vitit 1995, me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001. Ndryshime janë bërë edhe me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, në kuadrin e përjasjes së legjislacionit të brendshëm me Protokollin e Palermos.

Me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, u shtua neni 110/a, “Trafikimi i njerëzve”. Nevoja që shtronte realiteti social dhe ratifikimi i Protokollit të Palermos “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve”, në plotësim të konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, bënë të domosdoshme amendimin e Kodit Penal. Me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, ligjvënësi përkufizoi më qartë veprat penale të trafikimit të qënieve njerëzore

dhe parashikoi si figura të veçanta të veprës penale trafikimin e personave (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 110/a, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, neni 1), trafikimin e femrave (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 114/b, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, neni 2) dhe trafikimin e të miturve (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 128/b, ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004, neni 3).

Ligjvënësit u bënë më të ndjeshëm nda mbrojtjes së veçantë të grave e vajzave, duke parashikuar me dispozita të veçanta trafikimin e tyre por edhe masa më të larta dënimi për autorët. (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 128/b, ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004, neni 3)

Kodi i Procedures Penale

(Kodi i Procedures Penale i RSH-së, Ligji nr.7905, datë 21.3.1995, ndryshuar me Ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002 dhe Ligjin nr.9276, datë 16.09.2004)

Kodi i Procedures Penale i RSH-së specifikon dy kategori të viktimave të veprave penale:

A. Personi i dëmtuar nga vepra penale

B. Personi i dëmtuar nga vepra penale si i dëmtuar akuzues

Viktima mund të ngrejë padi kundër dhunuesit duke iu drejtuar gjykatës, kur ndaj saj është ushtruar dhunë duke e kategorizuar si një vepër penale. Kodi i Procedurës Penale i RSH-së parashikon të drejtat e të dëmtuarit akuzues. Ai përcakton llojin e veprave penale. Veprat penale të parashikuara nga kjo dispozitë janë: rrahja, neni 90 i Kodit Penal, plagosja e rëndë nga pakujdesia, neni 91 i Kodit Penal, plagosja e lehtë nga pakujdesia, neni 92 i K. Penal , dhunimi i banesës, neni 112 i K. Penal, fyerja, neni 119 i K.Penal, shpifja, neni 120 i K. Penal, ndërhyrje të pa drejta në jetën private, neni 121 i K. Penal, përhapja e sekreteve vetjake, neni 122 i K. Penal, mosdhënia e mjeteve për jetesë, neni 125 i K. Penal, marrja e pa drejtë e fëmijës, neni 127 i K. Penal, botimi i veprës së tjetrit në emër të vet, neni 148 i K. Penal, riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit, neni 149 i K. Penal, dhe shkatërrimi i

pronës me mjete të tjera, neni 254 i K. Penal) Për këto i dëmtuari akuzues ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërsëdrejti në gjykatë. (Neni 58, Neni 59)

Në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale (H. Islami, A. Hoxha, Ilir Panda, 2003,) konkludohet se vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të gjitha veprat e tjera penale që lidhen me këtë fenomen, ndiqen nga organi i procedurës dhe nuk mund të ndiqen me ankim në gjykatë.

Për rrjedhojë, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit vetëm përmes padisë civile në procesin penal, ose padisë në procesin civil. Në këtë rast ato kanë statusin e palës në gjykim dhe mund të përfaqësohen me avokat, në lidhje me padinë e tyre në procesin penal.

Por nuk ka parashikime ligjore për mbrojtjen e tyre me avokat kryesisht.(Bozo, Aurela, 2008: ”Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore”)

Kodi i Familjes

Kodi i Familjes luan një rol fundamental për mbrojtjen e pjesëtarëve të familjes nga fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore në rregullimin e marrëdhënieve familjare. VOT ndeshen me një sërë problemesh ligjore në marrëdhëniet familjare.

Kodi i Familjes parashikon moshën 18 vjeç për bashkëshortët e ardhshëm, me pëlqimin e tyre të lirë dhe të plotë për martesë.

Martesa e lidhur pa pëlqimin e lirë, pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë dhe grua, e lidhur në ndikimin e një kanosjeje dhe e lidhur nën moshën ligjore që parashikon ky Kod, është e pavlefshme (Kodi i Familjes, nenet 33, 34, 36, 37, 39.)

Kodi i Familjes parashikon të njëjta të drejta dhe detyrime të barabarta për bashkëshortët në zgjidhjen e martesës, të cilat përbëjnë një garanci për një familje të shëndetshme dhe të mbrojtur nga fenomene të rrezikshme shoqërore. Midis të drejtave dhe

detyrimeve që Kodi i Familjes parashikon për bashkëshortët, mund të veçojmë të drejtën për “kontribut kompensues” (neni 147) dhe “të drejtën e përdorimit të banesës” (neni 153). Këto janë të drejta të rëndësishme për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve. Mendoj dhe gjykoj se ndryshimet që janë bërë në kuadrin ligjor vitet e fundit kanë zgjeruar dhe zhvilluar më tej konceptin ligjor të trafikimit duke e lidhur me shfrytëzimin seksualë apo me forma të tjera të shfrytëzimit për punë ose shërbime të detyruara.

Duke qenë se trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen i ri i periudhës së tranzicionit, në shoqërinë tonë, e gjeti Shqipërinë pa një kuadër ligjor antitrafik për ti ardhur në ndihmë në mënyrë imedia të vajzave të trafikuar. Nga ligji i parë që u hartua për trafikimin në vitin 1995 deri më sot, vërehet se fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është reduktuar ndjeshëm por nuk është eliminuar totalisht.

Zhvillimet më të reja në legjislacionin tonë penal janë kryer në përqsasje me aktet ndërkombëtare. Vërej se përkufizimet që I jane bërë trafikimit të vajzave/ grave për shfrytëzim seksual ,në legjislacionin penal shqiptar, janë plotësisht në përputhje me përkufizimet përkatëse të Protokollit të Palermos.

Personalisht mendoj se Kodi i Procedurës Penale ka nevojë të përmirësohet duke I ofruar një mbështetje viktimave të krimit, në mënyrë të vecantë viktimave të krimeve të dhunshme për të sanksionuar të drejtën e tyre për informim dhe për të patur një mbrojtje ligjore.

Ashtu sic ndodh rëndom në shtetin shqipëtar ku ligjet i marrim nga vendeve të huaja në zhvillim, dhe i adaptojnë me legjislacionin shqipëtarë pa patur në konsideratë se ato janë vende me një zhvillim të madh ekonomik, social, kulturor ndërsa Shqipëria vazhdon ende të jetë një vend i vogël, me një standart jo të lartë ekonomik, me një shoqëri të mbyllur e patriarkale. Zhvillimet më të reja në legjislacionin tonë penal janë kryer në përqsasje me aktet ndërkombëtare. P.sh., kuptimi dhe përkufizimet e trafikimit të personave, grave, në legjislacionin penal shqiptar, janë në përputhje me përkufizimet përkatëse të Protokollit të Palermos.

Mendoj se duhet të merren masa për të ndëshkuar në mënyrë të drejtë trafikantë dhe për të luftuar krimin e organizuar. Është shumë e rëndësishme që shteti Shqipëtar të zbatojë ligjet dhe strategjitë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë të drejtë që dhe vajza viktimat trafiku të ndihet më e sigurt në të ardhmen nëse zbatohet legjislati.

Mendoj se një vajzë e trafikuar do të lehtësohej në një farë mënyre për dëmin e shkaktuar nga trafikantët sikur të kompensoheshin financiarisht, në mënyrë për të nisur një jetë të re e të pavarur, dhe ky fakt duhet të ishte i sanksionuar në ligj.

Një mënyrë e kompesimit të VeT do të ishte që shteti shqipëtar ti konfiskonte pasurinë tutorit/trafikantit dhe ti vinte në funksion të vajzës që ai kishte shfrytëzuar seksualisht.

1.3.4.Përmirësimet në kuadrin ligjor në polici

Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (Korrik,2005) është krijuar për përmirësimin e informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve që merren me problemet e trafikimit. Nga ky dokument u hartuan një pjesë e madhe urdhërash që shërbejnë për policinë dhe punonjësit kufitar e cila përfshin edhe këshillimin e viktimave. Njësia Anti-Trafik koordinon Grupin Kombëtar Zbatues ne rang rajonal për përshtatjen dhe zbatimin e dokumentit të Mekanizmit Transacional të Referimit (MTR) për personat e trafikuar në Europën Juglindore. Gjithsesi në vitin 2006 janë ngritur dhe janë vëvnë në funksion Komitete Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Nga Ministria e Brendshme është ngritur njësia Anti-Trafik për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, konkluzionet e nxjerra kanë të bëjnë me konsolidimin e mekanizmave zbatues, me ngritjen e kapaciteteve të tyre, dhe bashkëpunimin e palëve të përfshira. Është vënë në dukje nga ministria se zbatimi i ligjit për “mbrojtjen e dëshmitarit” ka rezultuar joefektiv për viktimat e trafikimit pasi vetëm një rast është mbrojtur nga ky ligj në vitet 2005-2007. Si rrjedhojë një ligj tjetër do të

ishite i përshtatshëm dhe i nevojshëm për viktimat e trafikimit. Marrja e certifikatave në bashki si dhe mbulimi i kostove të strehimit për viktimat e trafikimit janë lehtësirat nga kontributet praktike. Raportet midis OJF-ve dhe Ministrisë së Brendshme për ruajtjen e sigurisë të viktimave të trafikimit kanë qenë më të ngushta. Me krijimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, puna ndërmjet OJF-ve dhe institucioneve shtetërore që merren me trafikimin e qenieve njerëzore janë lehtësuar madje OJF-të kanë bërë protokolle bashkëpunimi me çdo njësi. Individualisht. Prej këtyre nevojave është krijuar Mekanizmi Kombëtar I Referimit I cili është një marrëveshje dhe përcakton rolin e secilit actor për sa i përket luftës së trafikimit të qenieve njerëzore.

Me mbështetjen e US/BE është vënë në funksion Sistemi I Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) I cili ndihmon në grumbullimin e informacionit dhe ecurinë e çështjeve penale në lidhje me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Është një nga praktikat më efektive që janë përdorur deri tani pasi ka garantuar akses ndaj të dhënave dhe informacioneve si dhe në ruajtjen e privatësisë së viktimave.

Në vitet 2010-2013 është krijuar Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga një grupë specialistësh për çështjet e trafikimit në bazë të pengesave që lanë të pazbatueshme një numër të mirë të çështjeve të përmendura në strategjitë pararendëse. Kjo nënkupton se ZKKA dhe OJF-të që veprojnë në këtë fushë kanë vullnetin dhe dëshirën për të punuar me praktikën e mëparshme dhe për ti përmirësuar ato më tej. Në korrik të 2007 strehëzat që administrojnë shërbime në kuadër të MKR vendosën të ngrejë një koalicion nën një Marrëveshje Mirëkuptimi për punën e bërë nga CAAHT .

Qëllimi i marrëveshjes ishte përcaktimi i procedurave përgjegjëse dhe detyrave që kanë palët e përfshira dhe funksionimi i koalicionit. Ndërsa objektivi i marrëveshjes ishte koordinimi dhe bashkëpunimi i punës që bëhet nga organizatat palë të koalicionit si edhe shërbimet që ato ofrojnë si : arsimimi, mbështetja, mbrojtja, rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave të trafikimit.

Një nisme e rëndësishme që ka arritur shteti shqiptar deri më sot, ishte përfitimi i ndihmës ekonomike për viktimat e trafikuar. Një nga masat e marra nga shteti për VeT është

miratimi i ligjit Nr. 904, datë 12.12.2012, “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku, midis përfituesve të ndihmës ekonomike, përfshihen edhe viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore. Kjo ndihmë ekonomike është 3.000 lekë të reja në muaj. Kjo shumë që VeT do të përfitojë, është vlerësuar nga ofruesit e shërbimeve si një shumë relativisht e papërfillshme.

1.4.MODELET E ASISTENCËS PËR RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NE SHQIPERI

Përkufizimi i procesit të riintegrit të viktimave të trafikimit është :

Riintegrimi i referohet procesit të rimëkëmbjes dhe përfshirjes social-ekonomike të individit ,pas një përvoje trafikimi. Riintegrimi përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt, aksesin në standarde të arsyeshme jetese, mundësitë për një zhvillim personal dhe ekonomik si dhe aksesin në mbështetjen emocionale dhe sociale. Në shumë raste riintegrimi përfshin kthimin e viktimës në familjen e origjinës/komunitetin e origjinës. Megjithatë ai mund të përfshijë gjithashtu integrimin në një vend të ri, duke u varur nga nevojat dhe interesat e viktimës. (Surtees,2008).

Shërbimet për viktimat e trafikimit në Shqipëri ndahen në tre grupe :

- a.**Shërbime rezidenciale** të cilat ofrojnë një mori shërbimesh brënda strehëza për vajzat viktima trafikimi, përfshirë këtu akomodimin, mbështetjen emocionale dhe suportin moral, mbështetjen ligjore, sigurinë, etj)
- b. **Qëndrat Pritëse** janë qendra që ofrojnë vetëm pritjen e parë të vajzave viktima trafikimi në momentin që janë identifikuar nga institucioni i policisë si raste trafikimi ose si raste të mundshme trafikimi. Këto qendra nuk kanë pjesë të programit të tyre procesin e riintegrit.
- c. **Shërbime komunitare (jorezidenciale).** Janë shërbime që ofrohon për realizimin me sukses të procesit të riintegrit të vajzave të trafikuar. Këtu përfshihen kurset profesionale që ofrohen për vajzat, aktivitete të ndryshme socializuese etj.

1.4.1 QENDRAT REZIDENCIALE

Në këto qendra, viktimave të trafikimit u mundësohet qëndrimi për një kohë të shkurtër. Ato janë qendra pritëse dhe për një kohë më të gjatë janë qendra riintegruese që ofrojnë mbështetje për riintegrim afatgjatë të VeT.

Në Shqipëri qendrat rezidenciale janë të hapura e të mbyllura. Qendrat pritëse janë të mbyllura, ndërsa qendrat riintegruese janë të hapura ose gjysmë të hapura. Qendra të mbyllura do të thotë që VeT, gjatë periudhës së akomodimit, në to nuk mund të lëvizin (të hyjnë apo të dalin nga strehëza). Ndërkohë, qendrat e hapura dhe gjysmë të hapura (Qendrat e Riintegritit) ju japin mundësinë VeT të ndjekin një kurs profesional, të shkojnë në punë të shoqëruara nga stafi i qendrës ose vetëm në varësi të problemeve të sigurisë që mund të ketë çdo individ.

Përveç qendrave, organizatat jofitimprurëse si "Të ndryshëm & Të barabartë", "Vatra" dhe "Tjetër Vizion", ofrojnë edhe mundësi strehimi dhe shërbimet e nevojshme në apartamente të cilët janë apartamente gjysmë të pavarur dhe apartamente me pavarësi të plotë. Apartamentet mund të merren me qera nga organizata e cila ndjek viktimën ose nga vetë viktimat e mbështetur financiarisht nga strehëza.

Qendrat pritëse ofrojnë asistencën e parë për viktimën dhe këtë e bëjnë me anë të paketës bazë të shërbimeve ku adresojnë nevojat e menjëhershme dhe themelore të tyre, siç është nevoja për siguri.

Në vendin tonë ekzistojnë dy qendra pritëse: Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT), e cila është e vetmja qendër shtetërore dhe institucion i Shërbimit Social Shtetëror (MPCSSH).

Shërbimet që ofron QKPVT janë: shërbime për pritjen, rehabilitimin, akomodimin, referimin për riintegrim dhe riatdhesimin të tri grupeve të synuara kryesore.

- Gra e vajza shqiptare të trafikuar ose në rrezik

- Gra e vajza të huaja të trafikuar

- Fëmijë të pashoqëruar ose në rrezik trafikimi

Karakteristika kryesore e Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit është niveli shumë i lartë i sigurisë, në krahasim me qendrat e tjera. Kjo qendër mbrohet nga Policia e Shtetit Shqipëtar dhe është qendër e mbyllur. Kjo është edhe qendra më e sigurt dhe më e përshtatshme për strehimin e viktimave të trafikimit me rrezik të lartë.

Strehëzat\Qendra Riintegruese afatgjata janë qendra që ofrojnë shërbime riintegruese afatgjatë për viktimat e trafikimit. Në Shqipëri qendra riintegruese janë:

- Organizata “Të ndryshëm dhe të Barabartë” është krijuar në Maj të vitit 2004. Kjo është një organizatë jofitimprurëse e cila gjatë këtyre viteve ka ofruar për vajzat viktima të trafikimit në Shqipëri, shërbime të drejtëpërdrejta riintegruese. Kjo organizatë është Antare e Mekanizmit Kombëtar të referimit për viktimat e trafikimit që nga viti që është themeluar (2004) dhe ka kontribuar në përmbushjen e linjave të zbatimit të planeve të veprimit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kontributi që organizata “Të ndryshëm dhe të Barabartë” ka dhënë gjatë këtyre viteve kosiston në :
 - Ofrimin e programeve të drejtëpërdrejta të riintegritit për viktimat e trafikimit shqipëtar duke i ofruar shërbime rezidenciale dhe komunitare (përfshirë këtu dhe fëmijë nëse kanë në ngarkim).
 - Mbështetje financiare për vajzat viktima trafikimi duke i ofruar teknika specifike për gjenerim të ardhurash dhe duke i ndihmuar drejtëpërdrejta në vetëpunësimin e tyre në të ardhmen.
 - Organizimin e vazhdueshëm të aktiviteteve me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit të gjërë për pasojat negative që shoqërojnë një viktimë të trafikuar në procesin e riintegritit si dhe të drejtat themelore që këto vajza duhet të kenë në shoqëri.
 - Angazhohet në realizimin e aktiviteteve për rritjen e aksesit që duhet të kenë vajzat viktimë trafikimi në tregun formal të punës.

- Kjo organizatë për vite të tëra angazhohet në rritjen dhe lehtësirat e aksesit të vajzave të trafikuar në shërbimet publike.
- Angazhohet sistematikisht në realizimin në mënyrë të vazhdueshme të trajnimeve për të gjitha organizatat e tjera jofitimprurëse që ofrojnë shërbime rezidenciale dhe komunitare për viktimat e trafikuar, gjithashtu ka ofruar trajnime dhe për institucionet shtetërore.
- Kjo organizatë angazhohet në vlerësime dhe studime të mirëfillta të këtij procesi të gjatë e kompleks sic është procesi i riintegrit të viktimave të trafikimit në Shqipëri.
- Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” ka rezultuar të jetë përherë pjesëmarrëse në procesin e rëndësishëm të identifikimit të viktimave të trafikimit.
- Ka akses në informimin për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore që ka fokus mbrojtjen e drejtëpërdrejtë të viktimave të trafikimit, si dhe realizon në mënyrë të vazhdueshme konsulencë teknike lidhur me këtë çështje siç është mbrojtja e vajzave viktimë trafikimi.

- Qendra psikosociale "Vatra" ndodhet në qytetin e Vlorës. Ajo është një organizatë jofitimprurëse e cila ofron shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si dhe të vajzave të trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual. Kjo qendër psiko-sociale ka filluar aktivitetin e saj për mbrojtjen ndaj viktimave të trafikimit, duke i asistuar në qendër që në vitin 1999. Në vitin 2004 është licensuar nga Ministria e Punës e Çështjeve dhe e Shansëve të Barabarta si një qendër që ofron shërbime rezidenciale dhe komunitare për viktimat e trafikuar dhe viktimat të dhunës. Fillimisht në vitet 2001 ajo është regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Vlorë me vendim 693, dt.02.10.2001 dhe më pas është reregjistruar në Tiranë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, nr Akti 211, dt 17.01.2005. Sot qendra psiko-sociale “Vatra” është pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me dy licensa për të ofruar shërbime rezidenciale dhe komunitare për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikuar.

Që nga viti 1999 e deri në ditët e sotme , kjo qendër ka implementuar dhe zbatuar një mori

projektesh kombëtare dhe ndërkombetare nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të vazhdueshëm në fushën e parandalimit të fenomeneve siç është trafikimi i vajzave për qëllime shfrytëzimi seksual, si dhe fenomenit të dhunës ndaj gruas në familje. Në këtë mënyrë kjo organizatë ka ofruar informacione dhe orientime të nevojshme sesi të mbrohem ndaj këtyre dy fenomeneve që ishin shumë ekzistuese në ato vite.

Në vitin 2001, në bashkëpunim me qendrën “Save The Children”, qendra psiko-sociale “Vatra” bëri të mundur zgjerimin e saj duke themeluar për herë të parë qendrën rezidenciale (strehëzën) në Shqipëri. Kjo strehëz e ngritur për herë të parë në Vlorë, kishte si qëllim akomodimin dhe programin e riintegrit të vajzave dhe grave viktime të trafikimit njerëzor për qëllime shfrytëzimi seksual. Që nga viti 2001 që është hapur qendra rezidenciale “Vatra” e deri më sot janë asistuar në shelter 1502 vajza të trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual, nga të cilat 132 rezultojnë të jenë vajza viktime trafikimi me nënshtetësi të huaj.

Qendra psiko-sociale “Vatra” nga viti 2003 deri në ditët e sotme ka qenë pjesë e përfshirjes së programeve të qeverisë Shqipëtare në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Kontributi që qendra sociale “Vatra” ka dhënë gjatë këtyre viteve ka qenë :

- Pjesëmarrja në takimet e organizuara për hartimin e Strategjisë Kombëtare Antitrafik të Planit të Veprimit për vitin 2014-2017, të organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik.
- Kjo qendër është përfshirë si partnere e rëndësishme në zbatimin e objektivave dhe masave të marra në çdo strategji dhe plan konkret veprimi antitrafik që nga viti 2002 e deri në ditët e sotme.
- Qendra psiko-sociale “Vatra” në bashkëpunim me grupin e punës të ngritur nga Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinisë , ka kontribuar në hartimin e Standarteve kombëtare për shpërndarjen e shërbimeve sociale nr.195 datë 11.04.2007 të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 582 dt 27.07.2011 të miratuar për hartimin e standarteve të veprimit në identifikimin dhe referimin e viktimeve të mundshëm

të trafikuarra dhe viktimave të mirfillta të trafikuarra, qendra psiko-sociale “Vatra” ka dhënë kontributin e saj si eksperte në këtë fushë.

- Në vitin 2005 është nënshkruar Marrëveshja e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe kjo qender rezulton të jetë anëtare e këtij mekanizmi. Mekanizmi Kombëtar i Referimit është përpunuar dhe nënshkruar në vitin 2012.
- Për punën e tyre gjatë këtyre viteve qendra psiko-sociale “Vatra” është dekoruar me cmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Misioni kryesor i qendrës psiko-sociale “Vatra” është në parandalimin e fenomenit të dhunës në shoqëri veçanërisht dhunës ndaj vajzave dhe grave, si dhe fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore . Qendra fokusohet më tepër në mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të vajzave të trafikuarra nëpërmjet ofrimit të programeve të shërbimeve sociale rezidenciale dhe shërbimeve komunitare. Kjo qendër në sajë të programeve ofron informimin e vajzave viktime trafikimi për shërbimet që ofron, si dhe konsulencës juridike falas për vajzat që kanë probleme ligjore ndaj trafikantëve të tyre.

Qëllimet kryesore të punës që ofron qendra psiko-socioale “Vatra” përfshin :

- Rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri të viktimave të trafikimit njerëzor dhe të viktimave të dhunës në familje.
- Sensibilizimin dhe lobimin e vazhdueshëm në mbrojtje të të drejtave themelore të vajzave dhe grave në shoqërinë Shqipëtare.
- Parandalimin e fenomeneve të tilla si dhuna ndaj grave dhe trafikimi ndaj vajzave për qëllime shfrytëzimi seksual.
- Ngritje e nevojshme të burimeve e kapaciteteve për përfaqesues të institucioneve jo shtetërore e shtetërore në lidhje me çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe të trafikimit të qënieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual.

- Shoqata jofitimprurëse "Tjetër Vizion" është themeluar në 20 shkurt 2002. Në vitin 1998 Organizata joqeveritare CEFA (organizatë Italiane), në bashkëpunim me qeverinë

Shqipëtare të asaj kohe, arriti të ngrinte një gamë të gjërë të shërbimeve sociale për grupet në nevojë në qytetin e Elbasanit. Këtë gjë organizata jo-qeveritare CEFA e arriti nëpërmjet krijimit të projekteve të zhvillimit. Në vitin 2002 u krijua Organizata jofitimpruese “Tjetër Vizion”. Po në këtë vit falë një marrvëshje dypalëshe mes Shqipërisë e Italisë, u krye një veprim operativ i përbashkët me qëllim ndalimin imediat dhe përfundimtar të gomoneve të cilat qarkullonin përgjatë Kanalit të Otrantos, duke transportuar vajza, gra nga Shqipëria drejt Italisë. Fenomeni arriti të ulej në mënyrë imediate por nuk u arrit akoma eliminimi përfundimtar i tij. Patrullimi i gjërë që u bë në atë kohë i brigjeve shqipëtare e italiane, nga ana e forcave blu të rendit, i dekurajoi shumë trafikantë që dërgonin në vijë detare vajza e gra për qëllime shfrytëzimi seksual. Trafikantet filluan të mos përdornin me kufirin detar, por mundësuan krijimin e rrugëve të tjera të paligjshme të vajzave, grave, emigrantëve drejt Europës Perëndimore. Në vitin 2001, me inisjativën e qeverisë Shqipëtare në bashkëpunim me organizatat e ndryshme jofitimprurëse ku pjesë e saj ka qënë dhe organizata “Tjetër Vizion”, ku u përfshinë dhe aktorë të pushtetit lokal u përpilua për herë të parë strategjia e parë e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Por edhe pas masave të marra nga qeveria Shqipëtare, fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht i grave dhe i vajzave për qëllime shfrytëzimi seksual ka ndryshuar dukshëm. Tashmë në ditët e sotme fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore është bërë më i sofistikuar e më i organizuar. Ky fenomen i mirë organizuar godet jo vetëm Shqipërinë, si vend origjinë të trafikimit njerëzor por edhe vendet e destinacionit, si Kosova, Greqia, Italia, etj.

Përballë një realiteti kaq shumë të hidhur të shoqërisë Shqipëtare, organizata Jofitimprurëse “Tjetër Vizion” përmes shërbimit të strehëzës iu bashkangjiti inisjativës së qeverisë Shqipëtare për të vënë në jetë strategjinë e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht të vajzave e grave të trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual. Pritja e parë e vajzave të trafikuar pranë kësaj strehëze fillon gjatë viteve 2002. Shoqata “Tjetër Vizion” më 08.05.2002 mori aprovimin nga Gjykata e Tiranës. Qënga muaji Maj i vitit 2002 deri në ditët e sotme organizata “Tjetër Vizion” ofron shërbime sociale për të gjithë target grupet në nevojë, përfshirë këtu vajza/ gra të trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual, fëmijë të trafikuar për punë të detyrueshme, si dhe krijimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore e

sociale për të rinjt. Vitet e fundit organizata jofitimprurëse ka filluar të ofroj shërbime dhe në sektorin bujqësor, duke mundësuar në këtë mënyrë ngritjen dhe zhvillimin e aktiviteteve që mbështtsin shërbimet sociale në qytetin e Elbasanit. Kohët e fundit kjo organizatë ka filluar të veprojë dhe në sektorin e bisneseve sociale për të qënë më pranë komunitetit të gjerë.

Misioni i organizatës “Tjetër Vizion” është ofrimi i shërbimeve cilësore, për të gjithë target grupet në nevoje të shoqërisë duke operuar në fushën sociale, bujqësore e shëndetësore. Qëllimi kryesor e primar i kësaj shoqate mbetet përmiresimi i cilësisë së jetës së gjithë kategorive në nevojë dhe të mbarë komunitetit të gjerë. Burimi kryesor i financimit të kësaj organizate janë donatorët e huaj. Në Qershor të vitin 2014 kjo organizatë jofitimprurëse nuk ofron më shërbime rezidenciale për vajzat viktimë trafikimi si pasojë e mos financimit të projekteve që lidhen drejtëpërdrejtë nga donatorët e huaj. Në ditët e sotme organizata “Tjetër Vizion” ofron shërbime sociale rezidenciale për fëmijët në nevojë.

Këto tre organizata mbështetjën e arrijnë me tre faza :

Faza I

Asistenca fillestare (e cila kositon në akomodimin e vajzave viktimia trafikimi në qendrën sociale ose ofrimin e mundësive të tjera jorezidenciale)

Faza II

Asistenca afatmesme (Konsiderohet jetesa gjysmë e pavarur për përfitueset në apartamente autonome të ofruara nga organizatat ku ato janë asistuar më parë)

Faza III

Asistenca afatgjatë (Përfshin monitorimin e vazhdueshëm që i bëhet viktimave të trafikuar kur kanë filluar të jetojnë në mënyrë të pavarur në apartamentet që ato kanë marrë me qera)

Faza I - Faza e parë është faza fillestare e cila përfshin akomodimin në një qendër rezidenciale ku ofrohen shërbime, si akomodim, veshmbathje, asistencë mjekësore, asistencë ligjore, strehim , shërbime psikologjike, ruajtje dhe siguri fizike 24 orë, trajnime profesionale, komunikim periodik telefonik, ndërmjetësim me familjen, takime me

familjen, përkthim për përfitueset/sit e huaj, transport për shërbimet e tjera, referime në alternativa për riintegrimin afatgjatë. Këtë asistencë të fazës së parë e ofrojnë të gjitha qendrat që ofrojnë shërbime direkte për viktimat e trafikuar në Shqipëri.

Faza II - Faza e dytë është faza afatmesme ku jeta që bëjnë përfitueset është gjysmë e pavarur. Organizatat si "Vatra", "D&E" dhe "Tjetër Vizion", përveç mbështetjes që i bëjnë viktimave të trafikimit, në qendër ato i mbështesin edhe pasi dalin nga strehëza duke u gjetur strehim dhe kjo bëhet në dy mënyra, si strehimi në apartamente të marra me qera nga organizata. Kjo mënyrë aplikohet nga organizata "Vatra" dhe "Tjetër Vizion", ndërsa pagesa e qerasë së shtëpisë si mënyrë aplikohet nga organizata "Të ndryshëm & Të barabartë".

Këto organizata, përveç pjesës së strehimit, ofrojnë edhe shërbime të tjera mbështetëse, si punësimi, njohja me burimet e komunitetit, këshillimi, etj. Këto shërbime fuqizojnë viktimat duke i drejtuar drejt një jete të pavarur.

Faza III - Faza e tretë është faza afatgjatë që e çon përfituesen drejt një jete të pavarur. Kjo fazë është edhe faza e fundit, e cila arrihet kur në një rast, viktimi e trafikimit mund të jetojë e pavarur. (Standarti 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve në standartet "Për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale", të miratuara me VKM 195, dt.11.4.2007).

Mbështetja që u jepet rasteve për të dalë nga programi i ndihmës konsiston në:

- Ofrimin e ndihmës për riintegrim duke pasur si objektiv kryesor mbështetjen ose shfrytëzimin e familjes së origjinës ose të komunitetit.
- Ofrimin e nevojshëm të informacionit mbi shërbimet që ofrohen në komunitet si dhe burimet e disponueshme të komunitetit, duke realizuar kontaktet e nevojshme me këto institucione, dhe së fundi ofrimin e hartës së plotë të shërbimeve.
- Ndhimën e rasteve për krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve me institucionet e ndihmës së komunitetit ku po jeton.

- Monitorimi dhe ndjekja e mëpasshme e viktimës së trafikuar pasi ka dalë nga programi i strehëzës.

Pjesë e Kualicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-Trafik, e cila është krijuar në vitin 2007 është dhe Qendra Kombëtare Pritëse të Viktimave të trafikimit. Kjo qendër ndodhet në Linzë të qytetit të Tiranës, dhe është e vetmja strehëz e një sigurie të lartë e cila ruhet 24 orë në 24 nga forcat RENEA. Rastet e vajzave që asistohen në këtë qendër janë të një rrezikshmërie të lartë për jetën. Qendra Kombëtare pritëse për vajzat/gra viktimat trafiku ofron shërbime si :sigurinë, akomodimin, mbështetjen mjekësore, dhe ajo me kryesorja mbështetjen ligjore për këto vajza të cilat kanë denoncuar tutorët e tyre.

1.4.2.SHËRBIMËT JOREZIDENCIALE NË SHQIPËRI

Krahas shërbimeve rezidenciale në Shqipëri, tani ekzistojnë edhe shërbimet jorezidenciale ose komunitare, të cilat janë më shumë jashtë fushës antitrafik por me programet e tyre mbështesin edhe viktimat e trafikimit. Këto shërbime ofrohen edhe nga qendrat ditore që janë të ngritura në disa qytete, si nga OJF, ashtu dhe nga institucione shtetërore. Këto qendra ditore funksionojnë në Tiranë, Vlorë, Elbasan, etj

Qendrat ditore dhe komunitare ofrojnë disa lloje shërbimesh, si:

- Shërbime të ndihmës ligjore dhe administrative
- Mbështetje dhe monitorim në vazhdimësi
- Shërbime psikologjike ose shërbime këshillimi
- Asistencë financiare
- Formim profesional
- Mbështetje për të gjetur punë
- Asistencë mjekësore
- Asistencë për arsimim

- Fushata informuese
- Riintegrim në shkollë
- Shoqërim gjatë kthimit vullnetar. (Standarti 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve në standartet "Për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale", të miratuara me VKM 195, dt.11.4.2007).

1.4.3. Masat e marra nga institucionet qeveritare për riintegrimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri

Përsa i përket riintegrimin të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në lidhje me masat e marra nga Qeveria shqiptare, është e rëndësishme që të theksohet përafrimi i kuadrit ligjor në adresimin e nevojave më urgjente të viktimave.

Katër nga përpjekjet strategjike për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore kanë qenë hartimi dhe miratimi i:

- Strategjisë Kombëtare Shqiptare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2001-2003)
- Kuadri Strategjik e Plani Kombëtar i Veprimit (2005-2007)
- Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2008-2010), (Ministria e Brendshme, 2008b)
- Strategjisë Kombëtare Shqiptare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2014-2017)

Në 19.12.2005, me urdhër të Kryeministrit, nr.203 "Për mënyrën e funksionimit të Njësisë Antitrafik" u ngrit Njësia Antitrafik, e cila funksionon pranë Ministrisë së Brendshme dhe në ushtrimin e funksioneve të saj drejtohet nga Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore / Zëvendësministri i Brendshëm.

Njësia Antitrafik ka monitoruar dhe kordinuar veprimet e të gjitha strukturave dhe aktorëve të tjerë publikë shtetërorë dhe joshtetërorë (agjensive vendase dhe të huaja partnere) për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore dhe Planit të Veprimit 2005-2007. Ajo ka përgatitur gjithashtu edhe raporte periodike për situatën e trafikimit në Shqipëri si dhe ka kryer rolin e Sekretarit Teknik të Komitetit Shtetëror (Ndëministor) të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. (Ministria e Brendshme, 2008a) Në kuadër të riintegrit të viktimave të trafikimit, një masë e marrë shumë e rëndësishme është edhe ajo e krijimit të një baze të dhënash për viktimat e trafikimit. (Ministria e Brendshme, 2008a)

Nga krijimi i bazës së të dhënave mundësohet analizimi i informacionit për të patur një tablo të qartë të situatës së trafikimit në vend si dhe për të mundësuar zbardhjen në kohë të tendencave të fenomenit, në mënyrë që edhe përgjigja e strukturave përgjegjëse ndaj tij të jetë e shpejtë dhe efektive. (Më konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka hartuar një Urdhër-Shërbimi të Drejtorit të Përgjithshëm, nr.865, datë 26.12.2007, "Për hedhjen e të dhënave në database-in e viktimave të trafikimit". Ky urdhër shërbimi përcakton procedurat e hedhjes së të dhënave, caktimin e personave/operatorëve përkatës,afatet kohore, raportimet, etj).

Baza e të dhënave ka një rëndësi të veçantë për informacionin e lidhur me ecurinë e trajtimit të viktimave të trafikimit, që nga identifikimi e deri në riintegrimin e plotë. Baza e të dhënave, sipas Ministrisë së Brendshme, është vënë në funksion në mars 2008. Baza e të dhënave të ZKKA-së është ndërtuar për të mbuluar një gamë të gjërë informacioni, të mbështetur te rastet individuale për profilet e viktimave të trafikimit dhe trafikantëve. Baza e të dhënave të ZKKA-së përfshin të dhëna të sjella nga palët ndëshkuese të MKR-së (shtetërore dhe jofitimprurëse), pavarësisht se ku bëhet takimi i parë me viktimat e trafikimit (në kufi apo drejtpërdrejt në strehëz).

Marrëveshja për MKR-në (Situata e përpjekjeve në Shqipëri për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2007-2008, CAAHT, tetor 2008) mbështet regjistrimin dhe interpretimin e informacionit. Një politikë tjetër e rëndësishme për riintegrimin e

viktimave të trafikimit njerëzor në Shqipëri është edhe Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat e Trafikimit, e cila vjen si rezultat i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (MKR), e cila është firmosur në 18 korrik 2005. Kjo marrëveshje përcakton një bashkëpunim midis aktorëve kryesorë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe përcakton përgjegjësitë që palët e përfshira kanë në identifikimin, referimin, akomodimin, asistencën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit (Ministria e Brendshme, 2008). Mekanizmi Kombëtar i Referimit është një kornizë bashkëpunuese ku aktorët shtetërorë plotësojnë detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave njerëzore të personave të trafikuar, duke i koordinuar përpjekjet e tyre në partneritet strategjik me shoqërinë civile (OSBE / ODIHR, 2006).

Në bazë të një urdhëri të përbashkët të nënshkruar nga Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, u krijua Autoriteti Përgjegjës si pjesë e marrëveshjes për MKR-në, për bashkërendimin dhe përpunimin e referimeve për të gjitha viktimat e trafikimit dhe për realizimin e funksioneve të tjera të bashkërendimit dhe raportimit që parashikohen në marrëveshjen e MKR-së. Në 2007 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta miratoi Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale. Një iniciativë e tillë është ndër të parat në Ballkan në kuadër të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore nga të gjithë ofruesit e shërbimeve për target-grupin e viktimave të trafikimit në Shqipëri si edhe në kuadër të zhvillimit të një sistemi korrekt të inspektimit të zbatimit të shërbimeve që ju ofrohen VeT në qendrat rezidenciale.

Për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi janë hartuar disa standarte shërbimesh, si parimet e njohura të barazisë, respektimi dhe garantimi i vlerave dhe personalitetit të individit, të drejtat për të përfituar dhe për të qenë i mbrojtur, mosdiskriminimi, ruajtja e konfidencialitetit të jetës private, e dinjitetit dhe e sigurisë, partneritetit, integritetit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit.

Një tjetër politikë në nivel lokal, pavarësisht se jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë, është

edhe krijimi i Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila synon adresimin e nevojave për riintegrimin efektiv të viktimave të trafikimit njerëzor. Kjo nismë mbështetet nga urdhëri ligjor me nr. 139 nga Kryeministri, dt. 19.06.2006. Si qëllim kryesor për këto komunitete është sigurimi që politikat, programet dhe shërbimet antitrafik të vihen në jetë në qarqet e tyre dhe të ulet cënueshmëria e personave, familjeve dhe komuniteteve nga krimet e trafikimit të qenieve njerëzore. Për të përmbushur këtë qëllim kryesor, këto komunitete kanë për detyrë kryerjen e vlerësimeve periodike për situatën rajonale dhe nevojat specifike si dhe nxjerrjen në pah të përparësive për veprim në nivel rajonal, etj. (Ministria e Brendshme, 2008b) Në nivel mikro, në vitin 2003 është ngritur Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) për të ofruar shërbime direkte për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky institucion funksionon në vartësi të Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSH). QKPVT-ja ka një kapacitet prej 100 personash, e cila asiston pritjen, akomodimin, rehabilitimin, referimin për integrim dhe riatdhesimin (kur përfituesit janë shtetas të huaj), të tre target-grupeve kryesore:

- Gra e vajza të trafikuar dhe në rrezik trafikimi
- Fëmijë të trafikuar dhe në rrezik trafikimi
- Migrantë të parregullt (Ministria e Brendshme, 2008a)

Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit ofron shërbime në përputhje me Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007, "Për Miratimin e Standarteve të Shërbimit të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi". Këto shërbime standarte do të shërbejnë për rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për grupet në nevojë, duke synuar respektimin e parimeve e te barazisë, mosdiskriminimit, vetëvendosjes, rehabilitimit, parandalimit, integritit shoqëror, etj. (Ministria e Brendshme, 2008a)

1.4.4. Masat që janë marrë nga institucionet për riintergrimin e VeT

Organizatat joqeveritare në Shqipëri që operojnë në fushën e antitrafikimit japin një kontribut, i cili ka qënë dhe është thelbësor për shërbimet që iu ofrohen targetgrupit të viktimave të trafikimit. Këto organizata, të cilat ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit, se bashku me një qendër të menaxhuar nga shteti, kanë krijuar Koalicionin Kombëtar të Strehëzave shqiptare për të koordinuar sa më mirë punën e tyre (KKSAT).

Anëtarët e këtij koalicioni janë: "Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e trafikimit"-Tiranë, organizata "Të ndryshëm & Të barabartë"-Tiranë, shoqata "Tjetër Vizion"-Elbasan, Qendra Komunitare "Jetë dhe Shpresë"-Gjirokastrë, Qendra Psiko-Sociale "Vatra"-Vlorë.

Kontributi i anëtarëve të këtij koalicioni ka qënë shumë i rëndësishëm në iniciativën e marrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për hartimin e standardeve për përkujdesin shoqëror që u jepet personave të trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.195, dt.11.04.2007. Këto organizata kanë ofruar ekspertizën dhe eksperiencën e tyre disa vjeçare, duke u përfshirë intensivisht në grupin e punës për të ofruar asistencë direkte për viktimat e trafikimit. Një ndër masat më të rëndësishme që organizatat joqeveritare ofrojnë për targetgrupin e viktimave të trafikimit në Shqipëri është ofrimi i një pakete shërbimesh rehabilituese dhe riintergruese për këto viktime. Kjo paketë përfshinë shërbime të specializuara dhe të standartizuara për të gjithë personat që identifikohen si viktime trafikimi dhe vazhdon të jetë deri në përgatitjen për të dalë në jetën e pavarur.

1.5. Praktikrat më të mira në lidhje me VeT në vende të tjera

Në varësi të nevojave të secilit rast ofrohen shërbime rezidenciale dhe jorezidenciale për VeT. Këto shërbime ofrohen në mundësitë reale dhe financiare të strehëzës (të stafit) për të ndihmuar viktimat, çështjet e sigurisë, pengesat institucionale dhe ligjore, kushtet e nevojshme jetëgjatësinë e programit, përzjerjen e fëmijëve me vajzat e trafikuarat etj.

Programet që kanë funksionuar në rajon dhe kryesisht në Europën Lindore kanë qenë programet e parandalimit në Kroaci nëpërmjet Ministrisë së Arsimit e cila ka bërë sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin me material të ndryshme nëpër shkolla. Në Moldavi programet janë përqendruar tek ndihma ekonomike dhe përmirësimi për vajzat dhe gratë të cilat janë në rrezi trafikimi ose mund të jenë trafikuar ose ato të cilat mund të riciklohen sërisht nga trafikantët dhe të kenë mundësi ekonomike për të filluar një jetë të pavarur. Në rastin e Rumanisë pjesa më e madhe e vajzave të trafikuar dhe e fëmijëve vijnë nga jetimoret, strehëzat dhe OJF-të ofrojnë trajtime për aftësimin e fëmijëve (duke i mësuar një profesin) për të gjetë një punë dhe për të bërë një jetë të pavarur në momentin kur largohen nga jetimorja. Ndërsa Rusia ka bërë një kombinim të programeve që bëjnë ndërgjegjësimin dhe trajnimin dhe ju ofrojnë mundësi ekonomike vajzave të trafikuar (Best Practices in Trafficking Prevention in Europe and Eurasia, USAID : 2009). Stafi i qendrave riintegruese gjatë vizitave studimore të bëra në shtete të ndryshme të Europës Perëndimore, ka përcaktuar si praktikë shumë të mirë dhe efiçente përfshirjen sociale të viktimave të trafikimit mbështetjen e madhe që jep shteti nëpërmjet sistemit të mbrojtjes sociale.

Për shembull nga vizita studimore që është bërë në Belgjikë dhe Itali vihet re se qendrat që asistojnë viktimat e trafikimit luajnë vetëm rolin e ndërmjetësit me institucionet e ndryshme si : shëndetësia, zyrat e strehimit social, zyrat e formimit profesional dhe punësimin, zyrat e ndihmës ekonomike dhe janë pikërisht këto institucione që mbështesin individin në aspekte të ndryshme që çojnë në një riintegrim të qëndrueshëm të viktimave të trafikimit.

Edhe në vizitën studimore në Kosovë u vunë re disa praktika të mira si p.sh : funksionimi i shërbimeve sociale nga ana e shtetit, nëpërmjet zyrave të punës sociale. Këto zyra u ofronin mbështetje gjithë grupeve sociale vulnerable, si dhe viktimave të trafikimit (mbështetja ofrohej profesionalisht nëpërmjet një ekipi multidisiplinor).

Një tjetër praktikë shumë e mirë në Kosovë ishte edhe prania e Mbrojtësit Ligjor të viktimave të trafikimit, i cili ishte i vendosur nga Ministria e Drejtësisë. Organizatat në Itali kishin si praktikë të mirë në funksion të riintegrimin të VeT programet për gjenerimin e të ardhurave të cilat realizohen kryesisht nëpërmjet ngritjes së bizneseve sociale.

Disa nga praktikat e mira që ndihmojnë në Shqipëri për riintegrimin e viktimave të trafikimit janë:

1.5.1. Shërbimet Riintegruese që ofrohen në Shqipëri për vajzat viktima trafikimi

Në funksion të riintegrit të viktimave të trafikimit arritje e rëndësishme është edhe finalizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Qendrave Shtetërore të Formimit Profesional (pjesë të MPCSSHB) dhe organizatave që ofrojnë shërbime riintegruese për viktimat e trafikimit.

Nga këto marrëveshje është krijuar një frymë pozitive bashkëpunimi që lehtëson procesin e regjistrimit dhe fillimit të kurseve të ndryshme profesionale për përfitueset e qendrave të riintegrit “Të ndryshëm & Të barabartë”, “Vatra”, “Tjetër Vizion” etj.

Pranë Qendrave Shtetërore të Formimit Profesional ofrohen disa kurse profesionale si : rrobaqepësi, kuzhinë, parukeri etj këto kurse I pajisin VeT me njohuri të mira profesionale. Për të përfituar nga këto kurse profesionale duhet bërë regjistrimi në Zyrat e Punës si punë kërkuese të papuna. Ky problem po kapërcehet gradualisht (fillimisht VeT nuk donin të identifikoheshin si të tilla nga frika e diskriminimit, mos ruajtja e konfidencialitetit mbi identitetin e tyre etj) me rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve të administratës për rëndësinë e ruajtjes së të dhënave të marra nga VeT në momentin e aplikimit pranë këtyre strukturave.

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në këtë rast viktimave të trafikimit është ngritja e një institucioni të ri të quajtur Komisioni për Ruajtjen e të Dhënave. Ky institucion merret me mbledhjen e ankesave të qytetarëve në rastet e shkeljes së të drejtave të tyre (p.sh nëse një punonjës administrate abuzon me të dhënat e marra nga VeT , me anë të një ankese drejtuar institucionit të mësipërm VeT ka të drejtë të kërkojë deri ndjekjen penale të punonjësit qëka kryer shkeljen).

Këshillohet që ky informacion tu kalohet viktimave të trafikimit për ti siguruar që informacioni personal që japin në Zyrat e Punës do të mbetet konfidencial. Një shembull pozitiv bashkëpunimi me institucionet shtetërore është edhe marrëdhënia midis OJF-ve që punojnë në asistecë direkte me VeT dhe nën kuadrin e projektit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) synon të ofrojë mikro-kredi për sipërmarrjet private të grave dhe vajzave të trafikuar duke u mundësuar atyre pavarësinë ekonomike dhe duke reduktuar mundësitë e ri-trafikimit.

Deri tani një gjë e tillë është realizuar në kuadrin e projekteve të ndryshme (të përmenduar edhe më sipër, projekt i përbashkët OSBE –ILO) dhe rezultatet kanë qenë me të vërtetë pozitive. Ish viktimat e trafikimit që kanë qenë pjesë e këtyre projekteve kanë treguar aftësi dhe përkushtim si në hapjen e mikrobizneseve të tyre private, ashtu edhe në zgjerimin dhe në krijimin e një lloj qëndrueshmërie për këto aktivitete. Një praktikë që çon në një riintegrim sa më të qëndrueshëm në shoqëri të viktimave të mitura të trafikimit janë të ashtuquajturat familjet kujdestare. Duke vlerësuar me kujdes nevojat e VeT të mitura, është arritur në përfundimin që vendosja në një mjedis familjar është padiskutim alternativa më e mirë për riintegrimin e tyre. Gjetja e këtyre familjeve kujdestare të përshtatshme për këtë grupë është problem më vete, përgjegjësi kjo që normalisht është e Seksionit të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në Bashki/ Komunë (MPÇSSHB, Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013, Tiranë 2007).

Janë të sanksionuara ligjërisht disa kritere mbi bazën e të cilave përzgjidhen familjet kujdestare të tilla si:

1. Vlerësimi i familjes kujdestare;
2. Moshë e prindërve;
3. Marrëdhëniet me ligjin;
4. Statusi financiar;
5. Motivimi për të qenë prindër kujdestarë;
6. Aftësitë prindërore;

7. Edukimi;
8. Shëndeti;
9. Strehimi;
10. Qëndrime jodiskriminuese;
11. Infrastruktura e komunitetit;
12. Përfshirja e anëtarëve të familjes kujdestare;
13. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me institucionet e përfshira në procesin e kujdestarisë;
14. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me familjen e origjinës.

Ndërkohë deri më sot, ofruesit e shërbimeve kanë arritur të seleksionojnë familje të tilla për VeT minorene duke u mbështetur në rrethin familjar të vetë VeT, padiskutim duke i vlerësuar me kujdes mbështetur edhe në kriteret e mësipërme. Miratimi i Standardeve për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi janë një tjetër praktikë e mirë e ndërmarrë në Shqipëri në kuadrin e ofrimit të shërbimeve riintegruese sa më cilësore për viktimat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi. Zbatimi i standardeve shërben si bazë për pritjen, rehabilitimin e grave dhe vajzave që kanë qenë viktimat të trafikut dhe për realizimin e procedurave fillestare të përkujdesjes ndaj fëmijëve, për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për fëmijët e trafikuar, të keqtrajtuar dhe të abuzuar (MPCSSHB, Standartet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në Qendrat Rezidenciale, Tiranë 2008.

KAPITULLI II

2.2.METODOLOGJIA

Në këtë kapitull parashtrohet mënyra se si është realizuar studimi “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”, hapat e ndjekur për realizimin e tij, elementët përbërës dhe mënyra e kombinimit të tyre për të përftuar rezultatet përfundimtare. Kapitulli paraqet metodën kërkimore të përdorur në realizimin e studimit dhe shpjegon përshtatshmërinë e kësaj metode me qëllimet e kërkimit. Gjithashtu, është prezantuar plani i studimit, janë shpjeguar instrumentet e përdorur për grumbullimin e informacionit të nevojshëm, problematikat që kanë dalë gjatë studimit, procedurat dhe instrumentet e përdorura, kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në studim, procedurat e ndjekura për të siguruar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve, si dhe kufizimet e vështirësitë e hasura për realizimin e studimit.

2.3.Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është kuptimi e analizimi i përvojave, emocioneve, vështirësive sociale e ekonomike që u duhen vajzave të trafikuar për t’u përballur gjatë procesit të riintegritimit në shoqëri.

Objektivi specifik i këtij studimi është :

- Eksplorimi i burimeve, mundësive, sistemeve dhe strukturave mbështetëse që mund të ndihmojnë për një riintegrim të suksesshëm të vajzave të trafikuar në Shqipëri
- Rëndësia e procesit të riintegritimit dhe faktorët që ndikojnë në realizimin me sukses të këtij procesi në jetën shoqërore të viktimave të trafikimit
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për vajzat viktime trafikimi për të patur një riintegrim të suksesshëm në shoqëri si dhe analizimi i sfidave në këtij procesi.

2.3. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Është ngritur një hipotezë kryesore për këtë studim, për të parë sesi e dëshmon kjo hipotezë realitetin shqiptar. Hipoteza e studimit e ngritur është :

H =>Faktorët socialë e ekonomike ndikojnë në mosrealizimin me sukses të procesit të riintegritit të vajzave viktimë trafikimi (VeT).

Për të realizuar këtë studim në mënyrë sa më efikase, kam ngritur një mori pyetjesh kërkimore si :

- * Cilat janë sfidat që përballen vajzat viktimë të trafikuar gjatë procesit të riintegritit?
- * A mbështeten nga familja e origjinës vajzat e trafikuar?
- * A ka ndikuar historia e trafikimit të vajzave në fushat kryesore të jetës, gjatë procesit të riintegritit?
- * Ç`qëndrim mban shoqëria e komuniteti i gjërë me vajzat pas procesit të trafikimit?

2.4. Hartimi i kërkimit

Arsyeja e ndërmarrjes së këtij studimi lidhet me rëndësinë që ka për viktimat e trafikut procesi i riintegritit në jetën sociale. Në jetën e përditshme flasim shpesh për pasojat shokuese që ky fenomen lë tek vajzat e pambrojtura, por nuk është folur se me çfarë sfidash duhet të përballen femrat që kanë lënë pas një jetë të tillë të trafikimit. Zakonisht ne nuk arrijmë të flasim dot për vështirësitë e përditshme që vajzat viktimë trafikimi hasin drejt procesit të riintegritit në shoqëri. Duke qënë të ndërgjegjshëm se procesi i riintegritit është një proces mjaft i vështirë, kam menduar që me anë të këtij studimi ta shqyrtoj këtë proces në tërësi, duke u fokusuar tek faktorët që çojnë në një riintegrim të suksesshëm të vajzave viktimë trafikimi në Shqipëri.

Raste të vajzave e grave viktima të trafikimit që kanë arritur të riintegrohen plotësisht në shoqëri nuk mungojnë, por nga ana tjetër e medaljes, ka pasur dhe vajza, viktima trafiku, që janë rickluar, sërish, duke u bërë viktima trafiku ose tutore ndaj vajzave të tjera .

Referuar disa “studimeve” të mëparshme të kryera në vendin tonë në lidhje me fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore, vihet re se nuk ka studime të mirfillta që të kalojnë në etapat e një procesi kërkimor. Ato pak të tilla që ekzistojnë janë përqendruar tek procesi i riintegritimit gjatë asistimit nëpër qendra dhe jo në vazhdimësi e sidomos pas daljes së vajzave VeT nga programi i shërbimeve sociale që ofrojnë qendrat për këtë kategori.

Ky studim është munduar të pasqyrojë një pamje të plotë e të integruar të problematikave që hasin vajzat e trafikuar në shoqërinë tonë, siç janë: problemet në gjetjen e një pune dhe mbajtjen sa më gjatë të saj, mos të paturit e një marrëdhënie me familjen e origjinës, paragjykimet e stereotipet që ekzistojnë në shoqëri për vajzat viktima trafiku, si dhe arsyet që e çojnë një vajzë të trafikuar të riciklohet sërish në shoqëri. Studimi analizon në detaje situatën, duke u fokusuar dhe tek elementë të cilët krijojnë, një pasqyrë më të qartë të ndërthurjes së problemit me faktorët socialë, ekonomikë e institucionalë.

2.5. Procesi i realizimit të studimit dhe kohëzgjatja e tij

Studimi ka nisur në Dhjetor të vitin 2012 dhe ka përfunduar në Shtator të vitit 2015. Pikënisje të tij ka pasur përcaktimin dhe përzgjedhjen e fushës së studimit, (analizimi i sfidave që hasin vajzat viktima të trafikuar në vendin tonë) duke u ndalur kryesisht tek problemet social-ekonomike që ndeshin vajzat VeT, si dhe rolin e institucioneve politikëbërëse dhe politikëzbatuese në trajtimin e fenomenit të trafikimit në Shqipëri. Përvoja e studiuesve në fushën sociale më ka ndihmuar të kuptoj qartë, që në fillim të studimit, disa nga arsyet të cilat pengojnë e vështirësojnë procesin e riintegritimit. Pas krijimit të një pasqyre të qartë të situatës aktuale të fenomenit të trafikimit, këndvështrimi i studimit u drejtua tek ofruesit e shërbimeve sociale për vajzat viktimë trafikimi, si një pikë e rëndësishme mbrojtje e mbështetje të vazhdueshme në jetën e këtyre vajzave.

Të dhënat tregojnë se situata aktuale e trafikimit të personave në Shqipëri ka bërë përparime të mëdha e fundamentale vitet e fundit, në drejtim të luftës kundër trafikimit të

qenieve njerëzore, falë përpjekjeve të përbashkëta e të gjithanshme të agjensive shtetërore dhe joshetërore, si dhe mbështetjes së vazhdueshme të organizatave partnere ndërkombëtare dhe atyre të shoqërisë civile.

Duke analizuar të dhënat zyrtare mbi personat e trafikuar të identifikuar në Shqipëri, si dhe informacionet e tjera të marra nga aktorët antitrafik në terren, arrijmë në përfundimin se Shqipëria mbetet kryesisht një vend origjine për trafikimin e burrave, grave dhe fëmijëve, që i nënshtrohen shfrytëzimit për punë të detyruara dhe prostitucion. Shumë viktime shqiptare, kryesisht femra, i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion brenda vendit dhe në vendet fqinje e më tej, sidomos në Belgjikë, Francë, Gjermani, Irlandë, Itali, Holandë, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar (viktimat shpesh pranojnë oferta të rreme për punësim, si kamariere, banakiere, kërcimtare apo këngëtare, sidomos në Kosovë, Greqi dhe Maqedoni, apo trafikohen me anë të mashtrimit të “të dashurit”). Trafikimi i brendshëm i të miturve dhe të rriturve ka rritur shifrat e përgjithshme të trafikimit në Shqipëri, gjë që dëshmohet nga numri i identifikimeve që janë bërë nga njësitë lëvizëse proaktive, të krijuara së fundmi gjatë vitit 2013.

Gjatë vitit 2011 janë identifikuar 84 viktime të mundshme trafikimi, nga të cilat 45 të rritur dhe 39 të mitur. Në 2012 janë identifikuar gjithsej 92 viktime të mundshme, nga të cilat 26 janë të mitur, dhe 66 të rritur, ndërsa në 2013 janë identifikuar 95 viktime të mundshme trafikimi, nga të cilat 52 të rritur (të gjitha gra) dhe 43 të mitur (nga të cilët 14 meshkuj). Të dhëna këto nga raportet periodike të ZKKA-së, (Strategjia kundër trafikimit të personave dhe Plani i Veprimit 2014 – 2017)

Studimi “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”, ka kaluar në këto faza.

Në fazën e parë është bërë një rishikim literature ekzistuese rreth fenomenit të trafikimit, me qëllim njohjen e arritjeve deri me sot të studimeve që janë realizuar në lidhje me procesin e riintegritimit në shoqëri të këtyre vajzave viktime trafikimi si dhe njohjen e gjetjeve të studimeve të bëra kryesisht brenda vendit. Në këtë fazë puna është përqëndruar në përmbledhjen e gjetjeve kryesore të faktorëve që pengojnë në procesin e riintegritimit të

suksesshëm të vajzave e grave Vet. Në fazën e parë të tij ka konsultuar dhe në përmbledhjen e sugjerimeve e kërkimeve ekzistuese, ku lidhet me pyetjet kërkimore të këtij studimit të realizuar. Duke u nisur nga fakti që studimet e mëparshme përditësohen me informacione të reja në lidhje me këtë temë, rishikimi i literaturës më ka ndihmuar për të analizuar të dhënat cilësore të paraqitura në këtë studim si dhe për të riparë e shqyrtuar anën teorike të këtyre studimeve. (Matthew. B. Miles, A. Michael Huberman , Qualitative Data Analyses: An Expanded Sourcebook, Sage , 1994, botim II , Fq. 152)

Faza e dytë e këtij studimi është përqëndruar në përgatitjen e pyetjeve kërkimore. Këto pyetje kërkimore kanë arritur të evidentojnë ekzistencën e problemit që lidhet me vështirësinë që hasin vajzat viktime të trafikuar në riintegrimin e plotë të tyre në shoqërinë Shqipëtare. Në lidhje me realizimin sa më efikas të këtij studimi është projektuar dhe një platformë pune. Rishikimi dhe selektimi i materialeve informuese mbi këtë temë, më ndihmoi në arritjen e konstatimeve konkrete të fenomenit të trafikimit si dhe selektimin e përzgjedhjen e pyetjeve kërkimore kyçe të studimit. Të gjitha këto më erdhën në ndihmë për të realizuar analizën cilësore të rezultateve të studimit.

Faza e tretë e studimit kosiston në evidentimin e metodave të kërkimit. Në këtë studim është përcaktuar metoda cilësore për të udhëhequr analizën e të dhënave të marra nga fokus grupet e realizuara me ofruesit e shërbimeve si dhe intervistat gjysëm të strukturuar që janë përdorur me vajzat viktime trafikimi. Në këtë studim, pas konsultimeve me specialistë të fushës së kërkimit cilësor, janë pilotuar intervistat gjysmë të strukturuar, hulumtim ky i tipit eksplorues dhe vlerësues. (L.Ross, A.Wits, From Surviving To Thriving, Departament of Social Polity and Social Eork, University of Birmingham, 1993). Fokus grupet u realizuan me ofruesit e shërbimeve ndërsa intervistat gjysëm të strukturuar u realizuan me vajzat /gra viktime të trafikimit. Pyetëtori është hartuar me pyetje të hapura, e pyetje të mbyllura dhe ka përfshirë dy kategori: viktimat e trafikuar që kishin marrë shërbime sociale në rezidencë dhe që kishin kohë që ishin shkëputur prej programeve të shërbimeve riintegruese; si dhe vajzat viktime të trafikuar që asistoheshin aktualisht në strehëz dhe që vazhdojnë të jenë pjesë e programeve të riintegrimit.

Duke njohur shërbimin dhe target grupet e përfshira, është parë e udhës që intervistat me fokus grupet të përfshijnë punonjëset e stehëzave Psiko-Sociale, si: “Vatra”, “Të ndryshëm e të Barabartë” e “Tjetër Vizion”.

Intervistat e realizuara me vajzat viktimë trafikimi u pa e arsyeshme , të realizoheshin në prezencën e punonjëseve të qendrës ku ato janë asistuar më parë. Ky detaj, është bërë me qëllim që vajzat e trafikuar të ndjeheshin më të qeta gjatë realizimit të intervistave, meqenëse intervista nuk mund të realizohej me praninë e një intervistuesi të huaj. Duke respektuar në këtë mënyrë standartet e miratuar nga Ministria e Punës e Cështjeve dhe e Shanseve të Barabarta dhe dëshirën e viktimave të trafikuar për të mos ndarë përvojën e tyre jetësore me persona të panjohur për to. Informacioni i marrë në këto intervista është përdorur vetëm për qëllime studimi dhe është trajtuar në kushte absolute kofidencialiteti.

Në fazën e katërt janë përdorur intervista të regjistruara me regjistrues (diktofon) si dhe forma e zhvillimit të focus grupeve. Kjo u bë e mundur pas njohjes së tyre me këtë proces paraprakisht. (Richard A. Krueger, *Developing Questions for a Focus Group*, Sage, Thousand Oaks, CA, 1998, fq. 81). Ky proces është pasuar me atë të transkriptimit të tyre. Pjesë e punës ka qenë dhe zbardhja e intervistave me ofrueset e shërbimeve, të cilat nuk pranuan intervistimin me regjistrim.

Pas përfundimit të intervistimit me tre kategoritë e përzgjedhur për studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”, u mblodhën dhe u analizuan të dhënat e marra nga vajzat viktimë të trafikuar që asistoheshin në qendër, ato vajza që kishin përfituar nga shërbimet e ofruara dhe nga ofruesit e drejtëpërdrejtë të këtyre shërbimeve.

Faza e pestë: Përfshin nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve të përgjithshme dhe specifike. Rekomandimet e përgjithshme adresohen për institucionet që merren drejtëpërdrejtë me procesin e riintegritimit të vajzave të trafikuar në shoqëri dhe rekomandimet specifike adresohen për të gjithë aktorët ku përfshihen institucionet qendrore politikëbërëse e zbatuese e organizatat ndërkombëtare.

2.6. Metoda kërkimore e përdorur

Metodologjia e përdorur në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” është ajo cilësore, si një metodë efektive që ofron një informacion sa më të detajuar e specifik dhe konceptimin më të gjerë e të thelluar të eksplorimit e subjekteve. Metoda e përdorur për realizimin e këtij studimi përfshin analizën e të dhënave parësore dhe dytësore. Përdorimi i kësaj metode është vlerësuar si më e përshtatshme për të analizuar eksperiencën e përvojën e gjatë të ofruesve të shërbimeve për viktimat e trafikuar në Shqipëri.

Gjithashtu kjo metodë cilësore e përzgjedhur është e përshtatshme edhe për shkak të natyrës tepër të ndjeshme dhe delikate të çështjeve që përfshihen në këtë studim. Nisur nga problematika që ka ekzistuar ndër vite, mund të themi se ka pak studime në këtë fushë. Ndër këto studime, më të rëndësishme mund të përmendim: Study On The Social Reintegration Of Victims Of Trafficking In Albania, June 2009; Beyond trafficking The re/integration of trafficking victims in the Balkans, botimi me Qershor 2015; Organizata “Të ndryshëm e të barabartë”; Procesi i riintegritimit të ish viktimave të trafikimit njerëzor, Tiranë 2006 ; Raport Për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave, Janar-Dhjetor 2011; Trafikimi, rasti i Shqipërisë, 2006; Doraci i Ofruesve të Shërbimeve për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Qershor 2008; Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017; Raporti i Zhvillimit dhe zbatimi i legjislacionit shqipëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Tiranë 2009; Kuadri ligjor mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore, Shkurt 2013; Përfshirja sociale përmes integritimit në punë, Mars 2010.

Dallimi i metodës cilësore nga ajo sasore qëndron në faktin që e para është deduktive, ndërsa e dyta induktive dhe ky fakt është mbajtur në konsideratë gjatë gjithë studimit. Një përjasje deduktive është ajo që kalon nga një teori ose hipotezë në vëzhgime empirike, në konkluzione. Përjasja induktive ndjek rrugën e anasjelltë, pra, kur vëzhgimi i paraprin

hipotezës, teorisë dhe interpretimit. (Jane Ritchie, Jane Lewis, Qualitative Research Practise: A Guide for Social Science Students and Researchers, Sage, 2003, fq. 106)

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh qëllimin e studimit për të treguar e nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm të ofruesve të shërbimeve në procesin e riintegrit, por jo vendimtar në arritjen e suksesshme të këtij procesi, pa patur fillimisht edhe bashkëpunimin e organizmave qeveritarë të viktimave të trafikimit, u pa e nevojshme përdorimi i analizës së të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore, si fazë e dytë e studimit, ka përfshirë studime, raporte, vlerësime për situatën aktuale të vajzave të trafikuar në Shqipëri dhe kjo është bërë gjatë etapës së fokusimit në rishikimin dhe shqyrtimin e literaturës, në aspektin teorik dhe praktik të saj.

Në studimin ekzistues, për sa i përket punësimit, si faktorë kryesor i procesit të riintegrit, faktet tregojnë se përqindja e vajzave viktime të trafikimit jo të punësuar është më e lartë se vajzat e punësuar, të cilat përbëjnë 56 % të të punësuarave në sektorin privat (Study On The Social Reintegration Of Victims Of Trafficking In Albania, 2009 fq 42). Duke iu referuar studimit të Organizatës “Të ndryshëm e të barabartë”, citohet se nga 70 vajza viktime të trafikuar (VeT) e të intervistuar, prej të cilave, vetëm 44.4 % e tyre janë punësuar pas largimit nga strehëza. Nga këto vajza Vet rezultojnë se vetëm 50 % e grupit të atyre që janë punësuar kanë patur vetëm një punë, ndërsa 25 % e vajzave viktime trafikimi kanë patur dy punë në vende të ndryshme dhe 15 % janë punësuar në tre punë të ndryshme. (Organizata “Të Ndryshëm e të barabartë”, Proçesi riintegrit të ishviktimave të trafikimit njerëzor, Tiranë 2006. Fq. 62)

Qëndrueshmëria financiare për vajzat viktime trafikimi, është konsideruar si faktori më i rëndësishëm e primar në realizimin e suksesshëm të procesit të riintegrit. Përdorimi i metodës cilësore më ka ndihmuar në krijimin e një perspektive teorike, e cila ka drejtuar pyetjet kërkimore të studimit mbi riintegrimin e vajzave viktime trafikimi, për të adresuar deri diku pyetjen e parë kërkimore për situatën aktuale të vajzave viktime trafikimi (Vet).

Gjithashtu, ja dhe informacioni rreth numrit të rasteve të reja të viktimave të trafikimit të asistuar çdo vit nën TVRP, nga viti 2007 deri 2014:

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
D&E	30	37	24	44	23	42	33	40	273
Tjeter Vizion	16	10	7	12	9	22	27	27	130
Vatra	-	-	-	-	-	37	37	39	113
TOTAL	46	47	31	56	32	101	97	106	516

(Beyond trafficking The re/integration of trafficking victims in the Balkans, botimi me Qershor 2015)

Sipas të dhënave, gjatë vitit 2011 janë identifikuar 84 viktima të mundshme trafikimi, nga të cilat 45 të rritur dhe 39 të mitur; në 2012 janë identifikuar gjithsej 92 viktima të mundshme, nga të cilat 26 janë të mitur dhe 66 të rritur; ndërsa në 2013 janë identifikuar 95 viktima të mundshme trafikimi, nga të cilat 52 të rritur (të gjitha gra) dhe 43 të mitur (nga të cilët 14 meshkuj). (Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave e Plani i Veprimit 2014-2017) është shtuar e thelluar më tej përmes intervistave me ofruesit e shërbimeve, prej të cilëve jemi njohur edhe me një numër të madh faktorësh të jashtëm që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj problemit.

Analiza e të dhënave nga intervistat si dhe nga studimi në tërësi, evidenton faktorë që, jo vetëm pengojnë procesin e riintegritimit të viktimave të trafikimit, por bëhen pengesë për realizimin e objektivave të vendosura nga organizatat joqeveritare. Për aspekte të tjera kërkimore të studimit, si dhe për të mësuar më shumë mbi përvojat e vajzave të trafikuar, për të kuptuar më mirë kontekstin brenda të cilit këto përvoja zhvillohen, janë realizuar intervista gjysmë të strukturuar me vajzat viktima trafikimi të riintegruara dhe në proces riintegrimi.

Pjesë e studimit ka qenë edhe përzgjedhja e tre fokus grupeve të organizuara me anëtarët e stafit që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për VeT, të cilët sollën dhe krahasuan idetë e tyre të gërshetuara kjo me eksperiencën shumë vjecare në ofrimin e shërbimeve për vajzat viktima trafikimi. (David L. Morgan, Focus Groups, fq 5).

Qëllimi i përfshirjes së këtyre fokus grupeve në këtë studim ka qenë për të kuptuar më mirë specifikat, ngjashmëritë, të përbashkëtat e dallimet në lidhje me fenomenin e trafikimit në shqipëri, si dhe problematikat që hasin vajzat viktime të trafikuar në procesin e riintegrit në shoqëri.

Pyetjet e diskutimet në fokus grup më ofruan informacion të detajuar dhe më krijuan mundësinë që ofruesit e shërbimeve të drejtëpërdrejta (OJF) të më jepnin përgjigje më të hollësishme dhe më shumë detaje rreth vështirësive që përballëshin vajzat viktime të trafikuar në procesin e gjatë e të vështirë të riintegrit .

Mënyra e organizimit të fokus grupeve si dhe natyra e pyetjeve të përdorura ndihmuan ofruesit e shërbimeve sociale të kujtojnë përvojat e eksperiencën e tyre të gjatë në këtë fushë si dhe t'i krahasojnë mendimet e opininet me njëri-tjetritin (Richard A. Krueger, *Developing Questions for Focus Groups*, kit 3, Sage, 1997, fq 38).

Organizimi I fokus grupeve u dha mundësi ofruesve të shërbimeve sociale për vajzat viktime trafikimi të ndiheshin të lirë e të kuptonin më mirë qëndrimin e njeri – tjetrit, si dhe të ishin më të qartë në përgjigjet që jepnin.

Metoda cilësore e përdorur në studim më ndihmoi për të kuptuar në thellësi shkaqet e vërteta dhe rolin që kanë shërbimet sociale rezidenciale në këtë proces të gjatë e të vështirë për tu realizuar me efikasitet. Me anë të kësaj metode janë shpjeguar sfidat me të cilat duhet të ndeshen punonjësit e shërbimeve sociale kur trajtojnë një vajzë viktime trafikimi në proces riintegritimi.

Avantazhi kryesor i kërkimeve cilësore është se ato na ofrojnë mundësinë për të kuptuar e eksploruar më thellë popullatën nën studim.

Në kërkimin cilësor, vlen të evidentojmë e të nxjerrim në pah se çdo rast është i vlefshëm për t'u marrë në studim. Çdo rast është përfaqësues i eksperiencave specifike të jetës së një personi dhe interpretimit të këtyre eksperiencave, pra, përfaqëson të vërtetën dhe realitetin për atë person. (Jane Ritchie, Jane Lewis, *Qualitative Research Practise*, fq. 54)

2.7. Përdorimi i metodës cilësore në këtë studim

* Në lidhje me këtë fenomen, mbledhja dhe analiza e të dhënave u realizua me efikasitet duke përdorur intervista gjysëm të stukturuara, duke u dhënë kështu mundësinë të intervistuarve që të flisnin për një numër temash në mënyrën e tyre.

* Metoda cilësore na ndihmon të kuptojmë e të njihemi me përjetimet personale të vajzave viktime trafikimi rreth këtij fenomeni dhe, në rastin konkret, na lejon të kuptojmë se ç'ndodh me përjetimet personale të vajzave viktime trafikimi (Vet) në lidhje me procesin e riintegrit.

* Procesi i riintegrit të viktimeve të trafikimit në Shqipëri është një çështje e mprehtë e delikate, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar dhe metoda cilësore ndihmon pikërisht kur studiohet një çështje e tillë delikate.

* Në këtë proces të gjatë e të vështirë siç është riintegritimi i vajzave viktime trafikimi, një rol kyç kanë ofruesit e shërbimeve sociale për të eksploruar këtë fenomen e proces që nuk është studiuar më parë dhe që mund të zhvillohet në mënyrë kuantitative më vonë.

* Riintegritimi i viktimeve të trafikimit të shfrytëzuara brenda Shqipërisë, është një sfidë e madhe e këtij studimi. Duke qenë se Shqipëria kategorizohet si një “vend i vogël”, problemi kryesor është që vajzat viktime trafikimi të njihen nga njerëzit e qyteteve, të cilët i etiketojnë si “prostituta” dhe ky fakt vështirëson përfshirjen e tyre në jetën shoqërore. Prandaj metoda që domosdoshmërisht kam aplikuar në këtë studim, është metoda cilësore, si një metodë efektive në sigurimin e informacionit specifik dhe kuptimin më gjerë e të thelluar në eksplorimin e problemeve kryesore që përballen vajzat viktime trafikimi.

* Është e njohur që procesi i riintegrit është i lidhur me institucionet që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për VeT dhe, në këtë rast, metoda cilësore është përdorur për t'u thelluar në këtë çështje që na intereson dhe na jep mundësinë ta shikojmë problemin në këndvështrime të ndryshme.

* Për të kuptuar përse hasin vështirësi të mëdha viktime e trafikuar për t'u integruar në shoqëri, është përdorur metoda cilësore si një metodë e cila aplikohet e ushtrohet kur duam të eksplorojmë në thellësi një fenomen.

* Metoda cilësore përdoret kur konsiderimi i kontekstit natyror të një çështjeje është i rëndësishëm dhe, në rastin tonë, e drejta për të pasur një jetë të pavarur e të integruar si çdo vajzë viktimë trafikimi do të dëshironte, është një e drejtë natyrore për këdo, pa dallime gjinie, race dhe feje apo etnie.

* Në studimin tonë ofruesit e shërbimeve janë ato që japin arsyet në vështirësitë që ndeshin vajzat gjatë procesit të riintegritimit . Përdorimi i metodës cilësore në këtë studim na jep një panoramë më të detajuar për të “kuptuar” më mirë fenomenet sociale nga perspektivat e aktorëve të përfshirë në këtë proces riintegritimi, sesa ato mund të shpjegohen së jashtmi.

* Procesi i riintegritimit të VeT është një proces ku të dhënat statistikore nuk mund të shpjegojnë në mënyrë të hollësishme, thellësinë e këtij procesi të gjatë e kompleks sic është procesi i riintegritimit të vajzave të trafikuar në shoqërinë shqipëtare. Ndaj, është parë me efikasitet përdorimi i metodës cilësore si një metodë që vjen në ndihmë për të kuptuar fenomene komplekse që janë të vështira ose të pamundura të kapen në mënyrë sasiore. (Scot W. Vanderstoep, Deirdre D. Johnston, *Research Methods for Real Life: Blending Qualitative and Quantitative Approaches*, Jossey Bass, San Francisco, 2009, fq. 142).

Një informacion të pasur dhe të gjerë rreth problematikave që hasin vajzat e trafikuar gjatë procesit të riintegritimit është siguruar pikërisht nëpërmjet përdorimit të analizës cilësore së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Disa aspekte që shqyrtohen në këtë studim janë sfidat me të cilat përballen vajzat viktimë të trafikimit si dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqërinë tonë për këtë kategori.

2.8. Popullata e përfshirë në studim dhe kampioni i përzgjedhur

Në fokus të këtij studimi kanë qenë vajzat viktimat trafikimi në proces riintegritimi që asistoheshin aktualisht në qendrat sociale “Vatra”, dhe “Të ndryshëm e të barabartë”, si dhe vajzat që kishin vite që ishin asistuar në qendrat rezidenciale dhe aktualisht ishin jashtë shërbimit.

Për të patur një panoramë të qartë e të plotë rreth këtij procesi, si dhe për të marrë më tepër njohuri rreth përceptimit të institucioneve në lidhje me këtë situatë, u pa e nevojshme përdorimi i intervistave me personat kyç.

Persona kyç janë konsideruar ata individë të cilët kanë njohuri të gjerë në fushën e shërbimeve sociale që ofrohen për viktimat e trafikuar, të cilat kanë aftësitë për të hartuar politika të posaçme sociale për t'i ardhur në ndihmë vajzave viktimë të trafikuar. Këta persona kyç janë përfaqësues të institucioneve politikëbërëse në këtë fushë, që karakterizohen nga kreativiteti si dhe kriticizmi ndaj realitetit të vajzave viktimë trafikimi.

Qëllimi i intervistimit të tyre ka qenë mbledhja e informacionit nga një rang më i gjerë njerëzish, pasi, këta persona janë edhe hartues apo zbatues të politikave të strategjive Kombëtare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në komunitet. Me njohuritë e tyre specifike rreth kësaj çështje të marrë në studim, ekspertet (<http://healthpolicy.ucla.edu>), mund të japin rekomandimet dhe sygjërimet e nevojshme për reduktimin dhe minimizimin sado pak për zgjidhje të problemit. Ato mund të ofrojnë informacione të larmishme rreth natyrës së problemit.

Intervistimi u realizua me përfaqësues të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Socialë të rrethit të Elbasanit, me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që operojnë drejtëpërdrejtë me vajzat viktimë trafikimi e që kanë në fokus të punës së tyre programet e procesit të riintegrit. Ky fakt më ndihmoi në mbledhjen e një informacioni sa më të gjerë e të larmishëm. Informacioni i servirur nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe dy përfaqësues të shërbimit social shtetëror më ndihmoi të krijoj një tablo më të qartë të përvojave të punës së tyre në lidhje me procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar VeT. Në këtë mënyrë, më ofruan informacione rreth natyrës së problemit që hasin vajzat e trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual në realizimin me sukses e me efikasitet të procesit të gjatë të riintegrit në shoqëri. Informacioni i ofruar nga vajzat e trafikuar që asistohen në strehëz dhe që janë pjesë e programit të riintegrit, nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe nga përfaqësuesit e Shërbimit Social Shtetëror më orientuan për të qenë më e qartë në adresimin e rekomandimeve për zgjidhjen e problemeve të marrë në shqyrtim.

2.9. Shtrirja në hapësirë e studimit

Studimi u krye në tre qendrat sociale që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikuar, në programin e të cilave përfshihet dhe procesi i riintegrit të VeT, në qendrën psiko - sociale “ Vatra” që ndodhet në qytetin e Vlorës, në qendrën sociale “Tjetër Vizion” që ndodhet në qytetin e Elbasanit dhe në organizatën “ Të ndryshëm e të Barabartë” që ndodhet në qytetin e Tiranës.

Arsyeja kryesore e përzgjedhjes së këtyre qendrave sociale lidhet me faktin se janë të vetmet qendra që përfshijnë në paketën e tyre të shërbimeve programe të posacme të procesit të riintegrit për vajzat viktime trafikimi . Qendra Kombëtare Pritëse për viktimat e trafikuar që ndodhet në Linzë të Tiranës, nuk ka qenë pjesë e përfshirjes së studimit, pasi kjo qendër nuk ofron në paketën e shërbimeve programin e riintegrit të VeT. Qëllimi i kësaj qendre kosiston në sigurinë për jetë të vajzave të trafikuar.

Ajo mbetet një ndër qendrat e sigurisë së lartë, pasi dhe vajzat e trafikuar që asistohen në këtë qendër kanë probleme ligjore ndaj personave që i kanë trafikuar.

Në momentin që rastet e vajzave të trafikuar që asistohen në Qendrën Kombëtare Pritëse për Vet në Tiranë , vlerësohen nga stafi që rrezikshmeria e tyre nuk është aq e lartë, atëherë këto raste transferohen në një ndër qendrat sociale që ofrojnë programin e riintegrit për vajzat viktime të trafikimit .

Të dhëna të përgjithshme për pjesëmarrësit në studim

Në Tabelën 1 tregohet shpërndarja e ofruesve të shërbimeve të përfshirë në studim sipas organizatave që operojnë:

Organizatave	Total pjesëmarrje	Koordinator OJF/ Drejtues Institucioni	Punonjës OJF
D&E	5	1	4
Tjetër Vizion	3	1	2

Vatra	5	1	4
Përfaqësues të DRSHSSH EL	2	-	2
Total	15	3	12

Në Tabelën 2 tregohet shpërndarja e viktimave të trafikuarra të përfshira në studim sipas organizatave që asistohen apo që janë asistuar më parë :

Organizatat	Total pjesëmarrje	VeT pjesë e procesit të riintegrit	VeT të riintegruar
D&E	41	14	27
Tjetër Vizion	43	-	43
Vatra	37	12	25
Total	121	26	95

2.10. Kriteret e përzgjedhjes së të intervistuarve

2.10.1. Informuesit kyç

Në fazën e parë të studimit është bërë përfshirja e informuesve kyç në lidhje me procesin e riintegrit. Përfaqësuesit e institucioneve qeveritare e joqeveritare, që merren drejtëpërsëdrejti me hartimin e zbatimin e politikave sociale për riintegritin e vajzave të trafikuarra në shoqëri duke përmirësuar cilësinë e jetës së këtyre vajzave, më ndihmuan në marrjen e informacionit të bollshëm e të detajuar në lidhje me politikat sociale që ndiqen për riintegritin e viktimave të trafikimit.

Informuesit kyç më informuan dhe për punën e bërë nga institucionet qeveritare për zbatimin e strategjisë kombëtare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ku qëllimi kryesor është përmirësimi i kushteve të jetesës së këtyre vajzave (VeT) në komunitet. Gjithashtu informuesit kyç të këtij studimi që janë koordinatorët e organizatave jofitimprurëse na prezantuan nga afër duke na njohur edhe me e punën e bërë nga ana e tyre gjatë pesë viteve të fundit, duke na ofruar statistika në lidhje me fenomenin në studim.

Studimit iu bashkangjit në këtë fazë edhe informacioni i marrë nga drejtuesit e Organizatave joqeveritare, të cilët nëpërmjet projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare kanë përfshirë programe pune të posaçme për realizimin me sukses të procesit të riintegritit të vajzave të trafikuar (VeT) për qëllime shfrytëzimi në shoqëri. Realizimi i intervistave me të gjithë të intervistuarit më njohu me sfidat që institucionet kanë në lidhje me zbatimin e politikave në realizimin e strategjive; me fakte e statistika të asistimit të vajzave në shelter si dhe statistika të përgjithshme rreth shërbimeve që këto vajza kishin përfituar gjatë kohëqëndrimit në strehëz; me punën e vazhdueshme për sensibilizimin e komunitetit të gjërë, për të denoncuar rastet kur shfrytëzoheshin për qëllim trafikimi. Këto objektiva rezultojnë të jenë edhe sfidat kryesore të strategjisë për të cilat institucionet shtetërore akoma punojnë.

Intervistat me personat kyç më ndihmuan që në fazën e parë të krijoja një ide më të qartë rreth problematikave që hasin vajzat e trafikuar në procesin e riintegritit, gjithashtu më familjarizuan me politikat e nismat që ndërmernin vetë qendrat sociale në lidhje me sensibilizimin, nxitjen dhe mbështetjen ndaj këtyre vajzave viktime trafikimi (VeT). Të dhënat e marra nga Organizatat Jofitimprurëse më krijuan një tablo më të qartë rreth asaj që më duhej të ndiqja në vijim të studimit.

Intervistat me përfaqësues të shoqatave në studim më njohën, me punën e tyre si dhe me paketën e programeve që ofronin për vajzat viktime trafikimi gjatë procesit të riintegritit në shoqëri.

Intervistat e realizuara me ofruesit e shërbimeve më ndihmuan të njihem dhe me përpjekjet e tyre lobuese për të drejtat e përfshirjes së vajzave viktime trafikimi në jetën e gjërë sociale. Në analizën e intervistave u ndesha me një sërë problematikash sociale, me të cilat ndesheshin realisht vajzat e trafikuar në shoqëri.

2.10.2. Vështirësitë e studimit

Gjatë intervistimit u hasa me disa vështirësi, ndër të cilat, përmend:

* Vështirësi të karakterit burokratik. Intervistuesit e ofruesve të shërbimeve sociale e përfaqesuesit e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në rrethe nuk jepnin intervistë pa u pajisur më parë me leje nga titullarët përkatës për realizimin e këtij studimi.

* Mungesë gatishmërie për t'u intervistuar nga përfaqësues të politikbërjes të cilët janë përgjegjës drejtëpërsëdrejti në hartimin e politikave sociale.

* Mos të paturit besim në regjistrimin e intervistave. Kryesisht punonjësit e ofruesve të shërbimeve nuk pranonin të regjistroheshin me diktofon gjatë zhvillimit të fokus grupit. Edhe pas informimit të ofruesve të shërbimeve rreth arsyes përse studiusja duhej të mbante të regjistruar bisedën që do të zhvillohej me to, që lidhej drejtëpërsëdrejti me qëllimin e studimit, në dy organizata që ofronin shërbime sociale për vajzat viktime trafikimi refuzuan mbajtjen e regjistruarit. Ky fakt u respektua nga unë dhe intervistat u mbajtën shënim me shkrim.

2.11. Kampionimi

Për t'u dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve kërkimore, atëherë kampionimi në këtë rast shërben si një nëngrup i popullatës së marrë në studim. Kampionimi i marrë në këtë studim, ka qenë i tillë që të mund t'u japë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura nga studiuësja. Zakonisht, dihet se kampioni në kërkimet cilësore është më i vogël se kampionimi që përdoret në kërkimet sasiore (Luis Cohen, Lawrence Manion, Keith Morrison, Research Methods in Education, Routledge, 2007, fq. 143).

Studiuësist kur arrijnë ti bazojnë intervistat e tyre në studim në kërkimet cilësore, atëherë në pjesën dërrmuese të rasteve ato propozojnë kampionimin pa probabilitet. Si nën pjesë e kampionimit pa probabilitet është kampionimi i qëllimshëm, Ky lloj kampionimi i qëllimshëm është përdorur në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në shqipëri”, pasi është i vetmi kampionim që është parë nga unë si më adeguati e më i përshtatshmi, për t'u përgjigjur pyetjeve kërkimore që

kisha ngritur në studim. Kampionimi i qëllimshëm (pjesë e kampionimit jo probabilitar) më ka siguruar në këtë studim një informacion të larmishëm e shumë të detajuar për të kuptuar fenomenin e marrë në studim.

Kampioni në këtë studim prezanton karakteristikat e kërkuara, prandaj dhe është një kampionim i qëllimshëm. Në këtë lloj kampionimi të qëllimshëm të përzgjedhur nga une, kampionimi përfaqëson vetveten dhe jo popullatën e gjerë (Cohen et al., Research, fq. 56). Kjo metodë cilësore që është përdorur në studim, më ka mundësuar që të përzgjedhë me dëshirë individë, që unë mendoj e gjej se mund ti përgjigjet të gjithave pyetjeve kërkimore të ngritura në studim.

Individët e përzgjedhur në studim, kanë qenë pjesë e studimit me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe kanë arritur ti përgjigjen pyetjeve kërkimore (Ritchier; Lewis; 2003; fq. 79).

Metoda cilësore e realizuar në këtë studim ka bërë të mundur përzgjedhjen e kampionit të qëllimshëm, duke marrë parasysh se përgjigjet e të intervistuarve janë ato që hedhin dritë mbi çështjet fundamentale të kërkimit në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri”.

Qëllimi i kampionimit pa probabilitet kosiston në marrjen sa më shumë të informacioni të thelluar e të detajuar nga pjesëmarrësit.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të eksplorojë në mënyrë të detajuar e të përshkruajë hollësisht arsyet që i çojnë vajzat viktime të trafikimi që të mos e shohin asistimin në qendra rezidenciale si element primar dhe përfundimtar të procesit të riintegritit të plotë. Kampionimi teorik arrin ta ndërtojë teorinë e tij nga mbledhja dhe analizimi i të dhënave dhe më pas arrin të përzgjedh intervistues të rinj për ta analizuar dhe për ta marrë nën shqyrtim këtë teori (Joan Joseph Castillo, Systematic Sampling, 2009).

Kampionimi teorik lidhet me përzgjedhjen e rrugëve të reja të kërkimit, në mënyrë që zbulimet e reja të kërkimit të marrë në studim të krahasohen me studimet që janë realizuar tashmë më parë. Ky lloj kampionimi mbetet një ndër mjetet kryesore të kërkimit cilësor (Glaser, Barney G & Strauss, Anselm L. The Discovery of Grounded Theory: Strategies for Qualitative Research, Aldine Publishing Company, Chicago, 1967, fq. 85).

Organizimi i fokus grupeve me përfaqësuesit e organizatave jo fitimprurëse që kanë pjesë të punës së tyre, programin e procesit të riintegritimit për vajzat viktime trafikimi , mbetet pjesa më shumë e rëndësishme në këtë studim.

Realisht u formuan tre fokus grupe, sipas organizatave jo fitimprurëse të marra në studim. Duke patur parasysh qëllimin e studimit “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në Shqipëri”, u hartuan intervista e fokus grupeve në kërkimin cilësorë si një ndër instrumentat kryesore që përdoren dhe që njëkohësisht lejon pjesëmarrësit në këtë studim të pyeten për çdo detaj duke përfshirë këtu, aspektet emocionale, mënyrën sesi ato perceptojnë këtë fenomen të marrë në studim, perceptimet, mendimet, besimet dhe qëndrimet e tyre pozitive dhe negative ndaj shërbimeve sociale që ofrojnë për viktimat e trafikuar si dhe për mendimet e sygjërimet optimiste që kanë për të ardhmen e këtyre vajzave viktime trafikimi.

Intervistat e realizuara në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në Shqipëri” karakterizohen nga një shkallë e lartë besueshmërie e vlefshmërie. Rezultatet të cilat janë të një besueshmërie të lartë, përmbajnë një kosto të ulët.

Madhësia e kampionit në këtë studim rritet dhe kjo si pasojë rrjedh që rezultatet e studimit përfitohen më shpejt. Meqenëse në këtë studim madhësia e kampionimit rritet, faktorë për këtë element ndikon drejtëpërsëdrejti dhe intervistimi njëherazi të disa pjesëmarrësve në studim (Catherine Marshall, Gretchen B. Rossman, Designing Qualitative Research, Copyrighted Material, 1999, fq. 39).

Analiza e të dhënave të këtyre intervistave ka bërë që të lindin pyetje të tjera tek studiuesja, rreth shqetësimeve e sfidave të vajzave në jetën e tyre sociale, perceptimeve për problemet që burojnë nga stigmatizimi dhe paragjykimimi i popullsisë për viktimat e trafikuar.

2.12. Numri i intervistave

Janë realizuar gjithsej 15 intervista (fokus grupe) me persona përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe përfaqësues të Organizatave Joqeveritare, të cilat operonin në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ndihmë të këtij target grupi.

Janë relizuar gjithsej 121 intervista gjysmë të strukturuar me viktimat të trafikimit të riintegruara e në proces riintegrimi, prej të cilave 95 raste ishin riintegruar dhe 26 raste ishin pjesë e programit riintegrimit brenda shërbimeve sociale .

Intervistave gjysmë të strukturuar që u përdoren në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegrimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” , përmbajnë pyetje të mbyllura e të hapura si dhe rrëfime personale të vetë vajzave viktimave të trafikuar.

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave (vajza viktimat trafikuara) janë marrë në konsideratë dhe janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme 10 (dhjetë) parimet që udhëzojnë çështjet që lidhen me etikën e target grupit të marrë në studim (WHO ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women. London School of Hygiene and Tropical Medicine, London: Daphne Program of the EU, 2003).

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave janë shqyrtuar gjithashtu një mori dokumentash strategjike që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me çështjet e trafikimit të genieve njerëzore, kryesisht të vajzave viktimat trafikuara të shfrytëzuara për qëllime seksuale.

Duke marrë në konsideratë faktin se vajzat viktimat trafikuara konsiderohen si target grupe “vulnerabël” , janë siguruar nga personi im, se nuk do të ekspozohen ndaj ndonjë rreziku.

2.13. Hartimi i instrumenteve të kërkimit

Metodologjia e përdorur për të mbledhur e për të përpunuar të dhënat lidhet se tepërmi me qëllimin e studimit. Tashmë dihet, se në kërkimet cilësore metoda më e përshtatshme për të mbledhur e analizuar të dhënat e studimit mbetet intervista.

Intervista është një proces i cili konsiston në pyetjet që studiuesja realizon ballë për ballë me personin e intervistuar duke i servitur një mori informacioni në bazë të përgjigjeve të tij. Intervistat përdoren për të dhënë një pamje të qartë e të hollësishme të realitetit, në mënyrën e të perceptuarit të pjesëmarrësve në studim.

Intervistat janë të vetmet që na paraqesin qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me fenomenin e marrë në studim (Cohen et al., Research Methods, fq. 147). Ato janë mjete fleksibile për mbledhjen e përpunimin e të dhënave .

Në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri” është përdorur intervista gjysmë e strukturuar. Kjo lloj interviste njihet ndryshe si interviste udhërrëfyese.

Në momentin që studiuesi zotëron informacion të detajuar rreth fenomenit të trafikimit të genieve njerëzore apo ka informacion rreth dukurive që do të marrë të dhëna , atëherë në këto raste përdoret intervista udhërrëfyese.

Në lidhje me studimin në fjalë, intervistuesja, në përvojën e saj të madhe ka arritur të sigurojë duke u pasuruar me informacion të përgjithshëm për situatën e vajzave viktime trafikimi në vendin tonë. Ky informacion është arritur të mblidhet si nga konsultimet e realizuara drejtëpërsëdrejtë me ofruesit e shërbimeve sociale për viktimat e trafikuar ashtu edhe nga rishikimi i hollësishëm i studimeve të mëparshme të kryera në vendin tonë, për çështjet që lidhen kryesisht me fenomenin e trafikimit dhe me procesin e riintegritit të vajzave të trafikuar, si Study On The Social Reintegration Of Victims Of Trafficking In Albania, June 2009; Beyond trafficking The re/integration of trafficking victims in the Balkans, botimi në Qershor 2015; Organizata “Të Ndryshëm e të barabartë”; Procesi i riintegritit të ish viktimave të trafikimit njerëzor, Tiranë 2006; ashtu edhe nga të dhëna statistikore të marra në faqen e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta .

Intervista gjysmë e strukturuar si element i mbledhjes së informacionit që është përdorur në këtë studim, i adreson pyetjet duke respektuar probleme të caktuara dhe i shtron ato në një mënyrë më të hapur sesa intervistat e tjera.

Intervistat gjysmë të strukturuar u përdorën nga unë, kur duhet të mësojmë më shumë rreth përvojave jetësore dhe eksperiencave personale të pjesëmarrësve në studim. Këto intervista luajnë rol fundamental në eksplorimin e njerëzve dhe në marrjen e sa më shumë informacion rreth çështjeve që lidhen me studimin.

Pyetjet në fokus grupe me përfaqësuesit e organizatave e të drejtorive të Shërbimit Social Shtetëror, janë organizuar për të mbledhur informacione të ndara në tre seksione:

1. ***Seksioni i parë:*** Përfshihen të dhënat e përgjithshme , vendin e punës, profesionin, kohën e punësimit në strehëz ose të perfaqesuesve të shërbimit social shtetëror (SHSSH).

2. ***Seksioni i dytë:*** Përfshin të dhënat mbi shërbimet riintegruese të ofruara për vajzat viktime trafikimi (VeT) , si p.sh. institucionin ku ato operojnë, sa është i përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore; a vijnë paralelisht programet e riintegrimit të ofruara për vajzat viktime trafikimi (VeT) nga organizata juaj me nevojat specifike të tyre; cilat janë sfidat me të cilat përballen vajzat e trafikuar gjatë procesit të riintegrimit, etj.

3. ***Seksioni i tretë:*** Përfshin masat e marra nga institucionet qeveritare për riintegrimin e vajzave të trafikuar (VeT) si dhe problemet që janë kostatuara nga ana e tyre. Ndarja e pyetjeve, sipas kësaj mënyre, më ka ndihmuar në qartësimin e situatës reale të vajzave VeT si dhe të vështirësive që hasin keto vajza viktime të trafikimit gjatë procesit të riintegrimit në shoqëri. Përpjekjet institucionale që janë bërë për realizimin me sukses të procesit të riintegrimit për vajzat VeT si dhe ndryshimet e bëra nga politikbërja gjatë këtyre viteve.

Pyetjet e organizuara për viktimat e trafikuar në proces riintegrimi apo vajzave që ishin aktualisht pjesë e programit të riintegrimit, u ndanë në tre seksione. Intervistat që u përdorën për këto vajza viktime trafikimi (VeT) ishin ato gjysëm të strukturuar, të cilat në thelbin e tyre përmbanin pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura.

1. ***Seksioni i parë*** përfshin të dhënat e përgjithshme, gjeneralitetet e vajzave të trafikuar, si mosha, vendlindja, arsimimi, etnia, gjendja civile e fëmijët që kishin në ngarkim.

2. **Seksioni i dytë** përshin shërbimet që këto vajza kishin përfituar apo që ishin duke përfituar aktualisht, si strehëza ku ato ishin asistuar aktualisht, apo më parë; çfarë shërbimesh kishin përfituar konkretisht në strehëz; koha kur nuk janë më pjesë e programit të shërbimeve sociale e vecanërisht pjesë e procesit të riintegrit; sa i kishin ndihmuar shërbimet e marra nga ofruesist e shërbimeve në jetën e tyre sociale.
3. **Seksioni i tretë** përfshin procesin e riintegrit, si vështirësitë që kanë hasur vajzat viktime trafikimi VeT në fillimet e procesit të riintegrit; nëse ishin të punësuar në sektorin privat a shtetëror dhe ku punonin; të ardhurat e tyre mujore; nëse kanë patur mbështetje në jetën e tyre dhe cilët kanë qenë mbështetësit kryesor të këtyre vajzave viktime trafikimi; nëse ishin ndjerë të rrezikuara për tu ricikluar sërish në shoqëri dhe si ndihen sot.

Marrja e informacioneve, sipas këtyre seksioneve, më ka ndihmuar në krijimin e një tabloje të qartë të situatës reale të vajzave viktime trafikimi . Ky informacion i ndarë në seksione më ka nxjerrë në pah një sërë faktorësh të pandeshur më parë në studimet e kryera, të cilat ndikon duke u bërë pengesa në riintegrimin e suksesshem të vajzave viktime trafikimi (VeT) në jetën sociale.

2.14. Hartimi i intervistës së fokus grupit

Intervistat në fokus grup luajnë një rol të rëndësishëm në “nxitjen e një komunikimi të hapur e bashkëpunues” midis të të intervistuarëve. Një mënyrë e tillë e të organizuarit të fokus grupeve më ndihmoi në sigurimin e një informacioni të thelluar e të lirë rreth fenomenit të marrë në studim.

Hartimi i një plani pune të ngritur nga unë rreth temave apo çështjeve që do të diskutohen më ndihmoi në punën time kërkimore duke përfshirë intervistat udhërrëfyes me fokus grupe (Richard A. Krueger, D. L., Morgan, The focus Group Kit. Thousand Oaks, Sage, California, 1998, fq. 51).

Intervistat udhërrëfyese në fokus grupe janë efikase dhe të dobishme pasi ndikojnë në stimulimin e mendimeve e ideve që pjesëmarrësit kanë me njëri-tjetrin për çështjet që lidhen me procesin e riintegritimit.

Fokus grupi na servir duke na ofruar të dhëna të ndryshme rreth çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, pasi të pranishmit në fokus grupe inkurajojnë duke nxitur idetë e mendimet nëpërmjet komunikimit verbal se si të flasim e të mendojmë (Morgan, D. L., *The Focus Group Guidebook*, Sage, London, 1998, fq. 65).

Fokus grupet më ndihmuan, të paraqesë në mënyrë të detajuar atë çka njerëzit me anë të përvojës së tyre të gjatë si ofruet të shërbimeve sociale për viktimat e trafikuar, të mendojnë duke i krahasuar këto me të dhënat ose me shifrat e ofruara nga studimet e realizuara më parë në lidhje me fenomenin në shqyrtim.

Me anë të këtij instrumenti të përdorur në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri” u bë e mundur mbledhja e të dhënave cilësore.

Fokus grupi mbetet alternativa më efektive e më efikase sesa intervistat e hollësishme e të detajuara, pasi ato mundësojnë përsëritjen e vazhdueshme dhe mbivendosjen e fakteve rreth çështjeve të marra në studim. (Morgan, D. L., *Focus Groups as Qualitative Research*, Sage, London, 1997, fq. 42).

Me anë të përdorimit të metodës cilësore, personi im, fitoi akses në eksplorimin e mendimeve e opinioneve nisur nga mënyra sesi organizohen fokus grupet me pjesëmarrësit. Ky element e më ndihmoi, që të gjeneroja sa më shumë ide lidhur me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe veçanërisht me procesin e riintegritimit të viktimave të trafikuar në shoqëri.

Inkurajimi dhe stimulimi i pjesëmarrësve të fokus grupit ishte një element i rëndësishëm që u përdor nga unë. Përdorimi i këtyre dy elementëve, më ndihmoi në nxitjen produktive të diskutimeve rreth jetës personale të vajzave viktimat trafikimi (VeT) dhe problematikave që këto vajza hasin në shoqëri gjatë realizimit me sukses të procesit të riintegritimit.

Kjo njihet si një formë efikase dhe e përshtatshme, e cila më ndihmoi që të arrij të mbledhë të dhëna njëkohësisht nga shumë pjesëmarrës që janë pjesë e kërkimit.

Intervistat me grupet e vogla kanë efikasitet e dobishmëri të lartë vetëm në rastet kur studiuesja vlerëson se qëllimi i studimit “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri” është të marrë të dhëna nga njerëz, të cilët në jetën e përditshme operojnë së bashku, dhe që shpesh herë hasen me përballimin e situatave të njëjta dhe kanë përgjegjësi të përbashkëta (Richard A. Krueger, Focus Groups: A Practical Guide for Applied Research, Sage, 1994, fq. 128). Ofruesit e shërbimeve sociale në studim janë pjesë shumë e rëndësishme e procesit të riintegritimit të vajzave viktimatrafikimi .

Çdo fokus grup kishte deri në 5 persona pjesëmarrës, sepse grupi me këtë përbërje gjeneron më shumë ide (Edward F. Fern, The Use of Focus Groups for Idea Generation: The Effects of Group Size, Acquaintanceship, and Moderator on Response Quantity and Quality”, Journal of Marketing Research, February, 1982, fq. 3).

Punonjësit e qendrave ishin pjesëmarrës në fokus grupe. Në realizimin e fokus grupeve, personi im mbajti në konsideratë, duke pasur parasysh atë që Wells (WilliamD. Wells, Group Interviewing, Handbook of Marketing Research, 1974, fq. 254) evidenton rreth mënyrës sesi ulen pjesëmarrësit në fokus grupe, respektimi me rigorozitet të çështjeve që lidhen kryesisht me etikën e deri tek ideali e madhësisë së fokus grupit.

Sipas, (Edward F. Fern, The Use of Focus Groups for Idea Generation, fq. 2) dihet se çelësin e suksesit të fokus grupit lidhet drejtëpërsëdrejtë me mënyrën sesi moderatori e organizon punën e tij me pjesëmarrësit. Ky ishte një element që unë i kushtova një rëndësi të madhe. Për këtë u pa e nevojshme të kontaktohej një specialist i fushës.

Gjithashtu, gjatë realizimit të fokus grupeve me pjesëmarrësit, unë kam arritur të ruajë në mënyrë të duhur ekuilibrat në lidhje me parimin e të mbajturave shënim dhe të shkuarit mirë të një fokus grupi. Ky element rezultoi të jetë shumë efikas dhe i rëndësishëm, duke më shërbyer si një laborator për bashkëveprim social (Frank I. Luntz, The Makings a Good Focus Group, Voice of Victory Pjesa II, 16 maj dhe 30 maj, 1994, The Polling Report, SHBA, fq. 159).

Krahas avantazheve të aplikimit të fokus grupeve me pjesëmarrësit, dhe mbledhjen e sa më shumë informacioneve rreth fenomenit të marrë në studim, një element që më është

dashur të punojë, kosiston në shmangien e disavantazheve që karakterizojnë realizimin me sukses të fokus grupeve. Ndër to, vlen të përmend:

- Mungesa e të shprehurit e ndonjë pjesëmarrësi, mund të ndikojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë duke shkaktuar pakënaqësi tek pjesa tjetër e fokus grupeve. Duke marrë në konsideratë sesa komplekse dhe të vështira mbeten çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht e vajzave kjo ndikon që një pjesëmarrës të heshtë ose të arrij të imponojë mendimet e tij ndaj pjesës tjetër të fokus grupit.
- Mungesa e gadishmërisë së disa anëtarëve të fokus grupit për të mos komunikuar në mënyrë të duhur me njëri-tjetrin.
- Prezenca e të gjithë anëtarëve, vështirëson realizimin me sukses të fokus grupit, duke krijuar një hendek në mungesën e të shprehurit lirshëm të disa individëve specifikë, duke mos evidentuar dhe treguar arsyet reale që pengojnë procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar.
- Realizimi i intervistave të fokus grupeve me pjesëmarrësit, nuk është një proces i lehtë që të regjistrohet me diktofon. Ai si proces, kërkon një kohë relativisht të gjatë për të realizuar me efikasitet, dhe njëkohësisht kërkon aftësi të lartë profesionale për të mbledhur e për të analizuar të dhënat.
- Të pasurit një regjistruar të bisedës me fokus grupet ndikon tek pjesëmarrësit duke i “bllokuar” atë në të shprehurit lirshëm të mendimeve dhe sygjërimeve lidhur me çështjen delikate e komplekse të marrë në studim.
- Duke patur në konsideratë faktin që pjesëtarët e fokus grupit janë pjesëtarë të një komuniteti, kjo ndikon në kufizimin e dhënies së informacionit të kërkuar me potencialin e duhur nga ana e pjesëmarrësve. Prania e personave të tjerë në intervistim ose në realizimin e intervistave të fokus grupeve ndikon në krijimin e paragjyqimeve të veçanta.

Në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegrit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” intervistat dhe fokus grupet që u realizuan kishin karakterin e një bisede normale.

Hapi i parë që u realizua me të intervistuarat dhe me pjesëmarrëset e fokus grupit kosistoi në falënderimin që unë i bëra në lidhje me marrjen pjesë të tyre në mënyrë vullnetare në këtë studim si dhe për dëshirën e mirë që pjesëmarrësit shprehen për të ndarë opinionet e mendimet e tyre rreth problemit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Pjesëmarrësve i'u paraqit një tablo, e detajuar e rolit të rëndësishëm të tyre në procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar për qëllime shfrytezimi seksual.

Më pas, të gjithë personave të cilët qenë pjesë e realizimit të këtij studimi iu prezantua qëllimi i studimit dhe mënyra se si të dhënat e marra nga intervistat e realizuara me ta do të përdoren për këtë studim.

Pjesëmarrësit u falenderuan dhe për kohën që ata i kushtuan studimit “Vlerësimi i procesit të riintegrit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” .

Të gjithë personat që ishin pjesë e intervistave dhe e fokus grupeve iu premtua se informacioni i dhënë prej tyre do të ruhej në kushte të plota fshehtësie.

I'u premtua të gjithë pjesëmarrësve, se do ti ruhej anonimiteti i tyre në këtë studim dhe se të dhënat e tyre do të trajtoheshin në kushte të plota konfidencialiteti. Për të realizuar këtë objektiv, nuk janë identifikuar apo përmendur emra të përfaqësuesve të shoqatave jofitimprurese që operojnë me viktimat e trafikuar. Thjesht janë përmendur institucionet ku ato operojnë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

E njëjta gjë iu premtua dhe vajzave viktime trafikimi gjatë intervistave të realizuara me to duke i siguruar se anonimiteti i tyre, të dhënat e tyre do të mbeteshin konfidencial. Ato janë përmendur në studim me organizatën në të cilën janë duke u asistuar aktualisht ose me organizatën jofitimprurëse që kanë qenë asistuar më parë.

Pjesëmarrësve u siguruan se, asnjë emër nuk do të bëhet publik në këtë studim, por do të përmendeshin, si p.sh., punonjësja sociale e D&E, koordinatorja ose punonjësja e SHSSH (do të identifikoheshin me emrin e organizatës që ato përfaqësojnë e pozicionin e tyre në punë).

Personat që morën pjesë në studim iu premtua se nuk do të mbahej shënim nga studiuesja asnjë informacion që nuk kishte lidhje me studimin ose me procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar. Gjatë prezantimit të studimit iu komunikua personave që morën pjesë në studim se mund të largoheshin me vullnetin e tyre të lirë në çdo moment të procesit të

intervistimit nëse nuk dëshironin të ishin pjesë e këtij studimi, gjatë periudhes së organizimit me fokus grupin.

Pasi personat që morën pjesë në studim kuptuan se mendimi dhe opinioni i tyre ishte shumë i rëndësishëm për studimin, ata u angazhuan maksimalisht në dhënien e sygjërimeve efikase për procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar në shoqërinë shqipëtare dhe për sfidat me të cilat këto vajza përballeshin në jetën e tyre të përditshme.

Trajtimi i pjesëmarrësve të fokus grupit me shumë respekt dhe konsideratë nga unë, ndikoi në nxitjen e interesin të tyre, të ndanin eksperiencën dhe përvojën me studiuesen. (Richard A. Krueger, M. A. Casey, Focus Groups: A Practical Guide for Applied Research, botimi IV, Sage, San Francisco, 2009, fq. 243).

Si përfundim, ajo ç'ka vlen të theksoj është fakti se cdo gjë që u tha dhe u evidentua nga personat që morën pjesë në studim nuk u ndryshua e nuk u keqinterpretua për asnjë motiv tjetër.

2.15. Instrumenti matës

Në këtë studim hartimi i instrumentave është bërë duke u mbështetur në punën e Holstein dhe Gubrium (1995). Janë përdorur “intervistat gjysëm të strukturara” me vajzat viktime trafikimi (VeT), të cilat nuk përqëndrohen në pyetje të strukturuar, por në teknika. Në intervista përfshihen dy elementë objektivë dhe subjektivë dhe janë intervista që drejtohen lirshmërisht. Elementi subjektiv konsiston se si intervistuesit do e interpretojnë “atë që duan intervistuesit dhe kanë mundësi të zhvillojnë mendimin e tyre mbi këtë perceptim, që mund të jetë edhe i gabuar”. Elementët objektivë lidhen kryesisht me diskutimin e zellshëm që realizohet midis të intervistuarve dhe intervistueses.

2.16. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Qëllimi i analizës së gjetjeve nga intervistat gjysëm të strukturuar me vajza viktime të trafikuar (VeT) dhe fokus grupet (ofruesit e shërbimeve sociale) e realizuara për këtë studim, ka të bëjë me identifikimin e problemeve që hasin vajzat viktime të trafikimit në

procesin e riintegrit, eksplorimin e mundësive dhe burimeve që ndihmojnë në një riintegrim të sukseshëm të vajzave viktime trafikimi (VeT) në shoqëri, në analizimin e sfidave dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara për këtë target grup.

Vlen të theksohet fakti se regjistrimi me diktofon i intervistave të realizuara me fokus grupet, edhe pse në fazën e parë hasi vështirësi dhe rezistencë për të mos u përdorur nga personat që morën pjesë në studim, më vonë ajo rezultoi të ishte një metodë efikase dhe e sukseshme. Pas një shpjegimi të hollësishëm e të detajuar të të gjithë personave që morën pjesë në studim në lidhje me faktin sesa i rëndësishëm është përdorimi i regjistrimit të bisedës për mua, në fazën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Më pas pjesëmarrësve të studimit, iu ritheksua fakti i ruajtjes dhe respektimit me rigorozitet i të dhënave të servitura nga ana e tyre në këtë studim. Pas shpjegimit në mënyrë të detajuar të pjesëmarrësve për të gjitha çështjet që lidhen kryesisht me etikën, arrita të siguroj dhe aprovimin e tyre për realizimin e fokus grupeve me regjistruar.

Realizimi i studimit me regjistruar më ka ndihmuar, të jem, më vigjilente ndaj faktit se cili prej të intervistuarve ishte më aktivë se pjesa tjetër, si janë shprehur ofruesit e shërbimeve në lidhje me programin e procesit të riintegrit të ofruar nga ana e tyre për vajzat viktime trafikimi (VeT).

Kjo metodë e përdorur, më ka ndihmuar, që të jem, e përqendruar tek personat që morën pjesë në studim, pothuajse gjatë gjithë procesit të intervistimit. Regjistrimi i bisedës me ofruesit e shërbimeve gjatë realizimit të fokus grupit më ka ndihmuar, duke arritur më mirë menaxhimin e intervistës me to (Edward F. Fern, The Use of Focus Groups for Idea Generation, fq.2)

Pas përfundimit me sukses të çdo interviste të realizuar me fokus grupet është bërë e mundur ekzaminimi në mënyrë të detajuar të gjithë asaj që është thënë e rithënë gjatë realizimit të procesit të intervistimit. Një rëndësi të madhe në këtë studim luajtën dhe mbajtja e shënimeve nga ana ime. Ato më ndihmuan duke më dhënë një panoramë të plotë rreth gjithë procesit dhe zhvillimit të intervistës me ofruesit e shërbimeve duke përfshirë këtu dhe reflektimet e tyre personale në lidhje me çështjen e marrë në studim .

Dy mbetën shtyllat më të rëndësishme në trajtimin me rigorozitet të procesit të mbledhjes së të dhënave :

Së pari, lidhet me faktin sesa të besueshme e të sakta janë të dhënat e mbledhura nga intervistat .

Saktësia e të dhënave ka të bëjë me përpikërinë, pastërtinë, besueshmërinë e riprodhimit të të dhënave. Këto të dhëna në mënyrë të pastër e të besueshme janë arritur të transkriptohen nga personi im. Për të qenë koherent me studimin e për të mbledhur e përpunuar të dhëna të sakta që lidhen vetëm me procesin e riintegrit të vajzave të trafikuarra i gjithë diskutimi me pjesëmarrësit e fokus grupeve u bazua vetëm në këtë çështje.

Në rastet kur biseda gjatë realizimit të fokus grupeve devijonte nga tema e studimit, atëherë personalisht, angazhohesha në ngritjen e pyetjeve të tjera që lidheshin me procesin e riintegrit të vajzave viktimat trafikimi (VeT) në shoqëri. Kjo gjë bëhej për të përfituar të dhëna sa më të plota e më të sakta. Në realizimin e diskutimeve me personat që morën pjesë në studim (fokus grupet) dolën në pah problemetika të tjera interesante që kishin lidhje tërthorazi e drejtëpërdrejtë me studimin në fjalë. Ky fakt, më ndihmoi që të nxjerr në pah një formë tjetër të studimit “Vlerësimi i procesit të riintegrit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuarra në shqipëri”, atë që njihet si elementi rastësor i studimit.

E dyta , lidhet me mënyrën sesi është realizuar strukturimi i mbledhjes e analizimit të të dhënave.

Ajo ç`ka është e evidente, qëndron në faktin se përdorimi i metodës cilësore në studim nuk kërkon një strukturim të lartë të mbledhjes së të dhënave, por përshtatet me strukturim të ulët.

Strukturimi lidhet me faktin sesa të përshtatshme janë metodat që përdoren në mbledhjen e të dhënave. Strukturimi më ndihmoi që të jem më fleksibile ndaj përshtatjes së të dhënave. Për të realizuar procedurën e vlerësimit të mbledhjes e të analizuarit të të dhënave, pyetjet që i drejtohen fokus grupit bëhen për të vëzhguar nëse metoda e marrë në studim ofron mundësinë për ta ndryshuar pyetjen gjatë diskutimeve me pjesëmarrësit. Është e rëndësishme që përmbajtja e përgjigjeve të personave që morën pjesë në studim të ruhet

derisa mblidhen të dhënat, ky element më ndihmoi që të shoh e të krahasoj të dhënat e studimeve që janë realizuar më parë me studimin në fjalë. Kjo mënyrë e të organizuarit të diskutimeve me pjesëmarrësit e fokus grupeve , më dha një ndihmë të madhe, në drejtimin dhe përcaktimin e mbledhjes së të dhënave. (Guba, E.G. & Lincoln, Y.S., Effective Evaluation, Jossey- Bass Publishers, San Francisco, CA, 1981, fq. 26).

Kur i referohemi të dhënave që mblidhen gjatë studimeve cilësore ato paraqiten gjithmonë në formën e fjalëve. Fjalët janë të vetmet që përbëjnë thelbin e tyre, në studimin cilësor, duke na servitur gjithmonë një panoramë e një përshkrim sa më të plotë të fenomeneve, të situatave, të problematikave të marra në studim.

Fjalët janë ato që mund të paraqesin shkurtime me nëntekste të tyre. Fjalët janë ato që e konvertojnë analizën e të dhënave në një sfidë më të vërshtirë e më të vërtetë . Fjalët janë “më të pasura” se shifrat, numrat dhe gjithmon na mundesojnë kuptime të shumta.

Fokus grupet me ofruesit e shërbimeve sociale, por edhe intervistat me vajzat viktima trafikimi (VeT), janë zhvilluar në mjediset e strehëzave (“Të Ndryshëm e Të Barabartë”; “Tjetër Vizion”; “Vatra”). Këto mjedise arrinin të siguronin qetësinë në bisedim me pjesëmarrësit në studim, duke më mundësuar njëkohësisht një lirshmëri në mbledhjen e një informacioni sa më të gjerë e të thelluar të çështjes së marrë në studim.

Intervistat e realizuara me vajzat viktima trafikimi janë bërë për intervale kohore nga 30 minuta deri në 45 minuta, ndërkohë intervistat e realizuara me pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë zgjatur deri në 120 minuta deri në 160 minuta, kjo gjithmonë në varësi të dinamikës së diskutimeve dhe të aktivizimit të personave që morën pjesë në të.

Intervistat me të dyja target grupet (vajza viktima trafikimi dhe ofrues të shërbimeve sociale) janë realizuar në mjedise e ambiente të përshtashme për to.

Qëllimi i gjetjes së këtyre mjediseve të qeta është bërë që të krijohet idea në psikozën e tyre të një bisede sa më të lirshme e të rehatshme për personat që morën pjesë në studim. (Richard A, Krueger & Casey, M. A., Focus Groups, fq. 159).

Me viktimat e trafikuar të riintegruara dhe në proces riintegrimi që janë asistuar në qendrën e Vlorës, u intervistuan pranë ambienteve të qendrës sociale “Vatra”, Vlorë ; ndërsa me vajzat viktima trafikimi (VeT) e riintegruara që janë asistuar në Organizatën “Tjetër Vizion”, u intervistuan në ambientet e qendrës “Hëna e Re” në qytetin e Elbasanit

dhe me vajzat viktime trafikimi (VeT) që janë asistuar në qendrën “Të ndryshëm e të barabartë”, janë intervistuar pranë zyrave qendrore të kësaj organizate në qytetin e Tiranës.

Ndërsa intervistat me fokus grupet me ofruesit e shërbimeve, u realizuan pranë qendrave përkatëse ku ata operonin. Me punonjësit e koordinatoren e qendrës “Vatra” intervista e fokus grupit u realizua pranë ambienteve të kësaj organizate. Me punonjësit e koordinatoren e qendrës “Tjetër Vizion”, bashkë me dy përfaqësuese të DRSHSSH, intervista e fokus grupit u realizua pranë ambienteve të kësaj organizate. Me punonjësit e koordinatoren e qendrës “Të Ndryshëm e të Barabartë”, intervista e fokus grupit u realizua pranë ambienteve të kësaj organizate.

Çdo pjesëmarrësi të fokus grupeve i është kërkuar të përshkruajë situatën aktuale të vajzave të trafikuar në shoqërinë shqiptare, pasi janë njohur me qëllimin e objektivat e studimit “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në S hqipëri”.

Ajo ç`ka personalisht iu ka premtuar, lidhet në mënyrë të drejtë me ruajtjen e fshehtësisë së informacionit të servitur si nga ofruesit e shërbimeve sociale që operojnë me programin e riintegritit dhe sidomos informacioni kofidencial i dhënë nga vetë vajzat viktime trafikimi VeT.

Intervistave gjysmë të strukturuar që u përdoren në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në shqipëri”, përmbajnë pyetje të mbyllura e të hapura si dhe rrëfime personale të vetë vajzave viktimeve të trafikuar.

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave (vajza viktime trafikimi) janë marrë në konsideratë dhe janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme 10 (dhjetë) parimet që udhëzojnë çështjet që lidhen me etikën e target grupit të marrë në studim (WHO ethical and safety recommendations for intervieweeing trafficked women. London School of Hygiene and Tropical Medicine, London: Daphne Program of the EU, 2003).

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave janë shqyrtuar gjithashtu një mori dokumentash strategjikë që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, kryesisht të vajzave viktime trafikimi të shfrytëzuara për qëllime seksuale.

Duke marrë në konsideratë faktin se vajzat viktimë trafikimi konsiderohen si target grupe “vulnerabël” , janë siguruar nga studiuësja se nuk do të ekspozohen ndaj ndonjë rreziku.

Të intervistuarve fillimisht iu prezantua qëllimi i studimit “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” dhe mënyra si do të realizohej ky studim.

Më pas, gjithë personat që ishin pjesë e intervistave dhe e fokus grupeve iu premtua se informacioni i dhënë prej tyre do të ruhej në kushte të plota fshehtësie. Personalisht iu premtua se do ti ruhen të dhënat e përgjithshme të tyre në këtë studim dhe se të dhënat e tjera të ofruara prej tyre do të trajtoheshim në kushte të plota konfidencialiteti.

Për të realizuar këtë objektiv, nuk janë identifikuar apo përmendur emra të përfaqësuesve të shoqatave jofitimprurese që operojne me viktimat e trafikuar ose edhe emra të punonjësve sociale që janë pjesë e shërbimit social shtetëror. Thjeshtë janë përmendur institucionet ku ato operojnë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

E njëjta gjë iu premtua dhe vajzave viktimat trafikimi gjatë intervistave të realizuara me to duke i siguruar se anonimiteti i tyre, të dhënat e tyre do të mbetet konfidencial. Ato janë përmendur në studim me organizatën në të cilën janë asistuar aktualisht ose me organizatën jofitimprurëse që kanë qenë asistuar më parë.

Ajo ç`ka është më kryesorja është se asnjë identitet nuk do të bëhej i ditur në këtë studim, vecanërisht të dhënat e përgjithshme që lidhen drejtëpërsëdrejti me vajzat viktimat trafikimi (VeT). Asnjë emër ose identitet nuk do të bëhej me dije, por do të përmendeshin, si p.sh. VeT, “Vatra”, Vlorë (vajza viktimë trafikimi, qendra ku asistohet apo është asistuar më parë, si dhe qyteti ku është ngritur qendra sociale).

Në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri” intervistat dhe fokus grupet e realizuara kishin më shumë karakterin e një bisede të thjeshtë e normale. Gjatë realizimit të kësaj bisede të thjeshtë e normale, studiuësja arriti të mbante shënim me shkrim, ku nuk u lejua përdorimi i diktofonit. Kjo gjë e ndihmoi studiuësen në mënyrë që të mos krijohet një atmosferë ku pjesëmarrësit të mos kishin besim. Anëtarët e fokus grupit arritën të shprehnin mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me çështjen e ngritur për studim.

Vlen të thjeksojmë faktin se, asgjë nga ato çfarë thanë të gjithë personat që morën pjesë në studim dhe që u intervistuan nuk u ndryshua ose të arrihej të interpretohej në forma ose menyra të ndryshme nga studiuesja.

Gjatë intervistimit të pjesëmarrsve të fokus grupeve, më është dashur në mënyrë të vazhdueshme të ndërhyj në diskutimet e tyre të zellshme midis vetë anëtarëve të fokus grupeve, kur vëreja se debati midis tyre devijonte nga qëllimi i studimit.

Në realizimin e fokus grupeve, personalisht ndoqa parimin në angazhimin e nxitjes që çdo pjesëmarrës të kontribonte duke dhënë mendimet e tija personale në lidhje me çështjen në fjalë (Richard A. Krueger, Focus Group Kit 4, Moderating FG, fq. 60). Çdo pjesëmarrës iu dha akses të ndrëhynte në debat lidhur me pyetjet e bëra nga ana ime.

Më është dashur, në mënyrë të vazhdueshme, të ndalem herë pas here për të sqaruar në një formë të hollësishme, e sa më të detajuar rëndësinë e marrjes së informacionit në mënyrë të saktë, të qartë e transparente të studimit. Ky informacion buronte nga përvoja jetësore, individuale e profesionale të çdo personi të pranishëm si pjesë e këtij studim.

I rëndësishëm në realizimin e mbledhjes e analizimit të të dhënave ka luajtur dhe blloku i shënimeve të mbajtura nga studiuesja gjatë këtij studimi. Personalisht më është dashur të reflektoj rreth shënimeve të mbajtura gjatë intervistimit, për të analizuar reagimet e veçanta të personave që ishin pjesë e fokus grupeve, si dhe për të kuptuar impresionet e tyre rreth çështjeve që lidhen me procesin e riintegrit të vajzave të trafikuar, paragjykimet e stigmatizimet e tyre në lidhje me këtë çështje, si dhe idetë e veçanta që kanë ndarë me mua në realizimin e procesit të fokus grupeve.

Më është dashur, të kthehet në një retrospektivë të domosdoshme kohore duke i rishikuar në mënyrë të vazhdueshme shënimet e mbajtura gjatë realizimit të fokus grupeve.

Rishikimi i këtyre shënimeve të mbajtura në mënyrë sistematike dhe të sakta më kanë ndihmuar të deshifroj dhe komunikimin jo verbal (që lidhet me gjuhën e trupit) të pjesëmarrësve të fokus grupeve, gjatë intervistimit.

Komunikimi jo verbal, pothuajse në çdo studim, ka një rëndësi të madhe pasi arrin të na japi një kuptim të thelluar të fjalëve nëpërmjet mënyrës së të shprehurit që përdorën personat që morën pjesë në studim gjatë realizimit të fokus grupeve (Richard A. Krueger Casey, M. A., Focus Groups, fq. 185)

Personalisht, më është dashur, të jem vigjilente gjatë realizimit të intervistave me fokus grupet duke mbajtur nën vëzhgim si mendimet, opinionet dhe sygjerimet e tyre rreth çështjes së marrë në studim.

Në mometin që arrita të përfitoja informacionin e shumëllojshëm e të bollshëm që më nevojitej për studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri”, u bë e mundur dhe ndërprerja e intervistës me fokus grupet.

Më pas, me ta, ka vijuar një bisedë e lirshme ku ofrueset e shërbimeve shprehen për vështirësitë e mëdha që hasin në punën e tyre të përditshme, duke më ofruar një informacioni mbi programet specifike të procesit të riintegritimit që ofrohen për vajzat viktimat trafikimi (VeT).

Ky element më ndihmoi, së tepërmi, të kuptojë sesa e vështirë është integrimi i vajzave të trafikuar në shoqërinë shqipëtare.

2.17. Analiza e të dhënave

Në kërkimet cilësore, procesi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave realizohet si proces në formë ciklike. Ky kërkim, ndryshe nga kërkimi sasiorë, analiza e të dhënave realizohet si proces pasi është një proces që realizohet pas mbledhjes së të dhënave përfundimtare të kërkimit.

Duke pasur parasysh faktin se, analiza e të dhënave në kërkimet cilësore realizohet pasi janë mbledhur të dhënat e para. Në këtë moment, analiza e parë e mbledhur në studim duhet të përcaktojë strategjitë e qëllimin e mbledhjes së të dhënave që është përdorur në vijim.

Ky është një element kyç, që më ka ndihmuar që në hapat e para të procesit të kërkimit të identifikoj se cilat janë gabimet që lindin në mbledhjen e të dhënave. Kjo më dha mundësinë e ndreqjes që në fazën e parë të këtyre gabimeve që mund të lindin në studim. Përsa i përket gabimeve që mund të lindin në fazën fillestare të mbledhjes e analizimit të të dhënave ato lidhen me pyetjet që mund të ndryshohen duke i përshtatur me mbledhjen e të dhënave. Instrumentat e metodat e përdorura në studim mund të ndryshojnë deri diku, e të përshtaten me mbledhjen e të dhënave në studim.

Ajo ç`ka vlen të theksohet lidhet me faktin se janë rezultatet e përfituara nga mbledhja e analizimi i të dhënave ato që përcaktojnë se cila metodë do të përdoret në studim.

Në mbledhjen e në analizën e të dhënave cilësore nuk ka ndonjë rregull standart ose një procedurë që duhet unanimisht e realizuar për të gjithë ndryshe nga përdorimi i metodës sasiore e cila rregulli është pothuajse i njëjtë për të gjithë kërkuesit, bazimi në të dhëna me shifra e numra. Ka mënyra të ndryshme të perceptimit për analizën e të dhënave cilësore.

Qëllimi i analizës kryesore së të dhënave në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”, ishte rishqyrtimi dhe mënyra e organizimit të të gjithë atij informacioni të detatuar e të bollshëm të marrë gjatë realizimit të intervistave me vajzat viktimat trafikimi dhe me pjesëmarrësit e fokus grupeve, me ofruesit e shërbimeve. Kjo mënyrë e analizës së të dhënave u realizua në mënyrë të tillë, që temat e diskutimit të bërë në studim dhe interpretimet e pjesëmarrësve të fokus grupeve të vinin në mënyrë paralelele me pyetjet që ishin ngritur që në fazën fillestare të studimit.

Të dhënat, më pas u transkriptuan nga unë, duke i konvertuar ato në materiale në formë të shkruar. Ky proces u realizua fill pasi, unë personalisht arrita të njihesha në mënyrë të detajuar, duke u familjarizuar pas dëgjimit me materialet që ishin regjistruar pas takimit me pjesëmarrësit e fokus grupeve. Pas dëgjimit në mënyrë të vazhdueshme e sistematike të intervistave me fokus grupet, arrita të mbaja shënim konceptet themelore të procesit të riintegritimit të vajzave të trafikuar në shoqëri si dhe temat kryesore që dolën nga dëgjimi i regjistruarëve të bisedave me to .

Transkriptimi e kodimi i analizave të të dhënave është realizuar menjëherë pasi ka përfunduar procesi i intervistave me të gjithë personat që morën pjesë në studim. Por, ka pasur dhe raste kur transkriptimi e kodimi i analizave të të dhënave është realizuar gjatë mbledhjes së të dhënave.

Gjatë procesit të transkriptimit, një rëndësi të vecantë i kam kushtuar dhe komunikimit joverbal, të cilat janë pasqyruar me shenjat e bëra nga pjesëmarrësit e intervistave, apo nga gjuha e trupi.

Në këtë studim janë pasqyruar dhe debatet jashtë temës së studimit “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri”, përfshirë këtu

dhe ndërprerjet që janë bërë nga ndërhyrja e momentit të telefonatave e personave nga jashtë (Richard A. Krueger, Moderating Focus Group Kit 4, fq. 70).

Për t'i dhënë një kuptim sa më të plotë bashkëbisedimit me ofruesit e shërbimeve dhe intervistave me vajzat viktime trafikimi, është vlerësuar që transkriptimi dhe kodimi i të dhënave të bëhet fjalë për fjalë. Kjo gjë u realizua që kuptimi i mendimit të personave që morën pjesë në studim të ishte i qartë dhe i saktë.

Transkriptet janë realizuar në atë formë që të jenë të lexueshëm e të kuptueshëm qartë nga të gjithë. Ato janë formatuar në atë formë që të krijoj mundësinë e vazhdueshme, për të pasur akses e hapësira që të arrijmë të shkruajmë komentet që nevojiten për studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritetit dhe i nevojave specifike të viktimeve të trafikuar në shqipëri”,

Hapi i parë që është ndjekur, është bërë e mundur kodimi në një fletë me tërë konceptet thelbësore dhe temave kryesore që kanë qenë pjesë e studimit. Kjo është bërë me qëllim që kodimi i të dhënave të kishte strukturë të temave themelore e nëntemave kryesore. Kodimi është realizuar duke identifikuar fillimisht lidhjet që ekzistojnë nëpërmjet kategorive, grupimit të tyre kategorive sipas përgjithësimit të niveleve si dhe klasifikimin e ndarjen e disa temave nga nëntema e studimit. Ajo ç'ka është vënë re në studim është se disa tema të studimit janë ri klasifikuar më shumë se një herë në studim. Për të shmangur një gjë të tillë është punuar që çdo temë të ngjitet në tekst për të shmangur përsëritjen në mënyrë të vazhdueshme.

Pasi, më është dashur, të njihem në mënyrë sa më të detajuar e të thelluar me të dhënat e mbledhura nga studimi, kam bërë të mundur klasifikimin e njësive me kuptim.

Fillimisht kam ndjekur si procedurë, identifikimin e atij informacioni që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me qëllimin e studimit, dhe më pas ky informacion i siguruar është përshtatur në mënyrë të kuptueshme me të gjitha informacionet e tjera. Kur arrita të bëj, përshatjen e informacionit në bazë të mbledhjes e analizimit të të dhënave, më pas mundësova realizimin e kodimit të tyre.

Hapi i parë konsiston në kodimin e fazës së parë. Ky kodim është realizuar pasi kam arritur të transkrijoj të dhënat që janë përmbledhur paraprakisht nga studimi. Në fazën e parë të kodimit, pasi është realizuar identifikimi i njësive të kuptimit, dhe pasi u arrit të vihen emra

për çdo njësi kuptimi të cilat në thelb përmbanin kuptime të njësive të njëjtë, u arrit të viheshin kode për secilën nga këto njësi të ndara në kategori.

Kjo ka qenë forma dhe mënyra e vetme që njësitë e kuptimit të mbledheshin në këtë fazë të procesit të kërkimit cilësor. Mënyra sesi është arritur të menaxhohen të dhënat në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në shqipëri”, vlen të theksohet se është realizuar në formë manuale.

Pas realizimit të intervistave me vajzat viktime trafikimi dhe me pjesëmarrësit e fokus grupeve, jam angazhuar në mbledhjen e analizën e të dhënave duke identifikuar në fazën e parë të gjitha njësitë e kuptimit. Pas identifikimit të njësive të kuptimit, mundësova kodimin e tyre duke i vendosur emra të njëjta me njësitë e kuptimit dhe në fund të saj bëra të mundur interpretimin e vazhdueshëm e të gjitha të dhënave të përfituara nga realizimi i intervistave me vajzat viktime trafikimi dhe me personat që morën pjesë në realizimin e intervistave me fokus grupet.

Kodimi i të dhënave në fazën e parë të studimit ka kaluar në këto nivele :

Në fazën e parë është bërë e mundur identifikimi I njësive të kuptimit, e cila vijoi me realizimin e fazës së dytë që kosistonte me etiketimin e grupeve e kategorive të njësive të kuptimit që në përmbajtjen e tyre kishin të njëjtin kuptim me njësitë e para.

Në fazën e tretë u arrit të përcaktoheshin se cilat do të ishin kodet për secilën nga këto njësi kuptimi.

Faza e fundit asistoi në riorganizimin e të dhënave me kodet e tyre dhe në përpunimin e thelluar të kodeve të kategorive të marrë në studim.

Pas realizimit në mënyrë të plotë e të saktë të fazës së parë të kodimit, u bë e mundur kalimi në fazën e dytë të kodimit që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me interpretimin e asaj që kemi evidentuar në realizimin e fazës së parë. Në këtë fazë është bërë e mundur të vendosen njësitë e kuptimit bashkë me realizimit të këtij procesi.

Ka pasur raste, kur më është dashur të përshtasë kategoritë në brendësinë e tyre duke mundësuar korigjimin e saktë e të plotë të njësive të kuptimit.

Kjo ka qenë një mënyrë, ku është evidentuar se fokusi I mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të realizuara me intervistat e bëra me vajzat viktime trafikimi ka qenë I ndryshëm nga fokusi I mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të realizuara nga pjesëmarrësit e fokus

grupeve me ofruesit e shërbimeve sociale. Në këtë studim konteksti i kategorive të vajzave viktima trafikimi është I ndarë nga konteksti I kategorive të ofruesve të shërbimeve.

Në këtë mënyrë organizimi e procesit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave më ndihmoi së tepërmi, që të evidentoja se cilat ishin ngjashmëritë dhe dallimit midis kategorive që ishin pjesë në studim. Në rastin konkret midis kategorive të vajzave viktima trafikimi dhe të ofruesve të shërbimeve sociale.

Në këtë mënyrë është bërë e mundur krahasimi i kategorive të studimit, duke nxjerrë në pah marrëdhëniet që këto kategori kanë me njëra-tjetrën. Në këtë konteks është arritur ti jepet kuptim njësisive në kategori.

Kategoritë, kanë arritur të integrohen në këtë studim nëpërmjet tëmave dhe nëntemave . Me kodimin e çdo teme e nënteme është proceduar sikurse u veprua me kodimin e kategorive .

Kodimi i intervistave të fokus grupit u realizua sipas këtyre çështjeve:

*** Shërbimet riintegruese (paketë e plotë shërbimesh në përputhje me nevojat e VeT)**

Ofrimi i shërbimeve rezidenciale për viktimat e trafikimit është shumë pozitiv, por nuk duhet të jetë i vetmi që ofrohet, pasi dhe institucioni shtetëror duhet të kontribuojë më tepër për plotësimin e nevojave të VeT. Në aspektin social strehëzat janë ato institucione që i përgatisin vajzat viktima të trafikuar (VeT) për të qenë të pavarura dhe aktive në jetë. Në fillim të programit strehëzat duhet t'u ofrojnë vajzave një model përkujdesjeje që në shumicën e rasteve u ka munguar në familjen e tyre dhe më pas ato përpiqen që t'i fuqizojnë vajzat të jenë të afta të jetojnë të pavarura, si dhe u ofrojnë mbështetje për të zhvilluar aftësi personale drejt jetës së pavarur si dhe marrin pjesë në përfshirjen e tyre në çdo etapë të procesit të rikuperimit dhe riintegrit.

*** Bashkëpunimi në rrjet mes aktorëve**

Përsa i përket pjesës teknike të programeve të riintegrit që ofrohen nga strehëzat, profesionistët bien dakord se paketa e shërbimeve të ofruara është e plotë, por një pjesë e shërbimeve varen shumë nga faktorë të cilët nuk janë në kontrollin e strehëzave. Pavarësisht se shërbimet ofrohen në mënyrë të plotë nga strehëzat, shteti nuk ofron asnjë

mbështetje për mundësimin e një procesi riintegrimi më cilësor afatgjatë, pasi, në rastin kur vajzat nuk marrin shërbime të plota, ato përballen me problemin e riciklimit.

Probleme të shumta janë hasur në procesin e identifikimit të viktimave nga punonjësit e policisë si dhe ka paqartësi institucionale dhe organizative për të mbështetur hallkat e riintegritit. Një gjë e tillë ka vështirësuar më shumë punën e strehëzave për riintegrimin e viktimave VeT në jetën sociale. E rëndësishme është të forcohen dhe të hidhen themelet e shtetit të mirëqenies sociale edhe në Shqipëri.

Në këtë mënyrë, shërbimet për VeT do të jenë të qëndrueshme, ashtu si dhe i gjithë procesi i riintegritit për këtë grup vulnerabël dhe me nevoja specifike.

Nga fokus grupet me ofruesit e shërbimeve, një element i rëndësishëm që ka arritur shteti shqiptar deri më sot, ishte përfitimi i ndihmës ekonomike për viktimat e trafikuar. Një nga masat e marra nga shteti për VeT është miratimi i ligjit Nr. 904, datë 12.12.2012, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku, midis përfituesve të ndihmës ekonomike, përfshihen edhe viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore. Kjo ndihmë ekonomike është 3.000 lekë të reja në muaj. Kjo shumë që VeT do të përfitojë, është vlerësuar nga ofruesit e shërbimeve si një shumë relativisht e papërfillshme.

Një element i rëndësishëm që u evidentua në fokus grupet me ofruesit e shërbimeve, ishte bashkëpunimi jo i lartë ndërmjet Zyrës së Punësimit dhe OJF.

Një mungesë tjetër e bashkëpunimit që u theksua në fokus grup ishte ofrimi i shërbimeve shëndetësore të një cilësie e efikasiteti jo të lartë, kur dihet se shumica e viktimave kanë nevojë të vazhdueshme nga shteti dhe OJF-të për mundësimin e shërbimeve të ndryshme shëndetësore. Ofrueset e shërbimeve shprehen në lidhje me këtë çështje. Pavarësisht se shërbimet shëndetësore ofrohen falas për viktimat e trafikuar, ato nuk janë në cilësinë e duhur.

*** Mbështetja nga familja dhe komuniteti**

Mjedisi familjar luan një rol fundamental në procesin e suksesshëm të riintegritit. Eksperinca e përvoja kanë treguar se vajzat viktimat trafikimi (VeT) që janë mbështetur nga

familja, kanë arritur të kenë sukses në realizimin e këtij procesi, duke e fuqizuar vajzën VeT në përbalimin e vështirësive të tjera që ka procesi.

Sipas ofruesve të shërbimeve, ka pasur dhe raste ku familja mund të ketë qenë shkaktare e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e trafikimit të vajzës VeT. Kjo ndodh zakonisht në familje të cilat kanë probleme të theksuara social-ekonomike.

Ne jemi një shoqëri e mbyllur, patriarkale dhe e kemi të pamundur të ndryshojmë lehtësisht opinionet e publikut të gjerë në lidhje me vajzat e trafikuar. Dëgjojmë shpesh të përmendin që “prostituta mbetet prostitutë”, duke e paragjykuar dhe kritikuar, në vend që t’i japim mundësinë VeT të shprehin eksperimentat negative që kanë kaluar në jetën e tyre. Pavarësisht mbështetjes së familjes dhe rolit të saj si ndërmjetëse, një sfidë tjetër për vajzat VeT mbeten dhe paragjykimet e stereotipet nga komuniteti i gjerë, një sfidë kjo që ndikon drejtpërdrejtë në izolimin e viktimave nga familja dhe komuniteti, duke e bërë të vështirë gjetjen e një pune dhe një rrethi social ku viktimat të mund të vazhdojnë jetën normalisht.

***Arsimimi, formimi profesional dhe punësimi**

Shumica e vajzave të trafikuar kanë pak vite arsimit, fakt ky që e bën më të vështirë gjetjen dhe mbajtjen e një vendi pune. Kjo çon drejt domosdoshmërisë për më shumë mundësi formimi profesional si dhe shanse më të mëdha punësimi. Në shumicën e rasteve ato punësohen falë mbështetjes e ndihmës nga OJF në biznese private, ndërkohë që roli i shtetit mbetet në nivele të ulta dhe jo shumë kontribues në këtë proces.

Ofruesit e shërbimeve evidentojnë lidhjen e procesit të riciklimit me nivelin arsimor të VeT. Vajzat me nivel të ulët arsimor (analfabete) janë më të predispozuar për t’u ricikluar në shoqëri. Ato e kanë të vështirë marrjen e një formimi profesional (guzhinë, rrobaqepsie e parukerie që ofrohen nga OJF-të) dhe, si pasojë, edhe gjetjen e mbajtjen e një pune. Këto mbeten target-grupet më vulnerabël ndaj këtij procesi.

*** Mbrojtja ligjore e VeT**

Një vështirësi që u evidentua nga ofruesit e shërbimeve lidhej kryesisht me mbrojtjen ligjore të vajzave viktimat trafikimi (VeT). Pengesat më të mëdha që vajzat VeT hasnin

kur i drejtohen sistemit të drejtësisë për ndihmë, është mungesa e informacionit mbi të drejtat e tyre dhe bashkëpunimi me OJF-të që punojnë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Avokatët e punësuar nga strehëzat duhet të jenë më bashkëpunëtorë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të luftojmë më fuqishëm për të mbrojtur të drejtat e vajzave viktime trafikimi (VeT) në sallën ku zhvillohet seanca gjyqësore ndaj personit që i ka shfrytëzuar për qëllime seksuale.

Duhet marrë në konsideratë se çështjet e vendimet që lidhen me sistemin gjyqësor në Shqipëri asnjëherë nuk janë të drejta e të pavarura. Një ndër problemet e mëdha të sistemit gjyqësor mbetet korrupsioni pasiv dhe presionet e jashtme që mund të kenë gjyqtarët në marrjen e vendimit të drejtë e në favor të viktimës.

Në fokus grup një element i rëndësishëm që u evidentua ishte vështirësia që hasnin institucionet përkatëse në identifikimin e viktimës dhe referimin e tyre pranë institucioneve e shërbimeve të duhura.

Pavarësisht se ligjet dhe disa praktika ekzistojnë, zbatimi i tyre për ta zgjidhur problemin varet nga dëshira e mirë e njerëzve që gjenden në këto njësi. Proceset e gjata gjyqësore dhe mbrojtja e pakët e viktimave bëjnë që këto të fundit dhe individë të tjerë të përfshirë, të humbasin besimin e tyre tek institucionet shtetërore.

*** Qëndrueshmëria në financimin e organizatave të ndihmës që ofrojnë asistencë direkte për vajzat viktime trafikimi (VeT)**

Që një strehëz të rrisë e të plotësojë me efikasitet nevojat e vajzave viktime trafikimi (VeT) për një proces të suksesshëm riintegrimi, sipas ofruesve të shërbimeve duhet që shteti ti financojë ekonomikisht. Ky faktor është cilësuar si shumë i rëndësishëm nga profesionistët e intervistuar dhe ata kanë dhënë një sërë rekomandimesh në këtë drejtim, edhe pse qëndrueshmëria e strehëzave varet shumë nga fondet e donatorëve, fonde këto të pakta në krahasim me nevojat me të cilat përballen vajzat viktime trafikimi në shoqëri.

Në momentin kur gjendja financiare e tyre është në përputhje me shpenzimet dhe nëse ato nuk janë gjatë gjithë kohës duke kërkuar fonde, atëherë bëhet më e lehtë për to të përqendrohen dhe të përmirësojnë sasinë dhe cilësinë e programeve të riintegritit për viktimat e trafikimit. Një gjë e tillë mund të bëhet fare mirë nëpërmjet procesit të decentralizimit të pushtetit, përgjegjësive dhe buxhetit, për të patur shërbime lokale efikase dhe lehtësisht të menaxhueshme.

2.18. Kufizimet e kërkimit

Tashme dihet se cdo kërkim cilësor mbart në vetvete disa kufizime, ku më të rëndësishmet në këtë studim, janë:

1. Numri i kufizuar i vajzave viktime trafikimi (VeT) dhe informatorëve kyç. Ka patur raste kur disa prej aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore nuk u janë përgjigjur thirrjes për intervistë, duke kufizuar, si rrjedhojë, numrin e tyre si dhe komentet e mundshme nga këta aktorë.
2. Metodologjia do të kishte qenë më e plotë nëse do të kishte ekzistuar mundësia për të krahasuar viktimat që kanë marrë ndihmë nga strehëzat, duke përfutur nga programi i riintegritit dhe ata që nuk janë asistuar asnjëherë në strehëz dhe nuk kanë qenë pjesë e procesit të riintegritit.
3. Kufizimi mund të konsiderohet edhe fakti se VeT (të gjitha femra) të intervistuar në funksion të këtij studimi, janë kryesisht viktime, të cilat janë shfrytëzuar për qëllime prostitucioni, ndërkohë që nuk janë marrë në studim individë të shfrytëzuar për qëllime të tjera (VeT minorene apo meshkuj). Vlen të theksohet se vajzat viktime trafikimi (VeT) të intervistuar janë pjesë e atij target grupi të viktimeve të trafikimit, që janë identifikuar si të tilla dhe kanë marrë asistencë riintegruese.

KAPITULLI III

3.1.Rezultatet e kërkimit – Perspektiva e ofruesve të shërbimeve sociale.

Të dhënat e përgjithshme të nxjerra nga intervistat në fokusgrup

Qëllimi i analizës së gjetjeve nga intervistat gjysëm të strukturuar me vajzat viktime trafikimi (VeT) dhe fokus grupet (ofruesit e shërbimeve) e realizuara për këtë studim kanë të bëjnë me identifikimin e problemeve që hasin vajzat viktime të trafikimit në procesin e riintegrit. Eksplorimi i mundësive dhe i burimeve që ndihmojnë në një riintegrim të suksesshëm të vajza viktime trafikimi (VeT) në shoqëri, analizimi i sfidave dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara për VeT, fokus grupet me përfaqësuesit e OJF e Drejtorisë Rajonale të SHSSH:

Informacioni social-demografik

Organizata	Pozicioni i punës	Koha që operon në këtë institucion
Vatra	Kordinatore	5 vite
Vatra	Punonjëse sociale	14 vite
Vatra	Punonjëse sociale	11 vite
Vatra	Punonjëse sociale	5 vite
Vatra	Psikologe	7 vite
D&E	Koordinatore	15 vite
D&E	Punonjëse sociale	10 vite
D&E	Punonjëse sociale	9 vite
D&E	Punonjëse sociale	7vite
D&E	Psikologe	2 vite
Tjetër Vizion	Koordinatore	12vite
Tjetër Vizion	Punonjëse sociale	10 vite
Tjetër Vizion	Psikologe	5 vite
Sh.S.SH EL	Punonjëse sociale	1.5 vite

Sh.S.SH EL	Punonjëse sociale	8 muaj
------------	-------------------	--------

Në bazë të standartave të hartuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë kategorike nuk identifikohen për asnjë lloj studimi emrat e viktimave të trafikimit si dhe emrat e ofruesve të shërbimeve, çështje këto që lidhen me sigurinë e tyre jetike.

Ky standard është respektuar me rigorozitet nga unë, ku fillimisht kam evidentuar institucionin që ato përfaqësojnë, pozicionin e tyre në këtë institucion si dhe vitet e punës së tyre. Pjesë e studimit kanë qenë fokus grupet me ofruesit e shërbimeve, të cilët operojnë drejtëpërdrejtë në ofrimin e programeve të riintegritit për vajzat viktimë trafikimi (VeT). Ky fokus grup përbëhej nga punonjës socialë që kishin një eksperiencë të gjatë pune me vajzat viktimë trafikimi (VeT). Eksperienca e gjatë në luftën antitrafik i ka bërë ofruesit e shërbimeve sociale për vajzat viktimë trafikimi (VeT) të jenë të aftë të evidentojnë faktorët që nevojiten për një riintegrim të suksesshëm të VeT. Gjithashtu, në takimin me to u evidentuan sfidat që hasin këto vajza viktimë trafikimi (VeT) gjatë këtij procesi.

3.1.1. Mungesa e mbështetjes së vajzave të trafikuar nga familja e origjinës

Sipas ofruesve të shërbimeve, rezulton se mjedisi familjar luan një rol fundamental në procesin e suksesshëm të riintegritit. Eksperienca e përvoja kanë treguar se vajzat viktimë trafikimi (VeT) që janë mbështetur nga familja, kanë arritur të kenë sukses në realizimin e këtij procesi, duke e fuqizuar vajzen VeT në përballimin e vështirësive të tjera që ka procesi.

“Ne kemi vërejtur se, kur viktimat kanë mbështetje nga familjet e tyre, ato janë shumë të suksesshme në RE /Integrimi se vajzat VeT që nuk kanë mbështetje nga familjet e tyre të origjinës”, shprehet punonjësja sociale e qëndres “Vatra”, Vlorë.

Sipas ofruesve të shërbimeve, ka pasur dhe raste ku familja mund të ketë qenë shkaktare e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e trafikimit të vajzave të tyre. Kjo ndodh zakonisht në familje të cilat kanë probleme të theksuara social-ekonomike.

"Nëse viktimat janë pjesë e një familje e cila ka shumë probleme, që do të thotë mosfunksionim i familjes, pjesëtarët e familjes mund të jenë ata që shtyjnë vajzën që të bëhet viktimë e trafikimit...", shprehet punonjësja sociale e qëndres D&E, Tiranë.

"Ndodh që të jenë vetë viktimat e trafikimit që nuk dëshirojnë të mbajnë marrdhënie me familjen e origjinës dhe refuzojnë t'i rivendosin ato me familjarët...", shprehet punonjësja sociale e qëndres. "Tjeter Vizion", Elbasan.

Ne jemi një shoqëri e mbyllur, patriarkale dhe e kemi të pamundur të ndryshojmë lehtësisht opinionet e publikut të gjerë në lidhje me vajzat e trafikuar. Dëgjojmë shpesh të permendin që "prostituta mbetet prostitutë", duke e paragjykuar dhe kritikuar, në vend që t'i japim mundësinë vajzave viktimat trafikuara (VeT) të shprehin eksperimentet negative që kanë kaluar në jetën e tyre.

Pavarësisht mbështetjes së familjes dhe rolit të saj si ndërmjetëse, një sfidë tjetër për vajzat VeT mbeten dhe paragjykimet e stereotipet nga komuniteti i gjerë. Kjo mbetet një ndër sfidat, kjo që ndikon drejtpërdrejtë në izolimin e vajzave viktimave nga familja dhe komuniteti, duke e bërë të vështirë gjetjen e një pune dhe një rrethi social ku viktimat të mund të vazhdojnë jetën normalisht.

"Në familje baballarët dhe vëllezërit janë ata që sillen më keq me motrat e tyre, të cilat kanë qenë viktimat e trafikimit.....", shprehen punonjëset sociale të qëndrave " D&E", Tiranë e "Vatra" Vlorë.

3.1.2. Arsimimi, formimi profesional e punësimi i vajzave të trafikimi

Shumica e vajzave të trafikuar kanë pak vite arsimit, fakt ky që e bën më të vështirë gjetjen dhe mbajtjen e një vendi pune në vazhdimësinë e jetës së tyre. Kjo çon drejt

domosdoshmërisë për më shumë mundësi formimi profesional si dhe shanse më të mëdha punësimi.

Ofruesit e shërbimeve evidentojnë se vajzat viktime trafikimi (VeT), të cilat kanë përfituar kurse profesionale gjatë kohës së asistimit në qendër (OJF), kanë qenë më të suksesshme në gjetjen e një pune gjatë procesit të riintegritimit.

Në shumicën e rasteve ato punësohen falë mbështetjes e ndihmës së ofruar nga organizatat (OJF) në biznese private, ndërkohë që roli i shtetit mbetet në nivele të ulta dhe jo shumë kontribues në këtë proces. Në Shqipëri punonjëset e OJF-ve shprehen:

“Deri më sot shteti ka ofruar vetëm kurse profesionale trajnimi pa pagesë por, pavarësisht se janë ndjekur politika punësimi për këtë targetgrup, rezultati nuk ka qenë pozitiv, pasi viktimat nuk duan që të identifikohen si të tilla në Zyrat e Punës...”, shprehet punonjësja sociale e qendrës D&E, Tiranë.

“Shteti duhet të hartojë politika sociale si dhe të gjejë burimet dhe mekanizmat për t’i zbatuar ato....”, shprehet psikologja e qendrës “Tjeter Vizion”, në Elbasan.

Ofruesit e shërbimeve shprehen se :

“Një vajze me arsim të mesëm dhe formim profesional ka më shumë hapësira për punësim në tregun e punës ...”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “Vatra” Vlorë.

Nëse një vajzë ka një vend pune dhe është e kënaqur me punën që bën, e ka më të lehtë të bëjë një jetë të pavarur dhe të ketë një vetvlerësim më të lartë...”, shprehet psikologja e qendrës “Vatra” në Vlorë.

Ofruesit e shërbimeve evidentojnë lidhjen e procesit të riciklimit me nivelin arsimor të vajzave viktime trafikimi (VeT). Sipas tyre, vajzat (VeT) me nivel të ulët arsimor (analfabete) janë më të predispozuara për të qenë pjesë e riciklimit në shoqëri. Ato e kanë të vështirë marrjen e një formimi profesional në të ardhmen (guzhinë, rrobaqepsie e parukerie që ofrohen nga OJF-të) dhe, si pasojë, edhe gjetjen e mbajtjen e një pune. Këto mbeten target-grupet më vulnerabël ndaj këtij procesi.

3.1.3.Mungesa e mbështetjes nga institucioni shtetetëor në procesin e riintegrit të viktimave të trafikimit

Përsa i përket pjesës teknike të programeve të riintegrit që ofrohen nga strehëzat, profesionistët bien dakord se paketa e shërbimeve të ofruara është e plotë, por një pjesë e shërbimeve varen shumë nga faktorë të cilët nuk janë në kontrollin e strehëzave. Pavarësisht se shërbimet ofrohen në mënyrë të plotë nga strehëzat, shteti nuk ofron asnjë mbështetje për mundësimin e një procesi riintegriti më cilësor afatgjatë, pasi, në rastin kur vajzat nuk marrin shërbime të plota, ato përballen me problemin e riciklimit.

Punonjësit socialë të strehëzave mendojnë se :

“Teksa strehëzat ofrojnë shërbimet e para, shteti duhet të vazhdojë mbështetjen e tij në forma të tjera gjatë fazave të ndryshme të riintegrit...”, shprehet koordinatorja e qendrës “D&E” në Tiranë.

Probleme të shumta janë hasur në procesin e identifikimit të viktimave nga punonjësit e policisë si dhe ka paqartësi institucionale dhe organizative për të mbështetur hallkat e riintegrit. Një gjë e tillë ka vështirësuar më shumë punën e strehëzave për riintegritin e viktimave VeT në jetën sociale.

“Për sa kohë që shteti shqiptar nuk do të zbatojë politika të mirëfillta sociale për viktimat e trafikimit, strehëzat do të hasin vështirësi në zbatimin e programit të riintegrit të plotë të viktimave të trafikimit. Për këtë duhet një koordinim më i mirë nga autoritetet lokale që ofrojnë shërbime sociale, zyrat e punës, etj....”, shprehet koordinatorja e qendrës “Tjetër Vizion” në Elbasan.

E rëndësishme është të forcohen dhe të hidhen themelet e shtetit të mirëqenies sociale edhe në Shqipëri.

“Duhet të jenë vetë institucionet e shtetit që të marrin përsipër ofrimin e shërbimeve kryesore për VeT, duke filluar nga asistenca shëndetësore, formimi profesional, punësimi,

strehimi, mbrojtja ligjore”, shprehet koordinatorja e qendrës sociale “ Vatra” në Vlorë.

Në këtë mënyrë, shërbimet për VeT do të jenë të qëndrueshme, ashtu si dhe i gjithë procesi i riintegrit për këtë grup vulnerabel dhe me nevoja specifike.

Kur dy punonjëse të shërbimit social shtetëror u pyetën se cili ishte kontributi më i rëndësishëm i dhënë prej institucionit ku ato operonin, (pavaresisht jo me shumë eksperience në punën e tyre) u shprehën :

“Pika e fortë është se ndihma ka shkuar direkt për viktimat. Është e rëndësishme të theksojnë mbështetjen e drejtpërdrejtë që u është dhënë viktimave të trafikimit.... Kjo është shumë pozitive për ne si institucion....”, shprehet punonjësja sociale e Drejtorise Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, L.S në Elbasan.

Nga fokusgrupet me ofruesit e shërbimeve, një element i rëndësishëm që ka arritur shteti shqiptar deri më sot, ishte përfitimi i ndihmës ekonomike për viktimat e trafikuar. Një nga masat e marra nga shteti për VeT është miratimi i ligjit Nr. 904, datë 12.12.2012, “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku, midis përfituesve të ndihmës ekonomike, përfshihen edhe viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore. Kjo ndihmë ekonomike është 3.000 lekë të reja në muaj. Kjo shumë që VeT do të përfitojë, është vlerësuar nga ofruesit e shërbimeve si një shumë relativisht e papërfillshme.

“Normalisht ndihma e shtetit duhet të jetë më e madhe, duke menduar se ajo do të shërbejë për të lehtësuar sadopak viktimën e trafikimit gjatë procesit të riintegrit....”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “D&E” në Tiranë.

Një element i rëndësishëm që u evidentua në fokus grupet me ofruesit e shërbimeve, ishte bashkëpunimi jo i lartë ndërmjet Zyrës së Punësimit dhe OJF. Ofruesit e shërbimeve shprehen:

“Nuk mbaj mend të kemi pasur qoftë edhe një rast të vetëm të një vajze Vet që të jetë punësuar pranë institucioneve shtetërore gjatë këtyre 13 viteve eksperiencë pune...”, shprehet koordinatorja e qendrës “Tjetër Vizion” në Elbasan.

Një mungesë tjetër e bashkëpunimit që u theksua në fokus grup ishte ofrimi i shërbimeve shëndetësore të një cilësie e efikasiteti jo të lartë, kur dihet se shumica e viktimave kanë nevojë të vazhdueshme nga shteti dhe OJF-të për mundësimin e shërbimeve të ndryshme shëndetësore.

Ofrueset e shërbimeve shprehen në lidhje me këtë çështje.

“Mungojnë shërbimet shëndetësore të kualifikuara në përputhje me nevojat specifike të viktimave, sidomos ato shërbime që lidhen me këshillimin psikoterapeutik dhe jo me “ngopjen” e viktimave me qetësues, duke qenë mënyra më e thjeshtë për të përballuar situatën...”, shprehet psikologja e qendrës “Vatra” në Vlorë dhe psikologja e qendrës “Tjetër Vizionit” në Elbasan .

Pavarësisht se shërbimet shëndetësore ofrohen falas për viktimat e trafikuar, ato nuk janë në cilësinë e duhur.

3.1.4. Përputhshmëria e shërbimeve të ofruara me nevojat specifike të viktimave të trafikimit

Pyetjes nëse shërbimet e ofruara janë të mjaftueshme për viktimat e trafikimit, ofruesit e shërbimeve u janë përgjigjur pozitivisht, por duke e parë në këndvështrime të ndryshme. Sipas tyre, ofrimi i shërbimeve rezidenciale për viktimat e trafikimit është shumë pozitiv, por nuk duhet të jetë i vetmi që ofrohet, pasi dhe institucioni shtetëror duhet të kontribuojë më tepër për plotësimin e nevojave të VeT.

Ofruesit e shërbimeve shprehen:

“Kur rastet janë me rrezikshmëri të ulët, shërbimet shihen si të mjaftueshme, ndërsa, në rastet me rrezikshmëri të lartë, shërbimet nuk arrijnë dot të përmbushin nevojat e viktimave....”, shprehet punonjësja sociale e qendres “D&E” në Tirane.

Ndërsa psikologjia e qëndrës sociale “Tjetër Vizion” në Elbasan, në lidhje me këtë çështje shprehet se :

“ ...Shërbimet duhet të ofrojnë më shumë mundësi punësimi, siguri për jetën, akses ndaj sistemit ligjor dhe avokatëve më të mirë në treg... ”

Në aspektin social strehëzat janë ato institucione që i përgatisin vajzat viktime trafikimi (VeT) për të qenë të pavarura dhe aktive në jetë. Në fillim të programit strehëzat duhet t’u ofrojnë vajzave një model përkujdesjeje që në shumicën e rasteve u ka munguar në familjen e tyre dhe më pas ato përpiqen që t’i fuqizojnë vajzat të jenë të afta të jetojnë të pavarura, si dhe u ofrojnë mbështetje për të zhvilluar aftësi personale drejt jetës së pavarur si dhe marrin pjesë në përfshirjen e tyre në çdo etapë të procesit të rikuperimit dhe riintegritimit.

3.1.5.Mbrojtja ligjore e viktimave të trafikimit

Një vështirësi që u evidentua nga ofruesit e shërbimeve lidhej kryesisht me mbrojtjen ligjore të vajzave viktime trafikimi (VeT). Pengesat më të mëdha që vajzat VeT hasnin kur i drejtohen sistemit të drejtësisë për ndihmë, është mungesa e informacionit mbi të drejtat e tyre dhe bashkëpunimi me OJF-të që punojnë në këtë fushë.

Ofruesit e shërbimeve, në lidhje me këtë çështje, shprehin mendimet e tyre, të cilat janë të ndryshme.

“Pjesa më e madhe e institucioneve dhe e strukturave nuk e kanë idenë se cilat janë përgjegjësitë e tyre për të identifikuar dhe mbrojtur viktimat e trafikimit, pa përfshirë Ministrinë e Brendshme. Shumë prej tyre përpiqen të heqin nga vetja përgjegjësinë, duke i drejtuar gishtat ndaj aktorëve të tjerë. Problemet e sigurisë lidhen pikërisht me këtë çështje ...”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “Tjetër Vizion” në Elbasan.

Avokatët e punësuar nga strehëzat duhet të jenë më bashkëpunëtorë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të luftojmë më fuqishëm për të mbrojtur të drejtat e vajzave VeT në sallën ku zhvillohet seanca gjyqësore ndaj tutorit.

Ofruesit e shërbimeve shprehen se :

“Avokatët tanë, për një arsye apo tjetrën, asnjëherë nuk e mbrojnë fuqishëm viktimën, përherë avokati i trafikantit është më “agresiv” në sallën e gjyqit....”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “Vatra” në Vlorë.

Duhet marrë në konsideratë se çështjet e vendimet që lidhen me sistemin gjyqësor në Shqipëri, asnjëherë nuk janë të drejta e të pavarura.

Një ndër problemet e mëdha të sistemit gjyqësor mbetet korrupsioni pasiv dhe presionet e jashtme që mund të kenë gjyqtarët në marrjen e vendimit të drejtë e në favor të viktimës.

Në fokus grup një element i rëndësishëm që u evidentua ishte vështirësia që hasnin institucionet përkatëse në identifikimin e viktimës dhe referimin e tyre pranë institucioneve e shërbimeve të duhura.

Ofruesit e shërbimeve shprehen se:

“Në shumë raste zgjidhja e problemeve bëhet në baza personale dhe jo institucionale....”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “Tjeter Vizion” në Elbasan.

Pavarësisht se ligjet dhe disa praktika ekzistojnë, zbatimi i tyre për ta zgjidhur problemin varet nga dëshira e mirë e njerëzve që gjenden në këto njësi. Proceset e gjata gjyqësore dhe mbrojtja e pakët e viktimave bëjnë që këto të fundit dhe individë të tjerë të përfshirë, të humbasin besimin e tyre tek institucionet shtetërore.

Ofruesit e shërbimeve shprehen se:

“Në rastin kur ka patur probleme sigurie ekstreme, shteti normalisht ka ndërhyrë për rehabilitim e viktimave dhe ka marrë masa të menjëhershme...”, shprehet punonjësja sociale e qendrës “Tjeter Vizion” në Elbasan.

3.1.6. Trajtimi i rasteve të vështira të viktimave të trafikimit

Ofruesit e shërbimeve pohojnë se gjatë procesit të riintegritimit përballen me raste shumë të vështira trajtimi. Ato identifikojnë si raste të vështira :

* Vajzat viktime trafikimi (VeT) me probleme të sigurisë. Qendrat rezidenciale janë qendra të një sigurie të mesme. QKPVT është një qendër e një sigurie të lartë ku vajzat viktime trafikimi ruhen nga forcat RENEA. Këto janë vajza me një rrezikshmëri të lartë, pasi kanë denoncuar një rrjet të madh tutorësh dhe kërkohet një siguri e lartë jetësore.

* Vajzat viktime trafikimi (VeT) që nuk kanë një marrëdhënie me familjen e origjinës prej një kohe relativisht të gjatë. Është një vështirësi tjetër në të cilën duhet të ndërhyjnë ofruesit e shërbimeve, duke tentuar në mënyrë të vazhdueshme për të rivendosur e rikuperuar marrëdhëniet me familjarët e VeT, si elementë parësorë në riintegritimin e sukseshëm të VeT .

* Vajzat viktime trafikimi (VeT) që kanë probleme të shëndetit mendor e fizik mbetën sërisht targetgrupet më të vështira për t'u trajtuar, për shkak se nuk ka institucione të posaçme që mund të marrin përsipër shërbimet për të cilat ato kanë nevojë.

* Vajzat viktime trafikimi (VeT) që janë ricikluar në shoqëri. Raste të vajzave që kanë përfituar më parë shërbimin nga OJF dhe ka arritur të riintegrohen në shoqëri suksesshëm.

* Një sfidë e madhe për vetë ofruesit e shërbimeve është kur ka raste që janë identifikuar sërisht nga institucioni i policisë si VeT. Vajza duhet sërisht të bëhet pjesë e paketës së procesit të riintegritimit edhe pse e ka përfituar më parë atë.

* Vajzat viktime trafikimi (VeT) që kanë probleme të abuzimit me substancat narkotike. Mosofrimi i një institucioni të posaçëm për ta ndihuar në rehabilitimin e saj, është një sfidë tjetër me të cilën ofruesit e shërbimeve ndeshen në punën e tyre me VeT.

Punonjëset e strehëzave, tek rastet e vështira, kujtojnë :

"K.S", 15 vjeçare e trafikuar për qëllime shfrytëzimi. VeT, pas asistimit në strehëz, u diagnostikua nga mjekët specialist me "prapambetje të lehtë mendore". Vajzës i mungonte mbështetja e familjes. Familja e saj ishte e varfër e nuk kishte mundësinë ta ndihmonte në ekzaminimin shëndetësor që vajza kishte nevojë. Shërbimet sociale shtetërore refuzuan të

pranojnë përgjegjësinë për rastin, sepse për ta klasifikojnë si rast "shumë vështirë". Qendrat që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara refuzuan ta pranonin, pasi rastet që asistoheshin në këto qendra ishin më të rënda. Si pasojë, qendra mori përgjegjësinë për rastin e saj edhe pse nuk kishte një staf të kualifikuar për ta trajtuar si person me aftësi të kufizuara mendore. Vajza, pasi u asistua në qëndër 4 muaj, u vlerësua nga stafi për mundësinë e fundit për t'a rikthyer në familjen e saj, duke e ndihmuar financiarisht në marrjen e mjekimeve nga ana OJF-së....", kujton punonjësja sociale e qëndrës "Vatra" në Vlorë.

"S.T" u referua nga policia si rast trafikimi. Vajza ishte nën presion nga policia për të hyrë në program, sepse ata donin që ajo të shërbente si dëshmitare. Policia e dinte se ajo ishte përdoruese e drogës por nuk hezitoi ta sillte në organizatë, pavarësisht faktit se qendra nuk ofron shërbime për personat që janë vartës të substancave narkotike. Gjithsesi, organizata ra dakord për ta ndihmuar vajzën, por me rezultate të kufizuara. S.T nuk ishte e motivuar për t'i dhënë fund varësise së saj me drogën dhe stafi nuk kishte kapacitetin për ta ndihmuar në shërimin e saj. Vajza u ndihmuar për disa muaj, por organizimi punës nga ana jonë ishte vetëm në gjendje për ta ndihmuar me problemet e tjera të saj...", kujton punonjësja sociale e qëndrës "D&E" në Tiranë.

"F.S", pasi u asistua në qëndrën e "Vatrës" ku mori shërbimet e ofruara, u referua nga kjo qëndër në organizatën "Tjetër Vizion. F.S vinte nga nje familje ku babai i saj kishte masakruar motrën e vogël dhe e kishte gruposur atë në shtëpi. Nëna e vajzës kishte vdekur kur ajo ishte vetëm 7 vjeçe. Vajza ishte analfabete. Në moshën 15 vjecare njihet me një djalë, i cili e trafikon përreth dy vite. Gjatë kohëqendrimit në strehëz vajzës iu ofrua një kurs kuzhine. Falë mbështetjes së stafit, vajza arriti të punësohej në një restorant në pozicionin e ndihmëskuzhinieres. Pas dy vite kohëqendrimit në strehëz, vajza largohet për të jetuar në mënyrë të pavarur. Pas 6 muajsh nga largimi në strehëz, vajza kishte rënë sërishit pre e trafikimit duke ushtruar profesionin e punonjësese së seksit. Aktualisht vajza po asistohet në qëndrën "D&E" në Tiranë dhe po përfiton sërish nga shërbimet që ka përfituar më parë....", kujton punonjësja e qëndrës sociale "D&E" në Tiranë.

3.1.7. Qëndrueshmëria në financimin e strehëzave për viktimat e trafikimit

Që një strehëz të rrisë e të plotësojë me efikasitet nevojat e vajzave viktimat trafikimi (VeT) për një proces të suksesshëm riintegrimi, sipas ofruesve të shërbimeve duhet që shteti ta financojë ekonomikisht.

Ky faktor është cilësuar si shumë i rëndësishëm nga profesionistët e intervistuar dhe ata kanë dhënë një sërë rekomandimesh në këtë drejtim, edhe pse qëndrueshmëria e strehëzave varet shumë nga fondet e donatorëve, fonde këto të pakta në krahasim me nevojat me të cilat përballen vajzat viktimat trafikimi në shoqëri.

Ofruesit e shërbimeve, në lidhje me këtë aspekt, shprehen se:

“Strehëzat duhet të rrisin shërbimet në mënyrë sa më efikase, edhe pse e kanë problem të madh qëndrueshmërinë e tyre....”, shprehet koordinatoresha e qendrës sociale “Vatra” në Vlorë.

Në momentin kur gjendja financiare e tyre është në përputhje me shpenzimet dhe nëse ato nuk janë gjatë gjithë kohës duke kërkuar fonde, atëherë bëhet më e lehtë për to të përqendrohen dhe të përmirësojnë sasinë dhe cilësinë e programeve të riintegritit për viktimat e trafikimit.

Një gjë e tillë mund të bëhet fare mirë nëpërmjet procesit të decentralizimit të pushtetit, përgjegjësive dhe buxhetit, për të patur shërbime lokale efikase dhe lehtësisht të menaxhueshme.

KAPITULLI IV

4.1 Rezultatet e kërkimit – të dhënat e përgjithshme të nxjerra nga intervistat gjysëm të strukturuar

Në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri” është përdorur metoda e karakterit cilësor.

Për realizimin e këtij studimi, përveç fokus grupeve me ofruesit e shërbimeve, janë përdorur dhe intervistat gjysëm të strukturura me vajzat viktimë trafikimi të riintegruara e në proces riintegrimi.

Në këtë kontekst janë realizuar 26 intervista me vajzat që janë në proces riintegrimi dhe 95 vajza viktimë trafikimi VeT që kanë kohë që e kanë përfituar nga paketa e ofruesve të shërbimeve. Intervistat janë realizuar në Tiranë, Vlorë e Elbasan. Përsa u përket intervistave të strukturuar, ato përmbajnë pyetje të hapura dhe të mbyllura.

Në realizimin e këtyre intervistave qenë të pranishme edhe punonjëset sociale të ofruesve të shërbimeve. Kjo u bë me qëllim që VeT të ndiheshin të qeta gjatë intervistimit të tyre dhe se intervistat nuk mund të realizoheshin në praninë e një intervistuesi të huaj, në bazë të standarteve të miratuara nga MPCSHB.

Është respektuar dhe dëshira e disa vajzave viktimave të trafikuar për të mos e ndarë përvojën e tyre jetësore me persona të panjohur për to. Informacioni i dhënë në këto intervista është ruajtur në kushte absolute konfidencialiteti dhe do të përdoret vetëm për qëllimin e studimit.

Intervistave gjysëm të strukturuar që u përdorën në studimin “Vlerësimi i procesit të riintegritimit dhe i nevojave specifike të viktimave të trafikuar në Shqipëri”, përmbajnë pyetje të mbyllura e të hapura si dhe rrëfime personale të vetë vajzave viktimave të trafikuar.

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave (vajza viktimë trafikimi) janë marrë në konsideratë dhe janë shqyrtuar në menyrë të hollesishme 10 (dhjetë) parimet që udhëzojnë

cështjet që lidhen me etikën e target grupit të marrë në studim (WHO ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women. London School of Hygiene and Tropical Medicine, London: Daphne Program of the EU, 2003).

Për përgatitjen e pyetjeve të të intervistuarave janë shqyrtuar gjithashtu një mori dokumentash strategjike që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, kryesisht të vajzave viktime trafikimi të shfrytëzuara për qëllime seksuale.

Duke marrë në konsideratë faktin se vajzat viktime trafikimi konsiderohen si target grupe “vulnerabël”, janë siguruar nga studiuësja se nuk do të ekspozohen ndaj ndonjë rreziku.

Informacioni i mbledhur u referohet viktimeve të trafikuar që janë identifikuar e asistuar në programe ndihme, ndërkohë që studiuësja nuk ka patur mundësinë të analizojë informacionin për rastet viktime trafikimi të patrajtuar dhe të paidentifikuara.

Numri i intervistave të realizuar në organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikuar

Organizata	Nr. i intervistave	Nr. i intervistave që asistoheshin në qendër	Nr. i intervistave jashtë strehëzës
Vatra	41 raste (33,8%)	14 raste (11.5%)	27 raste (22.3%)
Tjetër Vizion	43 raste (35.5%)	_	43 raste (35.5%)
D&E	37 raste (30.5%)	12 raste (9.91%)	25 raste (20.6%)
TOTAL	121 (100%)	26 raste (21.5%)	95 raste (78.5%)

Organizata “Tjetër Vizion” që në muajin qershor 2014 ofron shërbime vetëm për fëmijët viktime e trafikimit, duke mos ofruar më shërbime për vajzat e trafikuar, shkak kjo i përfundimit të projekteve që financohen për këtë target grup.

4.2. Informacioni rreth gjeneraliteteve të viktimave të trafikimit

Të dhënat e përgjithshme rreth grupmoshave të vajzave VeT:

Grupmosha	15-20 vjeç	20-25 vjeç	25-30 vjeç	30 vjeç e lart
Rastet	26	34	49	12
Përqindjet	21.4%	28%	40.4%	9.9%

Nga intervistat e realizuara me VeT rezulton se përqindja më e lartë (40.4%) e vajzave Vet i përket grupmoshës 25-30 vjeç. Nëse do ktheheshin në një retrospektivë të domosdoshme kohore, të gjitha studimet i referohen fenomenit të trafikimit lidhur me grupmoshat 20-25 vjeç, të cilat përbëjnë 41% (Studimi mbi riintegrimin social-ekonomik të viktimave të trafikimit në Shqipëri, Qershor 2009; fq. 30-32). Në studimin tonë rezulton që grupmosha 25-30 vjeç të ketë përqindjen më të lartë. Kjo vjen dhe si pasojë e faktit që vajzat kanë qëndruar një periudhë kohore të asistuar në qendër dhe tani kanë vite që kanë dalë nga programi i shërbimit. Nga studimi dhe intervistat me vajzat rezultoi shqetësues dhe përqindja mesatarisht e lartë, 21.4%, që i përket vajzave të grupmoshës 15-20 vjeç, moshë kjo relativisht e vogël për të qenë pjesë e procesit të trafikimit e për të përballuar në vazhdimësi sfidat dhe problematikat e procesit të riintegrit.

Të dhënat e përgjithshme rreth vendlindjeve të vajzave VeT

Vendlindja	Qytezë	Z. urbane	Z. rurale	Të huaja
Rastet	9	75	34	3
Përqindjet	7.4%	61.9%	28%	2.4%

Vendlindja e vajzave VeT ka një shpërndarje gjeografike relativisht të gjërë. Për lehtësi interpretimi, ajo është grupuar në katër seksione si, vajzat Vet që janë pjesë e qytezave; vajzat Vet që janë pjesë e zonave urbane; vajzat VeT që janë pjesë e zonave rurale si dhe vajzat Vet që janë me nënshtetësi të huaj. Nëse do t'u referoheshim studimeve të realizuara më parë në vendin tone, rezulton se prejardhja e vajzave viktimë trafikimi i përket zonave

rurale që përbëjnë 58% (Të ndryshëm e të barabartë, 2006). Por në studim rezulton se përqindja më e lartë, 61,9% e vajzave viktimë trafikimi, i përkasin zonave urbane. Kjo lidhet me faktin se në Shqipëri brënda këtyre viteve ka ndryshuar shpërndarja demografike e popullsisë si pasojë e procesit të migrimit. Gjithashtu, nëse do t'u referohemi viteve të lindjes së vajzave, pjesa më e madhe e grave shtatzanë u drejtoheshin spitaleve të rajonit për të kryer procesin e lindjes e, si rrjedhojë, regjistrimi i tyre bëhej në gjendjen civile të qytetit. Në studimin tonë janë përfshirë dhe persona që i përkasin shtetësisë së huaj, si Skocisë, Ruisë, Moldavisë e që janë pjesë e procesit të riintegrit në territorin shqiptar.

Të dhënat e përgjithshme rreth gjendjes civile të vajzave VeT

Gjendja civile	E martuar	E divorcuar	E ve	Beqare	Vajzë nënë
Rastet	17	22	2	64	16
Përqindjet	14%	18%	1.6%	52.8%	13.2%

Nga intervistat e realizuara me vajzat VeT rezulton se statusi civil i pjesës më të madhe të të intervistuarave është “beqare” (52.8%). Ky rezultat përputhet edhe me ato të studimeve të mëparshme ku vajzat me status beqare përbëjnë 81% të tyre (Studimi mbi riintegrimin sociale –ekonomik të viktimave të trafikimit në Shqipëri, Qershor 2009; fq. 34).

Të dhënat e përgjithshme rreth numrit të fëmijëve në ngarkim të vajzave VeT:

Nënat me fëmijë ngarkim	VeT me status nënë	VeT me status divorcuar	Vet me status e martuar	Vet me status e ve	Total
Numri i	19	13	9	1	42

fëmijeve					
Përqindjet	15.7%	10.7%	7.4%	0.8%	34.7%

Pjesa më e madhe e viktimave të trafikimit (65.3 %) nuk kanë fëmijë. Ky rezultat përputhet edhe me ato të studimeve të mëparshme ku 70% e vajzave Vet nuk kanë fëmijë (Studimi mbi riintegrimin socialekonomik të viktimave të trafikimit në Shqipëri, Qershor 2009; fq. 32). Gjatë studimit u evidentua e lartë edhe përqindja e fëmijëve (34.7%) që ishin në ngarkimin e viktimave të trafikimit, qofshin këto VeT me status të divorcuar, të martuar apo vajzë nënë. 34.7 % e Vet rezultoi që kanë fëmijë në ngarkim, nga 1 deri në 3 fëmijë. Të gjithë fëmijët jetonin aktualisht me nënën e tyre viktimë trafikimi.

Të dhënat e përgjithshme rreth arsimimit të vajzave VeT:

Arsimimi	Pa arsim	8-9vjeçar i përfunduar	8-9vjeçar i papërfunduar	I mesëm	I lartë
Rastet	8	64	33	13	3
Përqindjet	6.6 %	52.8%	27.2%	10.7%	2.4%

Nga intervistat rezulton se niveli arsimor mesatar i viktimave të trafikimit është ai 8-9vjeçar i përfunduar, që përbëhet nga 64 raste. Edhe në studimet e realizuara më parë, sërish mbetet përqindja më e lartë e kësaj kategorie, ku 63% rezulton tek studimi i "Të ndryshëm e Të barabartë", (2009) dhe 40 % rezulton tek raporti vjetor i qendrës psikosociale "Vatra" (2007).

4.3.Faktorët që ndikojnë në një riintegrim të suksesshëm të VeT në Shqipëri

Bazuar në intervistat gjysëm të strukturuar me VeT, u konstatua që të gjitha vajzat e intervistuar kishin qenë pjesë e shërbimeve rezidenciale. Nga 121 vajza VeT të intervistuar, 78.5% e rasteve VeT kishin qenë pjesë e shërbimeve disa vite më parë dhe 21.4% prej tyre po përfitonin nga shërbimet e ofruara në qendrat rezidenciale.

Të dhëna në lidhje me intervistat e VeT

VeT	VeT që asistohet aktualisht në strehëz	VeT që janë jashtë shërbimeve të ofruara nga strehëzat
Rastet	26	95
Përqindjet	21.4%	78.5%

Në bazë të intervistave të realizuara me vajzat VeT, shumë prej tyre shprehen se janë ndier të sigurt e me të fuqizuara pas shërbimeve që kanë marrë nga strehëzat.

VeT, Vatra në Vlorë, shprehet: “Ndiehem më e fuqizuar për ta përballuar jetën vetëm falë mbështetjes së vajzave.....” (bëhej fjalë për punonjëset e qendrës Vatra)

“Më kanë ndihmuar shumë shërbimet e marra, përndryshe, nuk e di se ku do të kisha përfunduar....” shprehet VeT, “D&E” në Tiranë.

“I këshilloj vajzat si unë që të bëhen pjesë e shërbimeve, se do t’u vlejë për të ardhmen....”, shprehet VeT “D&E” në Tiranë.

“Stafi më ndihmoi duke më dhënë një sallon parukerie... unë punoj dhe jetoj falë mbështetjes së tyre...” (VeT, Vatra Vlorë)

“Unë nuk mund ta imagjinoj se si jeta ime do të ishte, nëse vajzat nuk do më kishin ndihmuar të lija alkoolin....”, shprehet VeT “Vatra” në Vlorë.

“Unë ndihem më e sigurt, nuk kam më ankth e frikë për jetën time e të fëmijes tim... dhe kjo falë stafit....”, shprehet VeT “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Nëse qendra nuk do të më kishte ndihmuar në atë kohë, ndoshta sot do isha duke u endur rrugëve, e infektuar me sëmundje të ndryshme, e droguar, ndoshta nuk do jetoja më...” (VeT e infektuar me sëmundjen e sifilizit, “Tjetër Vizion” në Elbasan.)

Nga intervistat e realizuara me vajzat VeT del në pah se shërbimet që u janë ofruar nga strehëzat kanë qenë në përputhje të plotë me nevojat e tyre. Ato shprehen se ndiehen më të sigurta pas shërbimeve që kanë marrë e më të forta për ta përballuar jetën e tyre në mënyrë të pavarur.

Bazuar në intervistat e realizuara me vajzat VeT, u vlerësua si i rëndësishëm e fundamental pasqyrimi i komponentëve kryesorë të procesit të riintegrit, duke pëfshirë në këtë mënyrë dhe sfidat kryesore me të cilat përballen viktimat e trafikimit gjatë këtij procesi, si:

- **Punësimi, situata ekonomike e profesionale**

Bazuar në intervistat e realizuara me vajzat viktimat trafikimi (VeT) e me fokus grupet del në pah se, punësimi mbetet faktori kryesor për një riintegrim të suksesshëm të vajzave në shoqëri.

Studimi dëshmon për situatën e vështirë ekonomike e sociale me të cilën përballen vajzat viktimat trafikimi (VeT) në përditshmërinë e tyre dhe ndikimin e madh që kjo situatë ka në realizimin me efikasitet të procesit të riintegrit. Situata tejet e rënduar ekonomike ndikon më shumë në jetën e vajzave viktimat trafikimi.

Një nga sfidat me të cilat viktimat e trafikimit janë përballur e përballen gjatë procesit të riintegrit, mbetet aspekti ekonomik. Mungesa e mbështetjes ekonomike e vështirëson më shumë jetën e vajzave viktimat trafikimi (VeT) gjatë procesit të riintegrit.

- **Strehimi i sigurt dhe i përshtatshëm për to**

Strehimi mbetet një ndër komponentet më fundamentale në procesin e riintegrit të vajzave viktime trafikimi (VeT). Të paturit e një strehimi të sigurt e të përshtatshëm lidhet drejtëpërdrejtë me ndjenjat pozitive që vajzat VeT kanë për veten e tyre e për perceptimin për të ardhmen. Strehimi konsiderohet i rëndësishëm, pasi lidhet me sigurinë e vajzave viktime trafikimi (VeT) si dhe me qëndrueshmërinë e tyre drejt një jetë të pavarur. Në rastet kur viktime VeT nuk e plotëson këtë komponent, shanset që ato të bëhen pjesë sërish e trafikimit, janë më të larta, krahasuar me VeT që e kanë të plotësuar këtë komponent.

- **Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore**

Marrëdhënia me familjen është një komponent shumë i rëndësishëm në procesin e riintegrit dhe, në qoftë se kjo marrëdhënie është e shëndetshme dhe mbështetëse, për viktimën është më e lehtë të riintegrohet në shoqëri. Bazuar në intervistat e realizuara me vajzat viktime trafikimi VeT rezultoi se mbështetja e familjes i ka ndihmuar vajzat viktime trafikimi të jenë më të fuqizuara dhe më të gatshme për të përballuar sfidat e tjera të këtij procesi.

Në qoftë se marrëdhënie midis viktimes dhe familjeve të saj është e ndërlikuar dhe konfliktuale, siç ndodh më shpesh, është shumë e vështirë që viktime ta kalojë gjendjen në të cilën ndodhet, dhe të realizoj me efikasitet procesin e riintegrit.

Studimi dëshmon se marrëdhënia me familjen e origjinës është një komponent shumë i rëndësishëm në procesin e riintegrit dhe, në qoftë se kjo marrëdhënie është e shëndetshme dhe mbështetëse, viktime e ka më të lehtë të riintegrohet në shoqëri.

- **Mirëqenia psikologjike e fizike**

Viktimat e trafikimit e përfitojnë këtë shërbim në strehëzat ku shkojnë ku, përveç shëndetit fizik, ai emocional dhe mendor kanë një peshë të madhe në procesin e riintegrit.

Bazuar në intervistat e realizuara rezulton se 1.6% e vajzave kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor duke mos arritur të jenë pjesë e procesit të riintegritimit për shkak të gjendjes së tyre psikologjike e mendore. Shfrytëzimi i tyre, abuzimi fizik, seksual, psikologjik, detyrimi me forcë për të përdorur drogë dhe alkool, i ka çuar këto vajza të shfaqin probleme të rënda të shëndetit mendor. Vajzat që arrijnë të fitojnë një stabilitet emocional dhe të kenë një mirëqenie fizike e psikologjike të shëndeteshme, mundësitë për t'u riintegruar në shoqëri i kanë më të larta se vajzat, të cilat, traumat apo shqetësimet e tjera që vijnë si pasojë e procesit të trafikimit, nuk arrijnë dot t'i përballojnë. Madje, disa prej tyre përdorin edhe alternativa të tjera, si substanca narkotike apo alkool për ta perballuar sa më lehtë këtë situatë.

Ndërlikimet e shëndetit mendor ndodhin në çdo fazë të trafikimit, si përpara, gjatë tij, apo në periudhën e riintegritimit .Përveç kësaj, VeT përballen me shumë situata të vështira, të cilat kanë ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor. Traumat, vetëfajësimi, ankthi, dhuna fizike, seksuale, shtatëzani të padëshiruara, taktika të kontrollit psikologjik dhe manipulimet emocionale, janë vetëm një pjesë e këtyre përvojave traumatike që VeT përjetojnë.

- **Siguria e vajzave viktima trafikimi**

Pavarësisht se viktimat e trafikut marrin asistencë ligjore nga strehëzat si dhe monitorim të mëpasshëm, përsëri ato ndihen të rrezikuara për arsye se trafikantët janë në gjendje të lirë dhe ato nuk kanë mbrojtje nga shteti. Ky element ndikon drejtpërdrejtë për se drejti që këto vajza viktima trafikimi nuk arrijnë të bëhen pjesë e procesit të riintegritimit. Shteti shqiptar nuk ka hartuar politika sociale për t'i ardhur në ndihmë këtij target grupi.

Studimi dëshmon se pjesa më e madhe vajzave VeT ndihen të sigurta për të jetuar në mënyrë të pavarur sepse kanë informacionin e mjaftueshëm dhe dinë se ku të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Ato ndihen të fuqizuara nga shërbimet që kanë arritur të marrin gjatë kohës që kanë qenë asistuar në strehëz.

- **Edukimi dhe zhvillimi profesional**

Nga studimet dhe nga rezultatet e intervistave del se pjesa më e madhe e vajzave viktime trafikimi (VeT) kanë vetëm arsimin bazë. Ky fakt ja vështirëson atyre jetesën gjatë procesit të riintegrit. Paisja me kurse profesionale gjatë kohës së asistimit në qendra, ka ndihmuar vajzat viktime trafikimi (VeT) në gjetjen e një pune. Kurset apo trainimet profesionale që ofrohen për viktimat e trafikimit nga shërbimet, janë ato si: rrobaqepsi, parukeri, kujdestare fëmijësh, kuzhine, etj. Këto profesione me të cilat paisen vajzat VeT, janë profesione që nuk mundësojnë të ardhura të mjaftueshme në Shqipëri, duke u renditur sektori më pak i paguar. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ajo që do t'u siguronte një të ardhme më të mirë është rifutja në sistemin shkollor, por përsëri ky fakt lidhet me disa faktorë si: mosha aktuale, vitet e ndjekura të shkollës, dëshira dhe vullneti për t'u rikthyer në shkollë, etj.

- **Motivimi për një të ardhme më të mirë e perceptimi për një riintegrim të suksesshëm**

Për riintegrimin e viktimeve në shoqëri kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, si: strehëzat dhe shërbimet e tyre, kombinimi i faktorëve të mbështetjes nga familja me shërbime nga organizata e ndihmës, gjetja e një pune të përshtatshme, besimi në krijimin e një familje, etj.

Më poshtë janë të detajuar në mënyrë të hollësishme të gjitha elementët në bazë të të dhënave të mbledhura nga kërkimi cilësor e që ndikojnë në realizimin me efikasitet të procesit të riintegrit të vajzave viktime trafikimi .

4.3.1. Punësimi, situata ekonomike e profesionale e viktimave të trafikimit

Bazuar në intervistat e realizuara me vajzat viktima trafikimi VeT rezulton se nga 121 raste, 2 raste janë vajza që kanë probleme të rënda të shëndetit mendor. Një vajzë VeT është shtruar aktualisht pranë spitalit psikiatrik “Sadik Dinci”, pasi ka shfaqur probleme serioze të shëndetit mendor, ndërsa vajza tjetër ndodhet në familjen e origjinës, në fshatin Gjergjan të qytetit të Elbasanit.

Të dhënat në lidhje me punësimin e vajzave VeT:

VeT	VeT të punësuara	VeT jo të punësuara
Rastet	75	44
Përqindjet	61.9%	36.3%

Nga intervistat e realizuara me vajzat VeT, 61.9% pohojnë se janë të punësuara në sektorë privatë dhe se 36.3% e vajzave aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune.

VeT të punësuara	VeT të kënaqura me punën e tyre	VeT jo të kënaqura me punën e tyre
Rastet	43	32
Përqindjet	57.3%	42.6%

Opinionet e vajzave në lidhje me punësimin e tyre është në këndvështrime të ndryshme. Në intervistat me vajzat VeT rezulton se 57.3 % e tyre shprehen se ndihen të kënaqura me punën që bëjnë, arsye këto që variojnë, si: të ndierit mirë në ambientet e punës (51.6%), të mosparagjykuarit nga kolegët (37.2%), të pasurit me një biznes personal privat (11.6%) dhe kjo falë ndihmës së donatorëve të ndryshëm që financojnë drejtëpërdrejtë për VeT.

“Puna që unë bëj më bën të ndihem mirë”, shprehet VeT e punësuar në sallon bukurie “Vatra” në Vlorë .

“Ndiehem e kënaqur me punën që bëj, atje kam zënë shoqe të reja dhe ato më mësojnë sesi të qep bukur një fustan...”, shprehet VeT “ D&E” në Tiranë.

“Unë nuk ndihem e paragjykuar në ambientin e punës", shprehet VeT e punësuar në një restorant në pozicionin e ndihmëskuzhinieres, “Tjetër Vizion” në Elbasan.

Gjatë intervistave të realizuara me VeT kishte dhe vajza (42.6%) të cilat u shprehën se nuk ishin të kënaqura me punën që bënin. Kjo gjë vinte si pasojë e mosmotivimit nga ana financiare për punën që VeT bënin paga e ulët (53.1%) ; të ndierit e diskriminuar në ambientin e punës (34.3%) ; mosvendosja e një marrëdhënie të duhur midis punëdhënësit e punëmarresit (12.5%). Disa prej vajzave u shprehën:

“Punoj 10 orë në ditë pa pushim dhe në fund paguhem 120000 lekë të vjetra. Nuk arrij dot të paguaj qeranë dhe jo më të ushqej fëmijët. Do dal të interesohem për një punë tjetër me pagë më të lartë....”, shprehet VeT që punon si sanitare në një lokal të qytetit, “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Kam dy muaj që jam punësuar në një dyqan rrobash dhe pronarja më trajtonte mirë. Dikush i kishte thënë që unë qëndroj në qendër. Që nga ajo ditë ajo kërkon arsye për të më larguar nga puna...”, shprehet VeT e punësuar në një butik, “ Vatra” në Vlorë.

“Pronari im herë sillet mirë me mua,herë më bërtet se u vonova gjysëm ore për në punë. Njerëz jemi dhe ne ...nuk na del gjumi ndonjëhere....pastaj fillon: “bëj këtë punë” ... pa përfunduar punën që unë isha duke bërë,....nuk më le të pi një kafe me shoqet gjatë orarit të punës..... jam mërzitur shumë, do ta lë sapo të gjej një tjetër... shprehet VeT e punësuar si ndihmëskuzhine në një restorant, “ Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Punoja në një pasticeri me orë të zgjatura. Punëdhënësi nuk ishte i rregullt me pagesat mujore. Kishte katër muaj që nuk më paguante për punën që unë bëja. U detyrova ta

denoncoja në polici. Arrita të marr pagesat që meritoja, falë ndihmës së policisë..., shprehet VeT “ Tjetër Vision” në Elbasan.

Bazuar në intervistat e realizuara me vajzat VeT del në pah se pjesa më e madhe e tyre ishin të punësuar në sektorin privat. Nga intervistat e realizuara me VeT asnjëra nuk rezultoi të ishte e punësuar në sektorin shtetëror. Ndër sektorët ku VeT janë më shumë të punësuar, përmendim: barrestorant (banakiere dhe kuzhinierë); rrobaqepsi; parukeri; shitëse në dyqan dhe në mobileri.

Bazuar në intervistat e realizuara me VeT rezultuan se 36.3 % e vajzave nuk ishin të punësuar, për arsye të ndryshme që lidhen direkt apo indirekt me to. Ndër arsyet që u evidentuan gjatë intervistave ishin: kujdesi për fëmijët e vegjël (27.2%), arsye shëndetësore (20.4%), arsye që lidhen me sigurinë e tyre (2.27%), mosgjetja e një punë për shkak të krizës ekonomike (43.1%), plane për t'u punësuar pas përfundimit të kursit profesional që u ofrohet nga sreveza(6.8%). Vajzat shprehen:

“Kam dy javë rrjesht që kërkoj në gjithë qytetin punë e nuk kam gjetur akoma... jam shumë e mërzitur....”, shprehet VeT “ Vatra” në Vlorë.

“Nuk interesohem për punë në këtë kohë... kam vajzën dy muajshe të vogël e nuk kam kush të ma mbajë, as çerdhja nuk e pranon në këtë moshë.... ah sa do të doja të isha në punë, të fitoja një lek për vehten dhe për fëmijët e mi....”, shprehet VeT me dy fëmijë, djalin 4 vjeç e vajzën dy muajshe, “D&E” në Tiranë.

“Më dhemb trupi tërë kohën, kam dhimbje të tmerrshme të kockave...bëj çdo muaj dipenin (ilac për reumatizmën). Nuk kam fuqi të punoj....”, shprehet VeT “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Nuk kam dalë të interesohem për punë, kam shumë frikë (nga tutori) se mos më zhduk....”, shprehet VeT “D&E” në Tiranë.

“Sapo të mbaroj kursin do të punoj në X parukeri. Më pëlqen shumë të punoj atje se është një sallon i madh dhe vijmë shumë njerëz të njohur...”, shprehet VeT “D&E” në Tiranë.

Edhe nga fokusgrupet e realizuar me ofruesit e shërbimeve, edhe nga intervistat gjysëm të strukturuar me VeT, punësimi mbetet faktori kryesor për një riintegrim të suksesshëm të vajzave në shoqëri.

Studimi dëshmon për situatën e vështirë ekonomike e sociale me të cilën përballen vajzat VeT në përditshmërinë e tyre dhe ndikimin e madh që kjo situatë ka në procesin e riintegrit. Situata tejet e rënduar ekonomike ndikon më shumë në jetën e vajzave viktime trafikimi.

Bazuar në studim, del në pah se ka një diferencë midis vajzave të punësuara, 61.9%, me vajzat VeT që rezultuan të papunësuara, 36.3% ende. Të gjitha vajzat VeT, del nga studimi, janë punësuar në sektorin privat dhe se asnjëra nuk ka patur mundësinë të punësohet në sektorin shtetëror. Ky element përputhet edhe me studimet e realizuara më parë, ku pjesa më e madhe e vajzave VeT, 47%, kanë arritur të punësohen, ndërsa 42 % e tyre nuk kanë arritur ende të punësohen (D&E, 2009; Study on the social economic reintegration of victims of trafficking in Albania, fq. 41). Por edhe në studimin e realizuar në vitin 2006 nga organizatat, rezulton se nga 70 VeT të intervistuar, 44,4% e tyre janë punësuar pas largimit nga strehëza dhe 25% e këtyre vajzave kanë arritur të kenë nga dy punë (Studim mbi procesin e riintegrit të ish viktimeve të trafikimit njerëzor; “Të ndryshëm e Të barabartë”, 2006; fq. 14). Studimi gjithashtu dëshmon se vajzat VeT kanë më shumë hapësira punësimi në sektorët më pak të paguar në shoqëri, si në profesionet e parukieres, ndihmëkuzhinieres, rrobaqepses, shitëses në dyqan rrobash, sanitares etj. Studimi dëshmon se 57.3 % e vajzave shprehen se ndihen të kënaqura me punën që bëjnë, arsye këto që variojnë, si: të ndierit mirë në ambientet e punës, të mosparagjykuarit nga kolegët, të pasurit e një biznesi personal privat e familjar dhe kjo falë ndihmës së donatorëve të ndryshëm që financojnë drejtëpërdrejtë për VeT dhe 42.6% vajza VeT shprehen se nuk ishin të kënaqura me punën që ato bënin. Kjo gjë vinte si pasojë e mosmotivimit nga ana

financiare për punën që vajzat bëjnë, si: paga e ulët: të ndierit e diskriminuar në ambientin e punës; mos vendosja e një marrëdhënie të duhur midis punëdhënësit e punëmarrësit. Kështu në studime të tjera theksohet fakti se 93% e vajzave janë të kënaqura me punën që bëjnë, 30% e të cilave nga kushtet e mira në punë; 25 % nga paga e mirë dhe 20 % sepse kanë biznes privat, ndërsa 25 % nuk ndihen të diskriminuara në vendin e punës (D&E; 2009; fq. 41).

Studimi ynë dëshmon se 36.3 % e vajzave VeT nuk ishin të punësuar për arsye të ndryshme. Edhe në studimet e tjera rezulton se 42% e vajzave pohojnë se nuk punojnë. (“Të ndryshëm e të barabartë”, 2009; fq. 40) Edhe nga fokusgrupet e realizuar me ofruesit e shërbimeve, punësimi mbetet faktori kryesor për një riintegrim të sukseshëm të vajzave në shoqëri. Një nga sfidat më të cilat viktimat e trafikimit janë përballur e përballen gjatë procesit të riintegrimit, mbetet aspekti ekonomik. Mungesa e mbështetjes ekonomike e vështirëson më shumë jetën e VeT gjatë procesit të riintegrimit.

4.3.2. Strehimi i sigurt dhe i përshtatshëm i viktimave të trafikimit

Strehimi mbetet një ndër komponentet më fundamentale në procesin e riintegrimit të VeT. Të paturit e një strehimi të sigurt e të përshtatshëm lidhet drejtëpërdrejtë me ndjenjat pozitive që vajzat VeT kanë për veten e tyre e për perceptimin për të ardhmen. Strehimi konsiderohet i rëndësishëm, pasi lidhet me sigurinë e VeT si dhe me qëndrueshmërinë e tyre drejt një jetë të pavarur. Në rastet kur viktimat VeT nuk e plotësojnë këtë komponent, shanset që ato të bëhen pjesë sërish e trafikimit, janë më të larta, krahasuar me VeT që e kanë të plotësuar këtë komponent.

Të dhëna në lidhje me strehimin aktual të vajzave viktimë trafikimi

Strehimi i VeT	VeT të asistuar në	VeT të asistuar në	VeT të rikthyera në	VeT që kanë krijuar	VeT që kanë krijuar	VeT që jetojnë të pavarura në	VeT që asitohen në spital
-----------------------	--------------------	--------------------	---------------------	---------------------	---------------------	-------------------------------	---------------------------

	strehëz	apartam ente autono me të paguara nga strehëz a	familjen e originës	familjet e tyre të reja e që jetojnë në apartament me qera	familjet e tyre të reja e që jetojnë në shtëpinë e partnerit	apartament e me qera	psikiatrik
Rastet	12	14	21	26	3	44	1
Përqindjet	9.9%	11.5%	17.3%	21.4%	2.4%	36.3%	0.8%

Në bazë të intervistave të realizuara me vajzat VeT del në pah se pjesa më e madhe, 36.3% e vajzave, jetojnë të pavarura në shtëpi me qera. Një pjesë e konsiderueshme, 23.8% e vajzave VeT, rezulton të kenë ndërtuar familjen e tyre të re. Gjatë intervistimit, vajzat që bashkëjetojnë apo që kanë arritur të martohen, kanë pohuar se partnerët e tyre nuk janë në dijeni të historisë së kaluar të trafikimit.

Bazuar nga intervistat e realizuara me VeT rezulton se, nëse vajzat viktimë kanë pasur një strehim të sigurt dhe janë mbështetur financiarisht nga strehëza, atëherë e kanë pasur më të lehtë për t'u integruar në shoqëri. Vajzat shprehen:

“Qendra është ajo që më paguan qeranë e shtëpisë, janë mbështetësit e mi më të mëdhenj ...”, shprehet vajza VeT që asistohet në apartament të paguar nga donatorët e strehëzës “D&E” në Tiranë.

“Kam 6 muaj që kam marrë një shtëpi me qera dhe qeranë e ka paguar qendra. Tani që kam një muaj që e paguaj vetë, e shoh që është shumë e vështirë të më dalë rroga. Ishte më mirë kur e paguanin vajzat e qendrës (qesh)....”, shprehet vajza VeT e asistuar më parë në qendrën “Vatra” në Vlorë.

“Jam në një apartament automon që financohet nga strehëza, punoj dhe jetoj e pavarur. Jam e kënaqur, por e di që ndihma e OJF-së do përfundojë dhe do ta kem të vështirë ta përballoj jetën vetë me të ardhurat mujore.... Dëgjoj vajzat e tjera që kanë qenë këtu dhe kanë dalë... Mezi po ja dalin të shkretat, vijnë tek qendra dhe marrin ushqime çdo muaj...”, shprehet vajza VeT që asistohet aktualisht në qendrën “ D&E” në Tiranë.

Bazuar në intervistat me vajzat rezultoi se, kur strehimi i tyre është i papërshtatshëm, ka patur raste kur vajzat kanë rënë sërish pre e trafikimit, duke u ricikluar në shoqëri. Nga intervistat ka rezultuar se 18.1% e vajzave VeT janë ricikluar në shoqëri, duke u bërë sërish pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual. Vajzat VeT kujtojnë momente nga jeta e tyre:

“Pas një kohe 1 vjeçare në qendër, erdhi moment kur duhej të largohesha nga strehëza se i kisha përfutuar të gjitha shërbimet që ofronte qendra. Bashkë me dy fëmijët u vendosëm në një apartament të marrë me qera, ku qeranë e paguaja vetë (70000 në muaj). Unë punoja si ndihmësekuzhiniere në një restorant ku paguhesha 150000 të vjetra në muaj. Nuk po arrija dot të ushqeja fëmijët me bukë. E lashë punën dhe fillova në një bar në periferi të qytetit si kamariere, po me të njëjtën pagë. Pronari i lokalit më premtoi se do të më ndihmonte ekonomikisht. Ai filloi të më sillte klientë dhe unë punoja për të. Në këtë mënyrë iu riktheva sërish profesionit të mëparshëm....”, shprehet vajza VeT, “ Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Pasi kisha qëndruar dy vjet në qendër e kisha marrë shërbimet e qendrës, kisha 7 muaj që punoja në një parukeri dhe kisha mbledhur para për të bërë një jetë të pavarur. Mora një shtëpi me qera 100000 lek të vjetra. Pas dy muaj, nga menaxhimi im i keq, i përfundova lekët që kisha mbledhur në qendër. Më vinte shumë zor të shkoja në qendër dhe t’u thoja punonjëseve që nuk kisha para të paguaja shtëpinë. Tek punëdhënësja nuk kërkoja dot se i kisha marrë borxh 150000 lekë. E ndodhur në këtë situatë, pa lekë, duke më përzënë nga shtëpia, takoj në lokal një djalë, të cilit, pasi i tregoj problemin, ai më premtonte se do më ndihmojë. Më mori me qera një shtëpi superluksoze dhe, pas disa javësh kuptova se po filloja të punoja për të. Punonjëset e qendrës i gënjeja duke u thënë se është i fejuari im.

Nuk kisha rrugë tjetër, duhet të jetoja...”, shprehet vajza VeT, D&E në Tiranë, e cila, pas riciklimit është asistuar tek qendra “Vatra” në Vlorë.

“Punjonjëset e qendrës ishin shumë të mira me mua, por u mërzita duke qëndruar gjithë kohën në qendër me njerëz të tjerë. Nuk po i duroja dot më fëmijët që vinin me nënat e tyre në qendër e kështu vendosa të largohesha nga strehëza. Mora një shtëpi me qera 80000 lekë në muaj. Nuk kisha mundësi të paguaja qeranë muajt e fundit. Dy djem të rinj që vinin shpesh tek lokali ku unë punoja, më ofruan një vend pune në hotel si pastruese. Dyshova për qëllimet e tyre jo të mira dhe kërkova ndihmë tek vajzat e qendrës. Ato më ndihmuan duke më paguar qeranë e shtëpisë...”, shprehet vajza VeT te qendra “Vatra” në Vlorë.

“Puna ku unë punoja u mbyll, qeraxhiu kërkonte qeranë e shtëpisë ku unë po qëndroja, djali im 6 vjecar kishte dy ditë pa bukë, nuk kisha çfarë të bëja, u detyrova të punoja si punonjëse seksi (kështu na thërrasin tani).... të jetoja për djalin dhe për vete. (përlotet)...”, shprehet vajza VeT e “Tjeter vizionit” në Elbasan, që aktualisht asistohet në qendrën “D&E” në Tiranë.

Nga intervistat me VeT del në pah se strehimi i sigurt i vajzave është një element primar i rëndësishëm për procesin e riintegritimit të suksesshëm të tyre në shoqëri.

Studimi dëshmoi se pjesa më e madhe, 36.3% e vajzave jetojnë të pavarura në shtëpi me qera; 23.8 % e vajzave VeT rezulton të kenë ndërtuar familjen e tyre të re. Deri më sot në Shqipëri nuk rezulton asnjë studim që të jetë fokusuar te jeta e vajzave VeT, pas daljes së tyre nga programi i shërbimeve. Studimet e realizuara të “D&E” në 2006 e 2009 dhe raportet e realizuara nga qendra “Vatra” në 2008, fokusohen tek vajzat VeT që janë pjesë e shërbimeve të tyre. Studimi dëshmoi se kur strehimi ishte i paplotësuar, shanset që vajzat VeT të bëheshin sërish pjesë e procesit të riciklimit, ishin të mëdha. Nga studimi rezultoi se 18.1% e vajzave VeT janë ricikluar në shoqëri duke u bërë sërish pjesë e trafikimit të genieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual. Nga intervistat me VeT del në pah se strehimi i sigurt i vajzave është një element primar i rëndësishëm për procesin e riintegritimit të suksesshëm të tyre në shoqëri.

4.3.3 Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore të viktimave të trafikimit

Marrëdhënia me familjen është një komponent shumë i rëndësishëm në procesin e riintegritimit dhe, në qoftë se kjo marrëdhënie është e shëndetshme dhe mbështetëse, për viktimën është më e lehtë të riintegrohet në shoqëri.

Të dhënat e VeT në lidhje me familjen e origjinës

VeT	VeT që mbajnë kontakte me familjen e origjinës	VeT që nuk mbajnë marrëdhënie me familjarët e tyre
Rastet	82	39
Përqindjet	67.7%	32.2%

Bazuar në intervistat e realizuara me VeT rezulton se 67.7% e rasteve të vajzave VeT kanë vendosur dhe mbajnë marrëdhënie të mira me familjen e tyre të origjinës. Këto raste rezultojnë që ato të jenë të riintegruara suksesshëm në shoqëri. Mbështetja e familjes i ka ndihmuar vajzat viktime trafikimi të jenë më të fuqizuara dhe më të gatshme për të përballuar sfidat e tjera të këtij procesi. Disa nga vajzat shprehen pozitivisht në lidhje me marrëdhëniet që kanë me familjarët e tyre:

“Vendosja e kontakteve me nënën dhe rikthimi në shtëpi më shpëtoi nga rruga e keqe. Sot unë vazhdoj shkollën dhe ndjeë pasionet e mia (piktura)...”, shprehet VeT 16 vjeçare te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Gjatë kohëqendrimit në strehëz punonjëset më ndihmuan që të vendosja marrëdhënie me familjarët e mi. Pas daljes nga strehëza ata më pranuan sërish në shtëpi, pavarësisht se ata jetonin në fshat ku ne shihemi ndryshe. Ata më ndihmuan që të krijoja familjen time të re dhe të lë pas të shkuarën time....”, shprehet VeT te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Pas daljes nga organizata unë u riktheva në familjen time. Stafit i qendrës më ndihmoi mua dhe familjen time të krijonim një biznes të vogël, familjar. Sot ne kemi një furrë buke ku punojmë të gjithë së bashku....”, shprehet VeT te “ D&E, në Tiranë.

Bazuar në intervistat e realizuara me VeT rezultoi se 32.2% e vajzave nuk kanë marrëdhënie me familjen e origjinës

VeT	VeT të refuzuara nga familja e origjinës	VeT që nuk dëshirojnë të mbajnë kontakte me familjen e origjinës
Rastet	26	13
Përqindja	66.6%	33.3%

Nga intervistat e realizuara rezultoi se 66.6% e vajzave VeT nuk pranohen nga familja e origjinës, për shkak të historive personale të tyre dhe 33.3% e vajzave rezultojnë se nuk duan vetë të vendosin kontakte me familjen. Vajzat VeT të refuzuara nga familja e origjinës, që përbëjnë dhe përqindjen më të lartë, shprehen se familjarët e tyre nuk i pranojnë për motive të ndryshme si: marrëdhëniet konfliktuale midis anëtarëve të familjes (34.6%), paragjykimet dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqërinë tonë për VeT (42.3%) si dhe mungesa e informacionit nga ana e familjarëve rreth shërbimeve sociale që ofrohen për vajzat (23%) . Vajzat shprehen se:

“Familja ime nuk e pranon dot faktin që unë isha shfrytëzuar dhe që erdha e kërkova ndihmë në qendër. Pavarësisht që stafit bëri përpjekje për të vendosur kontakte me to, ato nuk pranuan e nuk pranojnë edhe sot e kësaj dite kur kanë kaluar tre vjet”, shprehet VeT te “Vatra” në Vlorë.

“Mbam lidhje të fshehta telefonike me nënën time. Me babain dhe vëllain kam pasur gjithmonë konflikte dhe kjo ka qenë arsyeja që unë u largova nga shtëpia dhe u trafikova...”, shprehet VeT te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Familja ime jeton në fshat. Vajzat si unë atje nuk pranohen. As familja ime nuk më pranon...”, shprehet VeT te “D&E” në Tiranë.

Nga intervistat rezultoi se 33.3% e vajzave viktima trafikimi nuk dëshirojnë të mbajnë marrëdhënie me familjen e origjinës. Kjo është një zgjedhje e tyre individuale, për arsye të ndryshme si: incestet familjare (46.1%), prindër me probleme të shëndetit mendor (30.7%), divorce dhe rimartesa brenda familjes (15.3%) , jetesa në zona e në kushte të vështira(7.6%). Vajzat shprehen se:

“Vellai im, kur ishte nën efektin e alkoolit, ka tentuar shpesh herë të kishte me mua marrëdhënie seksuale. Sillte në shtëpi dhe shoket e tij, të cilët tentonin të kishin marrëdhënie me mua....”, shprehet VeT te “Vatra” në Vlorë.

“Ai (njerku) më përdhunoi kur nëna nuk ndodhej në shtëpi. Kur i tregova mamit, ajo nuk më besoi dhe më rrahu. Kërkonte që t’i tregoja se në të vërtetë kisha qenë me një djalë nga fshati. Në atë kohë isha vetëm 10 vjeçe....”, kujton VeT te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

“Nëna ime ishte shumë e mirë, na lante, na krihte, pastronte shtëpinë... nuk vuante nga problemet mendore. Por ishte babai që e bëri të çmendej, sepse e rrihte çdo mbrëmje kur kthehej i dehur. E detyronte të kishte marrëdhënie me të në praninë tonë e për këtë arsye nëna ka dalë disa herë e zhveshur nga shtëpia. E urrej por kam edhe frikë prej tij...”, shprehet VeT te “D&E” në Tiranë.

“Familja ime më detyroi, kur isha 18 vjeçe, të martohesha me atë që më trafikoi e unë nuk kam për t’i falur ndonjëherë...”, shprehet VeT te “D&E” në Tiranë.

Marrëdhënia me familjen është një element tjetër i rëndësishëm për procesin e riintegrit të vajzave në shoqëri. Në qoftë se kjo marrëdhënie është e ndërlikuar dhe konfliktuale, siç ndodh më shpesh, është shumë e vështirë që viktima ta kalojë gjendjen në të cilën ndodhet.

Studimi dëshmon se marrëdhënia me familjen e origjinës është një komponent shumë i rëndësishëm në procesin e riintegrit dhe, në qoftë se kjo marrëdhënie është e

shëndetshme dhe mbështetëse, viktimat e ka më të lehtë të riintegrohet në shoqëri. Gjithashtu në studim del qartë se në 67.7% të rasteve, vajzat VeT kanë vendosur dhe mbajnë marrëdhënie të mira me familjen e tyre të origjinës dhe se vetëm 32.2% e tyre nuk kanë marrëdhënie me familjen e origjinës. Nga studimi rezulton se vajzat VeT që kanë mbështetjen e familjes së origjinës, rezultojnë të jenë të riintegruar suksesshëm në shoqëri. Mbështetja e familjes i ka ndihmuar vajzat viktimat trafikimi të jenë më të fuqizuara dhe më të gatshme për të përballuar sfidat e tjera të këtij procesi. Në studim del në pah se 66.6% e vajzave VeT nuk pranohen nga familja e origjinës për shkak të historisë personale të vajzës, marrëdhënieve konfliktuale midis anëtarëve të familjes, paragjykimet dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqëri për VeT. Në studim rezultoi se 33.3% e vajzave viktimat trafikimi nuk dëshirojnë të mbajnë marrëdhënie me familjen e origjinës. Kjo ishte një zgjedhje e tyre individuale, për motive të ndryshme, si: incestet familjare, prindër me probleme të shëndetit mendor, divorce dhe rimartesa brenda familjes, jetesa në zona të kushteve të vështira.

Në studimet e tjera tregohet se 3.3% e vajzave kanë marrëdhënie të mira me familjarët dhe 11.1% nuk mbajnë asnjë kontakt me familjen e origjinës. Nga ana tjetër, 11.1% e viktimave raportojnë të kenë marrëdhënie konfliktuale. Një familje paqësore ofron më shumë shanse riintegrimit se sa një familje konfliktuale. Këto të fundit e dyfishojnë rrezikun e trafikimit. (“Të ndryshëm e Të barabartë”, 2006; fq. 36)

Edhe pse ky studim nuk fokusohet në analizën e situatës së VeT përpara trafikimit, disa studime kanë nxjerrë në pah fakte të rëndësishme për t’u marrë në konsideratë, teksa analizohen faktorët që ndikojnë në një riintegrim të suksesshëm të VeT. Për shembull, studimi mbi VeT të asistuar në zonën e Ballkanit, nxjerr në pah se 70% e VeT jetonin me familjet e tyre përpara se të rekrutoheshin (IOM, 2001: 50). Nga i njëjti burim rezulton se afërsisht 18% e VeT të asistuar, kanë patur marrëdhënie të vështira, të këqija, madje edhe të dhunshme me anëtarët meshkuj të familjeve të tyre (IOM, 2001: 50). Në këtë kontekst, nga intervistat e realizuara për qëllimin e këtij studimi, autorët deduktojnë se këto cilësi marrëdhëniesh janë “trashëguar” edhe pas kthimit në vendin e origjinës dhe, si rrjedhojë, kanë vështirësuar apo zgjatur periudhën riintegruese të VeT.

4.3.4 Mirëqënia e tyre fizike e psikologjike e vajzave viktimave të trafikimit

Viktimat e trafikimit e përfitojnë këtë shërbim në strehëzat ku shkojnë ku, përveç shëndetit fizik, ai emocional dhe mendor kanë një peshë të madhe në procesin e riintegritit.

Bazuar në intervistat e realizuara rezultoi se 1.6% e vajzave kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor duke mos arritur të jenë pjesë e procesit të riintegritit për shkak të gjendjes së tyre psikologjike e mendore. Shfrytëzimi i tyre, abuzimi fizik, seksual, psikologjik, detyrimi me forcë për të përdorur drogë dhe alkool, i ka çuar këto vajza të shfaqin probleme të rënda të shëndetit mendor. Aktualisht, një vajzë VeT asistohet në spitalin psikiatrik të qytetit të Elbasanit. Ndërsa vajza tjetër qëndron e izoluar në një dhomë në familjen e origjinës dhe familjarët e saj refuzojnë ta trajtojnë atë pranë institucioneve të specializuara për këtë fushë. Kjo, për shkak të mendësisë dhe mentalitetit që ekziston në fshatin Gjergjan të Elbasanit.

Vajzat që arrijnë të fitojnë një stabilitet emocional dhe të kenë një mirëqenie fizike e psikologjike të shëndetshme, mundësitë për t'u riintegruar në shoqëri i kanë më të larta se vajzat, të cilat, traumat apo shqetësimet e tjera që vijnë si pasojë e procesit të trafikimit, nuk arrijnë dot t'i përballojnë. Madje, disa prej tyre përdorin edhe alternativa të tjera, si substanca narkotike apo alkool për ta përballuar sa më lehtë këtë situatë.

Një gjetje tjetër e studimit janë vajzat VeT që shfaqin probleme të shëndetit mendor për shkak të traumave që kanë kaluar në jetën e tyre. Në studimin tonë rezultoi se 1.6% e vajzave kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor duke mos arritur të jenë pjesë e procesit të riintegritit. Kjo problematikë ka rezultuar të jetë prezente edhe në studimet e realizuara më parë. Në këtë kuadër, studimi nxjerr në pah se rreth 5% e VeT shqiptare të rikthyera në Shqipëri dhe të asistuar në strehëz, kanë tentuar vetëvrasjen në periudhën riintegruese në strehëz, madje, disa prej tyre kanë tentuar vetëvrasjen edhe para mbërritjes në të (IOM, 2001: 50). Nga i njëjti burim rezultoi se 7% e VeT të sipërpërmendura janë diagnostikuar

dhe trajtuar për çrregullime të Stresit Posttraumatik. Studime të ndryshme tregojnë se trafikimi shpesh ka një ndikim të thellë në gjendjen shëndetësore dhe mirëqenien e VeT. Format e abuzimit dhe rreziqet që gratë dhe vajzat përjetojnë, përfshijnë: abuzimin fizik, seksual, psikologjik, detyrimin me forcë për të përdorur drogë apo alkool, kufizimet sociale, shfrytëzimin ekonomik, pasigurinë ligjore, kushtet e punës dhe të familjes si dhe rrezikun e të qenit migrante të jashtëligjshme (Zimmerman et al., 2003).

Ndërlikimet e shëndetit mendor ndodhin në çdo fazë të trafikimit, si përpara, gjatë tij, apo në periudhën e riintegrit .Përveç kësaj, VeT përballen me shumë situata të vështira, të cilat kanë ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor. Traumata, vetëfajësimi, ankthi, dhuna fizike, seksuale, shtatëzani të padëshiruara, taktika të kontrollit psikologjik dhe manipulimet emocionale, janë vetëm një pjesë e këtyre përvojave traumatike që VeT përjetojnë. Nga ana tjetër, shumë VeT zgjedhin të përdorin drogat, alkoolin apo duhanin, për ta përballuar sa më mirë situatën e tyre (Raymond dhe Hughes, 2001; Zimmerman et al., 2003). Bazuar në një studim të vitit 2001, pjesa më e madhe e VeT (87%) përdornin drogat dhe alkoolin për ta përballuar sa më lehtë periudhën e trafikimit (Raymond dhe Hughes, 2001).

Dihet se një pjesë e VeT kanë qenë të ekspozuara edhe ndaj seksit të pambrojtur. Përveç të tjerave, kjo nuk është tendencë vetëm e VeT shqiptare. Kështu, bazuar në një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit (2007), trafikimi i qenieve njerëzore shoqërohet me përhapjen e epidemisë së HIV/AIDS-it. I njëjti raport thekson se epidemia e HIV-it në Azi merr përmasa fatale teksa kombinohet edhe me abuzimin me drogat. Përhapja e këtij virusi vdekjeprurës tek gratë dhe vajzat e trafikuar nga Nepali në Indi, është në një masë të konsiderueshme prej 38% (U.S. Department of State, 2007).

4.3.5 Siguria e viktimave të trafikimit

Pavarësisht se viktimat e trafikut marrin asistencë ligjore nga strehëzat si dhe monitorim të mëpasshëm, përsëri ato ndihen të rrezikuara për arsye se trafikantët janë në gjendje të lirë

dhe ato nuk kanë mbrojtje nga shteti. Bazuar në intervistat, rezulton se një vajzë VeT shprehet:

“Nuk ndihem e sigurt për të jetuar në mënyrë të pavarur. Kam frikë se tutorët e mi janë të lirë. Nëse ata më shohim në rrugë, më vrasin...”, shprehet vajza VeT te “Vatra” në Vlorë.

Ky rezultat tregon se këto vajza viktime trafikimi nuk arrijnë të bëhen pjesë e procesit të riintegrit. Shteti shqiptar nuk ka hartuar politika sociale për t’i ardhur në ndihmë këtij targetgrupi. Por, nga studimi rezulton se pjesa më e madhe e vajzave VeT ndihen të sigurta për të jetuar në mënyrë të pavarur, sepse kanë informacionin e mjaftueshëm dhe dinë se ku të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Ato ndihen të fuqizuara nga shërbimet e marra. Vajzat shrehen:

“Falë shërbimeve që kam marrë nga strehëza, tani di se si të mbrohem...”, shprehet vajza VeT te “D&E” në Tiranë.

“Ndhem më e fuqizuar...”, shprehet vajza VeT te “D&E” në Tiranë.

“Kam fituar instrumenta për t’u mbrojtur...”, shprehet vajza VeT te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

Studimi dëshmon se pjesa më e madhe vajzave VeT ndihen të sigurta për të jetuar në mënyrë të pavarur sepse kanë informacionin e mjaftueshëm dhe dinë se ku të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Ato ndihen të fuqizuara nga shërbimet e marra. Nga studimi rezultoi se 97.5 % e vajzave VeT pohojnë se kanë fituar instrumenta dhe dinë të mbrohen nga trafikantët e tyre dhe se 0.8% e vajzave rezultuan se ndihen të rrezikuara nga trafikantët. Nga studimet e tjera rezulton se 26% VeT shprehen se ndihen të rrezikuara, 63% e tyre ndihen të sigurta dhe 11% prej tyre nuk e dinë nëse janë të rrezikuara apo jo. (D&E; 2009; fq. 43)

4.3.6 Edukimi dhe zhvillimi profesional i viktimave të trafikimit

Nga studimet dhe nga rezultatet e intervistave del se pjesa më e madhe e VeT kanë vetëm arsimin bazë. Ky fakt ja vështirëson atyre jetesën gjatë procesit të riintegrit. Pajisa me kurse profesionale gjatë kohës së asistimit në qendra, ka ndihmuar vajzat VeT në gjetjen e një pune. Kurset apo trajnimet profesionale që ofrohen për viktimat e trafikimit nga shërbimet, janë ato si: rrobaqepsi, parukeri, kujdestare fëmijësh, kuzhine, etj. Këto profesione me të cilat paisen vajzat VeT, janë profesione që nuk mundësojnë të ardhura të mjaftueshme në Shqipëri, duke u renditur sektori më pak i paguar. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ajo që do t'u siguronte një të ardhme më të mirë është rifutja në sistemin shkollor, por përsëri ky fakt lidhet me disa faktorë si: mosha aktuale, vitet e ndjekura të shkollës, dëshira dhe vullneti për t'u rikthyer në shkollë, etj. Nje vajze VeT shprehet:

“Unë nuk kam asnjë klasë shkollë, kam marrë dy çertifikata kursi professional.... uroj të më hyjnë në punë....”, shprehet vajza VeT te “Tjetër Vizion” në Elbasan.

Studimi dëshmon se pajisja me kurse profesionale e vajzave të VeT gjatë kohës së asistimit në qendra, i kanë ndihmuar vajzat në gjetjen e një pune. Kështu, rezulton se pjesa më e madhe e VeT, 52.8% kanë vetëm arsimin bazë. Ky fakt ja vështirëson jetesën gjatë procesit të riintegrit. Por janë kurset apo trajnimet profesionale që ofrohen për viktimat e trafikimit nga shërbimet, si: rrobaqepsi, parukeri, kujdestare fëmijësh, kuzhinë, etj. Këto profesione me të cilat paisen vajzat VeT, janë profesione që nuk mundësojnë të ardhura të mjaftueshme në Shqipëri, duke u renditur sektori më pak i paguar. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ajo që do t'u siguronte një të ardhme më të mirë është rifutja në sistemin shkollor, por përsëri ky fakt lidhet me disa faktorë, si mosha aktuale, vitet e ndjekura të shkollës, dëshira dhe vullneti për t'u rikthyer në shkollë etj. (“D&E; 2009; 42)

4.3.7. Perceptimi për një riintegrim të suksesshëm

Për riintegrimin e viktimave në shoqëri kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, si: strehëzat dhe shërbimet e tyre, kombinimi i faktorëve të mbështetjes nga familja me shërbime nga organizata e ndihmës, gjetja e një pune të përshtatshme, besimi në krijimin e një familje, etj.

Pyetjes nëse ndihen të riintegruara në shoqëri, shumica e viktimave i janë përgjigjur Po 65,2% e vajzave VeT. Këtu hyn grupi i VeT, të cilat kanë arritur të përfitojnë sukseshëm nga shërbimet e institucionit ku kanë qenë asistuar. Atje kanë fituar instrumentet bazë për të përballuar sfidat e mëtejshme. Gjithashtu, këtu përfshihet ai grup i VeT, i cili ka kuptuar dhe ka fituar motivimin e nevojshëm për të jetuar një jetë cilësore dhe një të ardhme më të mirë.

KAPITULLI V

DISKUTIME

Përfundimet e studimit treguan se procesi i riintegrit është një proces i gjatë e shumë kompleks. I gjatë, sepse duhen shumë kohë, punë direkt me vajzën e trafikuar që të arrijë të përshtatet me ambientin rrethues ku do të jetojë. Dhe kompleks, pasi pasojat që lë ky fenomen të vajzat e trafikuar, nuk mund të rikuperohen lehtë. Përveç këtyre arritjeve, ky studim mund të konsiderohet si një mundësi e vlerësueshme për të rishikuar dhe analizuar në detaje faktorët e ndryshëm që ndikojnë në realizimin e këtij procesi me efikasitet.

Ky punim është një dritare për të gjithë studiuesit e fushës, lidhur me analizimin e kuadrit ligjor, dimensioneve të mbështetjes sociale dhe aktorëve të ndryshëm që veprojnë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në vendin tonë, duke ofruar për herë të parë një tablo gjithëpërfshirëse të evoluimit të procesit të riintegrit deri në ditët e sotme.

Studimi dëshmon për situatën e vështirë ekonomike e sociale me të cilën përballen vajzat VeT në përditshmërinë e tyre dhe ndikimin e madh që kjo situatë ka në procesin e riintegrit. Situata tejet e rënduar ekonomike ndikon më shumë në jetën e vajzave viktime trafikimi.

Bazuar në studim, del në pah se ka një diferencë midis vajzave të punësuar, 61.9%, me vajzat VeT që rezultuan të papunësuar, 36.3% ende. Të gjitha vajzat VeT, del nga studimi, janë punësuar në sektorin privat dhe se asnjëra nuk ka patur mundësinë të punësohet në sektorin shtetëror. Ky element përputhet edhe me studimet e realizuara më parë, ku pjesa më e madhe e vajzave VeT, 47%, kanë arritur të punësohen, ndërsa 42 % e tyre nuk kanë arritur ende të punësohen (D&E, 2009; Study on the social economic reintegration of victims of trafficking in Albania, fq. 41). Por edhe në studimin e realizuar në vitin 2006 nga organizatat, rezulton se nga 70 VeT të intervistuar, 44,4% e tyre janë punësuar pas largimit nga strehëza dhe 25% e këtyre vajzave kanë arritur të kenë nga dy punë (Studim mbi procesin e riintegrit të ish viktimeve të trafikimit njerëzor; “Të ndryshëm e Të

barabartë”, 2006; fq. 14). Studimi gjithashtu dëshmon se vajzat VeT kanë më shumë hapësira punësimi në sektorët më pak të paguar në shoqëri, si në profesionet e parukieres, ndihmëkuzhinieres, rrobaqepses, shitëses në dyqan rrobash, sanitares etj. Studimi dëshmon se 57.3 % e vajzave shprehen se ndihen të kënaqura me punën që bëjnë, arsye këto që variojnë, si: të ndierit mirë në ambientet e punës, të mosparagjykuarit nga kolegët, të pasurit e një biznesi personal privat e familjar dhe kjo falë ndihmës së donatorëve të ndryshëm që financojnë drejtëpërdrejtë për VeT dhe 42.6% vajza VeT shprehen se nuk ishin të kënaqura me punën që ato bënin. Kjo gjë vinte si pasojë e mosmotivimit nga ana financiare për punën që vajzat bënin, si: paga e ulët: të ndierit e diskriminuar në ambientin e punës; mos vendosja e një marrëdhënie të duhur midis punëdhënësit e punëmarrësit. Kështu në studime të tjera theksohet fakti se 93% e vajzave janë të kënaqura me punën që bëjnë, 30% e të cilave nga kushtet e mira në punë; 25 % nga paga e mirë dhe 20 % sepse kanë biznes privat, ndërsa 25 % nuk ndihen të diskriminuara në vendin e punës (D&E; 2009; fq. 41).

Studimi ynë dëshmon se 36.3 % e vajzave VeT nuk ishin të punësuar për arsye të ndryshme, si: kujdesi për fëmijët e vegjël, arsye shëndetësore, arsye që lidhen me sigurinë e tyre, mosgjetja e një pune për shkakë të krizës ekonomike, plane për t’u punësuar pas përfundimit të kursit profesional që i ofrohet nga srehëza. Edhe në studimet e tjera rezulton se 42% e vajzave pohojnë se nuk punojnë. (“Të ndryshëm e të barabartë”, 2009; fq. 40) Edhe nga fokusgrupet e realizuar me ofruesit e shërbimeve, punësimi mbetet faktori kryesor për një riintegrim të sukseshëm të vajzave në shoqëri. Një nga sfidat më të cilat viktimat e trafikimit janë përballur e përballen gjatë procesit të riintegrit, mbetet aspekti ekonomik. Mungesa e mbështetjes ekonomike e vështirëson më shumë jetën e VeT gjatë procesit të riintegrit.

Studimi tregoi se një faktor shumë i rëndësishëm i procesit të riintegrit ishte strehimi i sigurt i vajzave VeT. Të paturit e një strehimi të përshtatshëm ka një ndërlidhje me ndjenjat pozitive që vajzat VeT kanë për veten e tyre dhe perceptimin optimist që kanë për të ardhmen. Studimi dëshmoi se pjesa më e madhe, 36.3% e vajzave jetojnë të pavarura në shtëpi me qera; 23.8 % e vajzave VeT rezulton të kenë ndërtuar familjen e tyre të re. Deri

më sot në Shqipëri nuk rezulton asnjë studim që të jetë fokusuar te jeta e vajzave VeT, pas daljes së tyre nga programi i shërbimeve. Studimet e realizuara të “D&E” në 2006 e 2009 dhe raportet e realizuara nga qendra “Vatra” në 2008, fokusohen tek vajzat VeT që janë pjesë e shërbimeve të tyre. Studimi dëshmoi se kur strehimi ishte i paplotësuar, shanset që vajzat VeT të bëheshin sërish pjesë e procesit të riciklimit, ishin të mëdha. Nga studimi rezultoi se 18.1% e vajzave VeT janë ricikluar në shoqëri duke u bërë sërish pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual. Nga intervistat me VeT del në pah se strehimi i sigurt i vajzave është një element primar i rëndësishëm për procesin e riintegrit të suksesshëm të tyre në shoqëri.

Studimi dëshmon se marrëdhënia me familjen e origjinës është një komponent shumë i rëndësishëm në procesin e riintegrit dhe, në qoftë se kjo marrëdhënie është e shëndetshme dhe mbështetëse, viktima e ka më të lehtë të riintegrohet në shoqëri. Gjithashtu në studim del qartë se në 67.7% të rasteve, vajzat VeT kanë vendosur dhe mbajnë marrëdhënie të mira me familjen e tyre të origjinës dhe se vetëm 32.2% e tyre nuk kanë marrëdhënie me familjen e origjinës. Nga studimi rezultoi se vajzat VeT që kanë mbështetjen e familjes së origjinës, rezultojnë të jenë të riintegruar suksesshëm në shoqëri. Mbështetja e familjes i ka ndihmuar vajzat viktima trafikimi të jenë më të fuqizuara dhe më të gatshme për të përballuar sfidat e tjera të këtij procesi. Në studim del në pah se 66.6% e vajzave VeT nuk pranohen nga familja e origjinës për shkak të historisë personale të vajzës, marrëdhënieve konfliktuale midis anëtarëve të familjes, paragjykimet dhe stereotipet që ekzistojnë në shoqëri për VeT. Në studim rezultoi se 33.3% e vajzave viktima trafikimi nuk dëshirojnë të mbajnë marrëdhënie me familjen e origjinës. Kjo ishte një zgjedhje e tyre individuale, për motive të ndryshme, si: incestet familjare, prindër me probleme të shëndetit mendor, divorce dhe rimartesa brenda familjes, jetesa në zona e në kushte të vështira.

Në studimet e tjera tregohet se 3.3% e vajzave kanë marrëdhënie të mira me familjarët dhe 11.1% nuk mbajnë asnjë kontakt me familjen e origjinës. Nga ana tjetër, 11.1% e viktimave raportojnë të kenë marrëdhënie konfliktuale. Një familje paqësore ofron më

shumë shanse riintegrimi se sa një familje konfliktuale. Këto të fundit e dyfishojnë rrezikun e trafikimit. (“Të ndryshëm e Të barabartë”, 2006; fq. 36)

Edhe pse ky studim nuk fokusohet në analizën e situatës së VeT përpara trafikimit, disa studime kanë nxjerrë në pah fakte të rëndësishme për t’u marrë në konsideratë, teksa analizohen faktorët që ndikojnë në një riintegrim të suksesshëm të VeT. Për shembull, studimi mbi VeT të asistuar në zonën e Ballkanit, nxjerr në pah se 70% e VeT jetonin me familjet e tyre përpara se të rekrutoheshin (IOM, 2001: 50). Nga i njëjti burim rezulton se afërsisht 18% e VeT të asistuar, kanë patur marrëdhënie të vështira, të këqija, madje edhe të dhunshme me anëtarët meshkuj të familjeve të tyre (IOM, 2001: 50). Në këtë kontekst, nga intervistat e realizuara për qëllimin e këtij studimi, autorët deduktojnë se këto cilësi marrëdhëniesh janë “trashëguar” edhe pas kthimit në vendin e origjinës dhe, si rrjedhojë, kanë vështirësuar apo zgjatur periudhën riintegruese të VeT.

Një gjetje tjetër e studimit janë vajzat VeT që shfaqin probleme të shëndetit mendor për shkak të traumave që kanë kaluar në jetën e tyre. Në studimin tonë rezultoi se 1.6% e vajzave kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor duke mos arritur të jenë pjesë e procesit të riintegrit. Kjo problematikë ka rezultuar të jetë prezente edhe në studimet e realizuara më parë. Në këtë kuadër, studimi nxjerr në pah se rreth 5% e VeT shqiptare të rikthyera në Shqipëri dhe të asistuar në strehëz, kanë tentuar vetëvrasjen në periudhën riintegruese në strehëz, madje, disa prej tyre kanë tentuar vetëvrasjen edhe para mbërritjes në të (IOM, 2001: 50). Nga i njëjti burim rezulton se 7% e VeT të sipërpërmendura janë diagnostikuar dhe trajtuar për çrregullime të Stresit Posttraumatik. Studime të ndryshme tregojnë se trafikimi shpesh ka një ndikim të thellë në gjendjen shëndetësore dhe mirëqenien e VeT. Format e abuzimit dhe rreziqet që gratë dhe vajzat përjetojnë, përfshijnë: abuzimin fizik, seksual, psikologjik, detyrimin me forcë për të përdorur drogë apo alkool, kufizimet sociale, shfrytëzimin ekonomik, pasigurinë ligjore, kushtet e punës dhe të familjes si dhe rrezikun e të qenit migrante të jashtëligjshme (Zimmerman et al., 2003).

Ndërlikimet e shëndetit mendor ndodhin në çdo fazë të trafikimit, si përpara, gjatë tij, apo në periudhën e riintegrit (ibid). Përveç kësaj, VeT përballen me shumë situata të

vështira, të cilat kanë ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor. Traumat, vetëfajësimi, ankthi, dhuna fizike, seksuale, shtatëzani të padëshiruara, taktika të kontrollit psikologjik dhe manipulimet emocionale, janë vetëm një pjesë e këtyre përvojave traumatike që VeT përjetojnë. Nga ana tjetër, shumë VeT zgjedhin të përdorin drogat, alkoolin apo duhanin, për ta përballuar sa më mirë situatën e tyre (Raymond dhe Hughes, 2001; Zimmerman et al., 2003). Bazuar në një studim të vitit 2001, pjesa më e madhe e VeT (87%) përdornin drogat dhe alkoolin për ta përballuar sa më lehtë periudhën e trafikimit (Raymond dhe Hughes, 2001).

Dihet se një pjesë e VeT kanë qenë të ekspozuara edhe ndaj seksit të pambrojtur. Përveç të tjerave, kjo nuk është tendencë vetëm e VeT shqiptare. Kështu, bazuar në një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit (2007), trafikimi i qenieve njerëzore shoqërohet me përhapjen e epidemisë së HIV/AIDS-it. I njëjti raport thekson se epidemia e HIV-it në Azi merr përmasa fatale teksa kombinohet edhe me abuzimin me drogat. Përhapja e këtij virusi vdekjeprurës tek gratë dhe vajzat e trafikuar nga Nepali në Indi, është në një masë të konsiderueshme prej 38% (U.S. Department of State, 2007).

Studimi dëshmon se pjesa më e madhe vajzave VeT ndihen të sigurta për të jetuar në mënyrë të pavarur sepse kanë informacionin e mjaftueshëm dhe dinë se ku të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Ato ndihen të fuqizuara nga shërbimet e marra. Nga studimi rezultoi se 97.5 % e vajzave VeT pohojnë se kanë fituar instrumenta dhe dinë të mbrohen nga trafikantët e tyre dhe se 0.8% e vajzave rezultuan se ndihen të rrezikuara nga trafikantët. Nga studimet e tjera rezulton se 26% VeT shprehen se ndihen të rrezikuara, 63% e tyre ndihen të sigurta dhe 11% prej tyre nuk e dinë nëse janë të rrezikuara apo jo. (D&E; 2009; fq. 43)

Studimi dëshmon se pajisja me kurse profesionale e vajzave të VeT gjatë kohës së asistimit në qendra, i kanë ndihmuar vajzat në gjetjen e një pune. Kështu, rezulton se pjesa më e madhe e VeT, 52.8% kanë vetëm arsimin bazë. Ky fakt ja vështirëson jetesën gjatë procesit të riintegrit. Por janë kurset apo trainimet profesionale që ofrohen për viktimat e trafikimit nga shërbimet, si: rrobaqepsi, parukeri, kujdestare fëmijësh, kuzhinë, etj. Këto

profesione me të cilat paisen vajzat VeT, janë profesione që nuk mundësojnë të ardhura të mjaftueshme në Shqipëri, duke u renditur sektori më pak i paguar. Ky fakt ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme. Ajo që do t'u siguronte një të ardhme më të mirë është rifutja në sistemin shkollor, por përsëri ky fakt lidhet me disa faktorë, si moshë aktuale, vitet e ndjekura të shkollës, dëshira dhe vullneti për t'u rikthyer në shkollë etj. ("D&E; 2009; 42)

KAPITULLI VI

PËRFUNDIME E REKOMANDIME

Përfundimet e studimit treguan se procesi i rinte grimit për vajzat vik tima trafikimi mbetet në tëresine e tij një proces i gjatë për tu realizuar e shumë kompleks, e i ndërlikuar. I gjatë për tu realizuar, sepse duhen shumë kohë punë direkt me vajzën e trafikuar që të arrijë të përshtatet me ambientin rrethues ku do të jetojë. Dhe i ndërlikuar, pasi pasojat që lë ky fenomen te vajzat e trafikuar, nuk mund të rikuperohen lehtë. Përveç këtyre arritjeve, ky studim mund të konsiderohet si një mundësi e vlerësueshme për të rishikuar dhe analizuar në detaje faktorët e ndryshëm që ndikojnë në realizimin e këtij procesi me efikasitet.

Ky punim është një dritare për të gjithë studiuesit e fushës sociale, lidhur me analizimin në mënyrë të detajuar të kuadrit ligjor, dimensioneve të mbështetjes sociale dhe aktorëve të ndryshëm që veprojnë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në vendin tonë, duke ofruar për herë të parë një tablo gjithëpërfshirëse të evoluimit të procesit të riinte grimit deri në ditët e sotme.

Studimi “Vlerësimi i procesit të riinte grimit dhe i nevojave specifike të vik timave të trafikuar në Shqipëri” ofroi një tablo të detajuar lidhur me analizimin e të gjithë komponentëve e faktorëve që ndikojnë në riinte grimin e suksesshëm të vajzave vik tima trafikimi VeT në jetën sociale. Gjetjet hedhin dritë mbi faktorët e rrezikut me të cilat përballen vajzat VeT gjatë realizimit të këtij procesi të gjatë e të ndërlikuar.

Studimi është ndër kërkimet e pakta, i cili përpqet të nxjerrë në pah efikasitetin e politikave të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve sociale nga vendi ynë, për përmirësimin e kushteve të jetesës së vajzave të trafikuar. Ndërsa studimet e mëparshme janë përqendruar në raportimin e raporteve që organizatat nxjerrin në lidhje me numrin e asistimit të vik timave të trafikuar në qendra, me sasinë e kurseve profesionale që u ofrohen, me moshën e tyre, nivelin e edukimit, etj. Ndërsa ky punim raporton dhe teston faktorë rreziku të tjerë, të tillë si riciklimi i vajzave vik tima trafikimi VeT në jetën shoqërore. Përveç

këtyre arritjeve, për herë të parë studimi ynë nxori në pah opinionet e pjesëmarrësve të fokus grupeve lidhur me procesin e riintegritit dhe sfidave me të cilat përballen VeT.

Ky studim arriti të bëjë një prezantim të detajuar të gjithë faktorëve e komponentëve kryesorë të procesit të riintegritit si dhe të sfidave të shumta me të cilat përballen vajzat viktima trafikimi VeT gjatë këtij procesi. Mosrealizimi i këtij procesi me efikasitetin e duhur në shoqërinë tonë lidhet kryesisht me shndërrimet politike, ekonomike e sociale, demografike, familjare e morale të ndodhura në 23-24 vitet e fundit.

Një gjetje e këtij studimi është efikasiteti i strehëzave që ofrojnë paketa të plota shërbimesh cilësore, afatshkurtra e afatgjata, riintegruese në vendin tonë. Paketa e shërbimeve që ofrohen nga strehëzat, aktualisht përmban shërbime, si akomodim, plotësim i nevojave bazë, asistencë mjekësore, ligjore, mbështetje për punësim, ndërmjetësim me familjen e origjinës së VeT, programe pune që krijojnë të ardhura, kurse profesionale, shërbime psikosociale, etj. Të rëndësishme janë konsideruar, si shërbimet bazë që u ofrohen vajzave viktima trafikimi VeT (akomodim, mbështetje ligjore, mjekësore, etj), por edhe shërbimet e mëtejshme që u ofrohen, me synim fuqizimin e tyre në jetën sociale.

Në këtë studim u vlerësua e rëndësishme marrëdhënia e mbështetja që u ofrohet VeT nga familja e origjinës. Shërbimet e ndihmës që u ofrohen vajzave nga organizatat, janë në përputhje të plotë me plotësimin e nevojave të vajzave, por i rëndësishëm është edhe rikuperimi dhe rivendosja e marrëdhënieve të VeT me familjarët e tyre. Ky është një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të procesit të riintegritit. Sa më miqësore të jenë këto marrëdhënie, aq më pozitive shkojnë vajzat VeT drejt këtij procesi. Marrëdhënia pozitive me familjen iu shërben shpesh VeT si motivuese për të ecur përpara në jetën e tyre të pavarur. Në rastet kur familjarët kanë qenë pjesë e procesit të trafikimit të VeT, në këto raste janë vetë vajzat që nuk duan të rivendosin marrëdhënie me ta.

Një gjetje e këtij studimi është vlerësuar dhe vendosja e marrëdhënieve të shëndetshme të vajzave VeT me shoqërinë, si element i rëndësishëm i procesit të riintegritit. Nëse vajzat VeT gjatë procesit të riintegritit kanë arritur të vendosin marrëdhënie pozitive shoqërore me individë të besueshëm, atëherë mundësia e këtyre vajzave për riciklim është shumë herë

më e vogël se vajzat, të cilat nuk arrijnë dot të vendosin marrëdhënie të shëndetshme shoqërore.

Një element i rëndësishëm që favorizon arritjen e suksesshme të procesit të riintegrit varet nga tiparet individuale dhe dëshira e vetë vajzave VeT për të ndryshuar rrjedhën e jetës së tyre. Në studimin tonë u konstatua se rastet VeT që kanë arritur të riintegrohen sukseshëm në jetën sociale kanë pasur dëshirë dhe vullnet të madh për të ndryshuar, pavarësisht shërbimeve ndihmëse që u janë ofruar. U konstatua gjithashtu se, pavarësisht se një vajze VeT i ofrohet një paketë shumë e mirë e shërbimeve riintegruese, nëse dëshira dhe vullneti i vajzës VeT për të përfituar nga këto shërbime mungon, atëherë rezultati i arritur do të jetë minimal.

Ky studim dëshmon se një gjetje e rëndësishme është ofrimi i kurseve profesionale, me qëllim që VeT të kenë lehtësira në gjetjen e një pune në bazë të kursit me të cilin ato janë paisur. Kjo u shërben vajzave si garanci punësimi në të ardhmen. E rëndësishme është të theksohet fakti se kursi profesional i ofruar duhet të jetë në përputhje me dëshirat dhe aftësitë personale të VeT.

Një gjetje e këtij studimi lidhet dhe me arsimin e vajzave. Sa më i lartë të jetë arsimimi i VeT, aq më të lehtë e kanë për ta përballuar procesin e riintegrit. Studimi dëshmoi se VeT që nuk kanë as arsimin bazë, nuk arrijnë dot të përballojnë sfidat e procesit të riintegrit e, si pasojë, bëhen pjesë e procesit të riciklimit.

Një sfidë e vërtetë për ta realizuar me sukses procesin e riintegrit të VeT në shoqëri, mbetet punësimi i tyre. Punësimi është një tregues domethënës i qëndrueshmërisë së saj si individ. Nëse një VeT arrin të gjejë një punë të përshtatshme e të sigurt, ka hapësira më të mëdha për t'u fuqizuar në mënyrë të pavarur. Po jo gjithmonë punësimi që arrin VeT është i mjaftueshem për të përballuar koston e jetës. Këtu i referohemi pagës së ulët, orareve të tejzgjatura e kushteve jo të mira të punës.

Studimi dëshmon se në qoftë se vajzat VeT kanë një banesë të sigurt, një punësim të përshtatshëm, arsimim dhe formim profesional, mbështeten nga familja dhe shoqëria, atëherë ato kanë premisa më të mëdha për ta realizuar me sukses procesin e riintegrit.

REKOMANDIMET

Duke qenë se trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen i ri i periudhës së tranzicionit, ai e gjeti Shqipërinë pa një kuadër ligjor antitrafik për t'u ardhur në ndihmë në mënyrë imediate vajzave të trafikuar. Nga ligji i parë që u hartua për trafikimin në vitin 1995 e deri më sot, vërehet se fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është reduktuar ndjeshëm, por nuk është eliminuar totalisht.

* Duhet të merren masa për të ndëshkuar në mënyrë të drejtë trafikantët dhe për të luftuar krimin e organizuar. Është shumë e rëndësishme që shteti Shqipëtar të zbatojë ligjet dhe strategjitë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë të drejtë që dhe vajza viktimë trafiku të ndihet më e sigurtë në të ardhmen, nëse zbatohet legjislacioni. Nëse zbatohet legjislacioni, i vajzat bëhen më të predispozuar për të denoncuar tutorët e tyre.

* Mendoj se një vajzë e trafikuar do të lehtësohej në një farë mënyre për dëmin e shkaktuar nga trafikantët, sikur të konpesoheshin financiarisht, në mënyrë që nisin një jetë të re e të pavarur dhe ky fakt duhet të ishte i saksonuar në ligj. Një mënyrë e kompesimit të VeT do të ishte që shteti shqiptar t'i konfiskonte pasurinë tutorit trafikant dhe t'ia vinte në funksion të vajzës që ai kishte shfrytëzuar.

* Përmirësimi i parandalimit të trafikimit të vajzave nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive socialekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit të gjërë.

* Garantimi i aksesit për asistencë gjithëpërfshirëse, mbrotje dhe shërbime për të gjitha viktimat e trafikimit, sipas nevojave dhe preferencave të tyre individuale (në strehëza ose në komunitete), pavarësisht dëshirës së tyre për të bashkëpunuar me strukturat e zbatimit të ligjit.

* Forcimi i programeve për dhënien e asistencës afatgjatë, me qëllim riintegrimin dhe përfshirjen shoqërore të vajzave viktime trafikimi, në përputhje me nevojat individuale.

* Garantimi i shërbimeve psikosociale, ligjore, shëndetësore dhe mbështetjes së vazhdueshme të viktimeve të trafikimit për riintegrimin e tyre në jetën sociale, duke përfshirë shërbime për parandalimin e krizave, si lehtësimi i përdorimit të shërbimeve sociale, i ndihmave sociale, strehimi, shpërndarja e informacionit tek grupet dhe personat në nevojë, si dhe aftësimi për jetën.

* Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikim për qëllime shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi i punës, lypja nga fëmijët etj).

* Të garantohet mbikqyrja e vazhdueshme e të gjithë aktorëve kryesore në Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe e masave të marra në vend, si dhe të rritet nxitja e shkëmbimit të informacionit mes të gjitha organizatave partnere, shtetërore dhe joshtetërore.

* Përfshirja sociale e viktimeve të trafikimit, me qëllim uljen e rrezikut për t'u riviktimizuar ose ritrafikuar, ose që të kthehen në tutorë të vajzave të tjera, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së specializuar për riintegrim, të fokusuar tek familja dhe të mbështetur nga komuniteti, në përputhje me standartet e rena dakort.

* Një element i rëndësishëm që ka arritur shteti Shqipëtar deri më sot është përfitimi i ndihmës ekonomike për viktimat e trafikuar. Një nga masat e marra nga shteti për VeT është miratimi i ligjit nr. 904, datë 12.12.2012, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ku, midis përfituesve të ndihmës ekonomike të përfshihen edhe viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore. Kjo ndihmë ekonomike është 3.000 lekë të reja në muaj. Kjo shumë që VeT përfiton është një shumë monetare relativisht e papërfillshme për jetesën në mënyrë të pavarur.

* Shteti shqiptar, nëpërmjet funksionit të bashkive, ka vënë në përdorim ligjin nr.9232, datë 13.05.2004, për përfitim të banesave sociale për familjet me vështirësi socialeekonomike. Pjesë e përfitimit të këtij ligji duhet të jenë dhe vajzat viktime trafikimi, si një ndër kategoritë më vulnerabël të shoqërisë.

* Shteti shqiptar duhet të jetë më i përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke i organizuar institucionet vartëse të tij në zinxhirin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë.

* Shërbimi Social Shtetëror duhet të luajë një rol më të rëndësishëm në identifikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet e tjera që operojnë në luftën kundër trafikimit të qenive njerëzore. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë edhe monitorimin afatgjatë e mbështjetjen e VeT gjatë procesit të riintegritimit.

* Meqenëse punësimi është një element thelbësor në procesin e riintegritimit dhe vështirësia më e madhe qëndron në tregun e punës, është e domosdoshme të ketë një bashkëpunim efektiv të Zyrave Rajonale të Punësimit. Kjo kategori duhet të konsiderohet me prioritet më të lartë.

* Shteti duhet të vlerësojë mundësinë nëpërmjet donatorëve të ndryshëm, si ofrimin e mikrokredive si një alternativë punësimi. Meqenëse punësimi në treg i VeT është i kufizuar dhe pagat janë minimale, ky shërbim do i ndihmonte në një punësim të sigurt me të ardhura më të mëdha.

* Meqenëse nga studimi rezultoi se kishte VeT që kishin hapur mikrobisnese, shteti duhet t'i ndihmojë në uljen e taksave si dhe në lehtësimin e procedurave për bizneset e hapura nga VeT.

* Shteti duhet të rrisë nivelin e interesimit dhe inspektimit në vendet e punës ku janë të punësuar VeT, në mënyrë të tillë që puna e tyre të mos jetë e shfrytëzuar nga punëdhënësi. Ato duhet të trajtohen në bazë të respektimit të Kodit të Punës.

* Në fushën e Arsimit fëmijët e VeT duhet të kenë më shumë lehtësira në trajtimin e tyre. Përveç ofrimit të teksteve shkollore falas, është e nevojshme që mesuesit e shkollave të kenë më shumë njohuri rreth çështjeve që lidhen drejtëpërdrejtë me trafikimin. Pavarësisht faktit se strehëzat kanë ndërmarrë fushata sensibilizuese në shkolla, shteti duhet të angazhohet më shumë nëpërmjet medias apo fushatave shkollore, për të rritur njohuritë tek publiku i gjërë në lidhje me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore.

* VeT duhet të kenë akses në shërbimet shëndetsore. Realisht ekziston ligji ku shërbimet shëndetsore për viktimat e trafikimit janë falas, por shumë punonjës në fushën shëndetsore kanë mungesë në njohjen e ligjit. Shteti duhet të angazhohet më shumë nëpërmjet takimeve, seminareve e tryezave të rrumbullakëta në informimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore lidhur me përfitimin e VeT në skemën e shërbimeve shëndetsore falas.

* Një rekomandim i vlefshëm i ofruesve të shërbimeve kosiston në faktin se puna e tyre organizative duhet të fokusohet në procesin e monitorimit afatgjatë, pasi viktimat e trafikimit është jashtë shërbimit të tyre. Ndhima që organizatat ofrojnë për VeT duhet të jetë e individualizuar në bazë të nevojave të tyre.

* Që shërbimet që ofrohen nga strehëza të jenë në përputhje të plotë me nevojat e vajzave VeT, duhet që këto organizata të kenë mbështetjen financiare, si nga shteti, ashtu dhe nga donatorët e huaj. Në momentin kur ofruesit e shërbimeve nuk mund të ofrojnë shërbime ndihmëse për VeT, për shkak të përfundimit të projekteve, atëherë duhet që shteti të mbështesë financiarisht programet e strehëzave.

* Garantimi i sigurisë fizike të të gjitha viktimave të trafikimit, pavarësisht nëse janë bashkëpunatore me sistemin e drejtësisë.

* Garantimi i mbrojtjes së posaçme për të gjitha viktimat e trafikimit që bashkëpunojnë me drejtësinë gjatë procedimeve penale (mbrojtje përpara séancës gjyqësore, gjatë dhe pas saj, përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut), duke nxitur në këtë mënyrë persona të trafikuar që të bashkëpunojnë me institucionet e zbatimit të ligjit.

* Përmirësimi i bashkëpunimit mes policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të së drejte penale, si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar për raportimin e menaxhimin e informacioneve dhe të dhënave mbi viktimat e trafikimit.

* Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh rajonal dhe ndërkombëtar ligjor, juridik dhe ligjzbatues në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

* Të implementohet me kujdes strategjia e re në Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2014-2017) dhe të ngrihen grupe monitoruese nga institucionet përkatëse në zbatimin e kësaj strategjie.

SHTOJCA

Intervistë (në fokusgrup) për ofruesit e shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit

Përshendetje! Po realizojmë disa intervista mbi situatën aktuale të vajzave të trafikuar në Shqipëri.

Ne ruajmë anonimat e përgjigjeve në këtë vrojtim dhe informacioni është konfidencial. Nuk jeni i/e detyruar të merrni pjesë, nëse nuk dëshironi.

Ne do të dëshironim që ju të shprehnit mendimin tuaj për të gjitha pyetjet, të cilat janë përfshirë në këtë intervistë.

Kjo interviste do të zhvillohet me perfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe me antarët e stafit që ofrojnë shërbime të drejtëpërdrejta për riintegrimin e viktimave të trafikut “Të Ndryshëm & Të Barabartë”; “Vatra” – Vlorë dhe “Tjetër Vizion” – Elbasan.

Informacionet e dhëna gjatë intervistës do të përdoren vetëm për qëllime studimi.

Në rast se keni pyetje, **MOS HEZITONI, BËJENI!**

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri, mbiemri i të intervistuarës _____

1. Vendi i punës. _____

2. Profesion _____

3. Koha që punon në këtë institucion _____

4. Pozicioni _____

II. TË DHËNA MBI SHËRBIMET RIINTEGRUESE TË OFRUARA PËR VeT

1. Sa i përfshirë është institucioni juaj në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ?

2. A vijnë paralelisht programet e riintegritit të ofruara për viktimat e trafikut nga organizata juaj me nevojat specifike të tyre?
3. Cilat janë sfidat me të cilat përballen vajzat e trafikuar gjatë procesit të riintegritit?
4. Çfarë instrumentash janë përdorur nga institucioni juaj për t'i përballuar këto sfida?

III .MASAT E MARRA NGA INSTITUCIONET QEVERTARE PËR RIINTEGRIMIN E VeT

1. Si mendoni e gjykoni: A janë efektive masat e marra nga institucionet qeveritare për riintegritin e viktimave të trafikut ?
2. Nëse jo, cilat janë problemet e konstatuara nga ana juaj?
3. A mund të na jepni disa sygjerime për përmirësimin e programeve të ndihmës që ofrohen për viktimat e trafikuar në Shqipëri?

Faleminderit për bashkëpunimin!

Intervistë për VeT të riintegruara

Ju jeni njëra prej vajzave të përzgjedhura në këtë studim. Informacioni që ju do të jepni do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë situatën reale të vajzave të trafikuar në Shqipëri.

Respektoj vendimin tuaj nëse nuk dëshironi të shkruani emrin në këtë pyetësor. Të gjitha përgjigjet do të ruhen në kushte absolute konfidencialiteti dhe askush nuk do të vihet në dijeni se çfarë ju keni shkruar.

Pyetësori është në formën e intervistave gjysëm të strukturuar. Pyetjet që ju janë bërë lidhen vetëm me situatën tuaj aktuale dhe do të përdoren për të përshkruar profilin e të dhënave të të intervistuarave.

Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve me sinqeritet. Nëse nuk ndiheni mirë të plotësoni ndonjë pyetje, thjesht lëreni pa plotësuar.

Ky pyetësor do të zhvillohet në tre strehëzat që ofrojnë shërbime për riintegrimin e viktimave të trafikut “Të Ndryshëm & Të Barabartë”; “Vatra” – Vlorë dhe “Tjetër Vizion” – Elbasan.

Në rast se keni pyetje, **MOS HEZITONI, BËJENI!**

SEKSIONI I \ GJENERALITETET

1. Moshë:

- a) Nën 15 vjeç
- b) 15 vjeç -20 vjeç
- c) 20vjeç – 25 vjeç
- d) 25 vjeç-30 vjeç
- e) 30 vjeç e lart

2. Vendlindja (specifiko qytetin ose fshatin) : _____

3. Cili është arsimimi juaj:

- a) Nuk kam ndjekur asnjëherë shkollën
- b) Nuk e kam përfunduar arsimin fillor
- c) Kam mbaruar shkollën fillore
- d) Nuk kam përfunduar arsimin 9-vjeçar
- e) Kam përfunduar arsimin 9-vjeçar
- f) Nuk kam përfunduar arsimin e mesëm
- g) Kam përfunduar arsimin e mesëm
- h) Ndjek studimet e larta
- i) Nuk kam përfunduar arsimin e lartë
- j) Kam përfunduar arsimin e lartë
- k) Tjetër

(specifiko)_____

4. Ju i përkisni etnisë:

- a) Egjyptiane
- b) Rome
- c) Shqiptare
- d) Tjetër

(specifiko)_____

5. Gjëndja juaj civile është:

- a) Beqare
- b) E martuar
- c) E divorcuar
- d) E ve
- e) Beqare me fëmijë (vajzë nënë)
- f) Tjetër

(specifiko)_____

6. A keni fëmijë? (Nëse jo, kalo në seksionin e dytë)

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër (specifiko)_____

7. Numri i fëmijëve tuaj është :

- a) 1
- b) 2
- c) 3
- d) 4 ose më shumë (specifiko) _____

8. Ku ndodhet/n aktualisht fëmija(ët) tuaj ?

- a) Me familjen tuaj të re
- b) Me ju
- c) Me babain
- d) Me familjen tënde të origjinës
- e) Me familjen e të atit
- f) Në ndonjë institucion
- f) Tjetër (specifiko)_____

SEKSIONI II \ SHËRBIMET E PËRFITUARA

1. Në cilën strehëz jeni asistuar më parë?
2. Cfarë shërbimesh keni marrë nga institucioni asistues?
3. Sa ju kanë ndihmuar në jetën tuaj shërbimet e përfituara?
4. Ku jetoni aktualisht ?

SEKSIONI III \ PROCESI RIINTEGRIMIT

1. C`farë vështirësish keni hasur në fillimet e procesit të riintegrimit?
2. A jeni të punësuar aktualisht? Nëse jo, kaloni tek pyetja 4.

3. Në ç`sektor përfshihet puna juaj?
4. Si ndieheni në punën që bëni?
5. Cila është arsyeja që nuk punoni?
6. A keni patur mbështetje të mjaftueshme për të përballuar jetesën? (Nëse jo, kaloni tek pyetja 10)
7. Kush kanë qënë mbështetësit tuaj?
8. Si janë sot marrdhëniet tuaja me familjen e origjinës?
9. Arsyeja që nuk mbani kontakte me familjen e origjinës është se...?
10. A ka ndikuar historia juaj (viktimë trafikimi) në fushat kryesore të jetës, gjatë procesit të riintegritit?
11. Si ka ndikuar në procesin e riintegritit historia juaj?
12. A keni hasur rrezikun për t'u ricikluar? Nëse jo, kalo tek pyetja 13.
13. Kur je ndier e rrezikuar për një riciklim të mundshëm?
14. Si ndiheni sot?

Faleminderit për bashkëpunimin!

Intervistë për VeT në proces riintegrimi

Ju jeni njëra prej vajzave të përzgjedhura në këtë studim. Informacioni që ju do të jepni do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë vështirësitë që hasin vajzat e trafikuar gjatë procesit të riintegritimit në Shqipëri.

Respektoj vendimin tuaj nëse nuk dëshironi të shkruani emrin në këtë pyetësor. Të gjitha përgjigjet do të ruhen në kushte absolute konfidencialiteti dhe askush nuk do të vihet në dijeni se çfarë ju keni shkruar.

Pyetësori është në formën e intervistave gjysëm të strukturuar. Pyetjet që ju janë bërë lidhen vetëm me situatën tuaj aktuale dhe do të përdoren për të përshkruar profilin e të dhënave të të intervistuarave.

Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve me sinqeritet. Nëse nuk ndieheni mirë të plotësoni ndonjë pyetje, thjesht lëreni pa plotësuar.

Ky pyetësor do të zhvillohet në tre strehëzat që ofrojnë shërbime për riintegrimin e viktimave të trafikut “Të Ndryshëm & Të Barabartë”; “Vatra” – Vlorë dhe “Tjetër Vizion” – Elbasan.

Në rast se keni pyetje, **MOS HEZITONI, BËJENI!**

SEKSIONI IËI GJENERALITETET

1. Moshë:

- f) Nën 15 vjeç
- g) 15 vjeç -20 vjeç
- h) 20vjeç– 25 vjeç
- i) 25 vjeç-30 vjeç
- j) 30 vjeç e lart

2. Vendlindja (specifiko qytetin ose fshatin) : _____

3. Cili është arsimimi juaj :

- l) Nuk e kam ndjekur asnjëherë shkollën
- m) Nuk e kam përfunduar arsimin fillor

- n) Kam mbaruar shkollën fillore
- o) Nuk kam përfunduar arsimin 9-vjeçar
- p) Kam përfunduar arsimin 9-vjeçar
- q) Nuk kam përfunduar arsimin e mesëm
- r) Kam përfunduar arsimin e mesëm
- s) Ndjek studimet e larta
- t) Nuk kam përfunduar arsimin e lartë
- u) Kam përfunduar arsimin e lartë
- v) Tjetër
(specifiko)_____

4. Ju i përkisni etnisë :

- e) Egjyptiane
- f) Rome
- g) Shqiptare
- h) Tjetër
(specifiko)_____

5. Gjëndja juaj civile është:

- g) Beqare
- h) E martuar
- i) E divorcuar
- j) E ve
- k) Beqare me fëmijë (vajzë nënë)
- l) Tjetër
(specifiko)_____

6. A keni fëmijë? (Nëse jo, kalo në seksionin e dytë)

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër (specifiko)_____

4. Numri i fëmijëve tuaj është :

- a) 1
- b) 2
- c) 3
- d) 4 ose më shumë (specifiko) _____

15. Ku ndodhet/n aktualisht fëmija(ët) tuaj ?

- a) Me familjen tuaj të re

- b) Me ju
- c) Me babain
- d) Me familjen tënde të origjinës
- e) Me familjen e të atit
- f) Në ndonjë institucion
- f) Tjetër (specifiko)_____

SEKSIONI II \ SHËRBIMET E PËRFITUARA

1. Ku asistoheni aktualisht ?
2. Çfarë shërbimesh keni marrë nga institucioni asistues?

SEKSIONI III \ PROCESI RIINTEGRIMIT

1. Cilat janë vështirësitë me të cilat përballeni ju në këtë fazë të procesit të riintegritit?
2. A jeni të punësuar aktualisht? Në ç` sektor përfshihet puna juaj?
3. Si ndieheni në punën që bëni?
4. Cila është arsyeja që nuk punoni?
5. A keni mbështetje të mjaftueshme për të përballuar jetesën? Kush janë mbështetësit tuaj?
6. Si janë sot marrdhëniet tuaja me familjen e origjinës?
7. Arsyeja që nuk mbani kontakte me familjen e origjinës është se ...?
8. A ndikon historia juaj (viktimë trafikimi) në fushat kryesore të jetës, gjatë procesit të riintegritit?
9. Si ndikon në procesin e riintegritit historia juaj?
10. A e hasni rrezikun për t'u ricikluar?

11. Si ndiheni sot?

Faleminderit për bashkëpunimin!

BIBLIOGRAFIA

1. AID 2008. Best Practices in Trafficking Prevention in Europe and Eurasia, NEXUS Institute. U.S.Department of State-Bureau of Public Affairs (2007b).Health consequences of trafficking in persons. Marrë nga : <http://www.state.gov/g/tip/rls/fs/07/91418.htm> US
2. Alia,Ramiz.1986. Raport to the 9-th congress fo the Party of Labour of Albania.Tiranë: 8 Nëntori.
3. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.
4. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Neni 19, Konventa e Kombeve të Bashkura për të Drejtat e Fëmijës, 20 nëntor 1989, ratifikimi nga Parlamenti Shqiptar më 27 shkurt 1992.
5. Bagnall, S.R. 1991. The Prostitution Tax in Roman Egypt. Bull.Am. Soc.Papyr 28, pp. 5-12.
6. Beard, Mary and Henderson, John.1997. Sacret Prostitution in Antiquity. Gender and History, 93, pp. 480-503
7. Benzi, Don Oreste. 2003. Prostitutat do t'ju kalojnë pranë në mbretërinë qiellore. Tiranë. Marin Barleti.
8. Best Practices Trafficking Prevention in Europe and Eurasia, USAID: 2009.
9. Bozo. Aurela. Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar në luftën kundër trafikit të qenieve njerëzore, me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Tiranë, 2008.
10. Brown, P.1990. Plots and Prostitution in Greek New Comedy.Pap.of Leeds Int'I Semminar 6.pp.241-266 1993.
11. Brunovskis, A. & Surtees, R. 2007.Leaving thepost behind? Ehen victims of trafficking decline assistance, Fafo:Norway.
12. Bryan, J. James. 1968. Apprenticeships in Prostitution.Sociology and everyday life. New Jersey: Prentice Hall INC, pp. 257-268.

13. CAAHT, 2008. Situata e Përpjekjeve në Shqipëri për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2007-2008, Tiranë.
14. CAAHT. 2008. Situata e përpjekjeve në Shqipëri për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2007-2008: Tiranë.
15. Çupi, Alma. 2001. Prostitucioni, epidemic pa fund. Gazeta Albania: 18 prill.
16. D&E. 2009. Study on the social economic reintegration of victims of trafficking in Albania
17. David L Morgan, Focus Groups as Qualitative Research, (Sage,1997).
18. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Tiranë: Botim i Qendrës shqiptare të të Drejtave të Njeriut.
19. Drobler, 1991. Rethingin prostitution; Purchasing sex in the 1990s.
20. Edwards, Catharine. 1997. Unspeakable Professions: Public Performance and Prostitution in Ancienr Love and Marriage in Greek New Comedy. CQ 43, PP. 184-205.
21. WHO ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women. London School of Hygiene and Tropical Medicine, London: Daphne Program of the EU. 2003.
22. Ekonomi, M., Gjermani. E., Danaj, E., Lula, E. dhe Beci, L. (2006). Krijimi i mundësive ekonomike për gratë në shqipëri: Një strategji për parandalimin e trafikimit. Tiranë.
23. Gjedia. Robert, Ruth Rasenberg. Ana Bergtsson & Silvana Haxhia. 2005. Trafficking Prevention Training Module for Teachers. Tirana: Iternational Organization.
24. Gjermani, E., Taga, I., Tahsini, I. dhe Meshi, M. Qershor 2008. Doracak i ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim dhe OSBE: Tiranë.
25. H. Islami, A. Hoxha Ilir Panda, Procedura PENALE, Komentar, Tiranë, 2003.
26. Horton B. Paul, Leslie R. Gerald Larson. The Sociology of Social Problems, Neë Jersey: Printice-hall, 1991.

27. Hoxha, Edmond. 2005. Mbi femrat e zhdukura në Shqipëri. Gazeta Metropol, 21 Korrik.
28. IOM. Manuali i IOM-it për ndihmën e drejtëpërdrejtë për viktimat e trafikimit. Tiranë, 2007.
29. IOM. Manualit të trajnimit Aspektet e shëndetit mendor të trafikimit të qenieve njerëzore. IOM, Budapest: 2004.
30. Islami H., Hoxha A., Panda I .,- Komentari i Kodit të Procedurës Penale të RSH, Tiranë Morava 2003.
31. Jane Ritchie Leëis, Qualitative Research Practise: A Guide for Social Science Students and Researchers, Sage, 2003.
32. Këshilli i Evropës, Konventa mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Tiranë, 2006, fq.5 sipas National Review, Janar 2003, <http://nationalreview.com>. Këtë renditje ka bërë sociologu Onnie Eilson (2003).
33. Këshilli i Europës, Konventa mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Tiranë, 2006.
34. Këshilli i Ministrave. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Mars, 2008.
35. Këshilli i Ministrave. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013. 2008.
36. Kodi Civil, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.07.1994.
37. Kodi i Familjes, Ligji nr.9062, datë 08.05.2003.
38. Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr.7905, datë 21.03.1995, ndryshuar me ligjin nr. 8460, datë 11. 02.1999; me ligjin nr.8570, datë 20.01.2000; me ligjin 8602, datë 10.04.2000 dhe ligjin 8813, datë 13.06.2002.
39. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (KPP). Tiranë: Botim i qendrës publike zyrtare.
40. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.27.01.1995, ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10.04.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.01.1998, ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9017, datë 06.03.2003, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004.
41. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.

42. Kuadri Strategjik e Plani Kombëtar i Veprimit (2005-2007).
43. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998.
44. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë, 27.01.1995”. “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë të Ndryshuar”, Fletorja Zyrtare nr.27,2007.
45. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008, “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995.” “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë të Ndryshuar”. Fletorja Zyrtare nr. 10.2008.
46. Legalizimi i prostitucionit u bazua në vendim të Qeverisë nr. 196, datë 10 shkurt. Fletorja zyrtare, nr.30, Gusht 1922, fq.4.
47. Ligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, nr. 9205, datë, 15.03.2004 dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.
48. Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për Ratifikimin e Konvestës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, Fletorja Zyrtare nr. 20, 1996.
49. Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002, Fletore Zyrtare nr. 41, korrik 2002.
50. Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Këshillit të Europës për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.
51. Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 ”Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së, “Për të Drejtat e Fëmijëve, për shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me fëmijë”. Fletorja Zyrtare nr. 165, 2007.
- a. Marrë nga: [http://www.ojp.usdoj.gov/nij/international/programs/sex trafficking us.pdf](http://www.ojp.usdoj.gov/nij/international/programs/sex%20trafficking%20us.pdf)
52. Matthew B. Miles.,A. Michael Huberman, Qualitative Data Analyses: An Expanded Sourcebook, Sage, 1994, botimi II.
53. Matthews, Bob;Ross, Liz.2010. Metodatat e hulumtimit. Tiranë.
54. Meade, Geoff(2015)Re/integration: a road back for trafficking victims, ZOOM
55. Mill. J. Stuart. 2011 Morality as a System of Social Rules.

56. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010.
57. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013.
58. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, të miratuara me VKM 195, datë. 11.04.2007.
59. Ministria e punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Strategjia e shërbimeve Shoqërore 2005-2010.
60. Monteskje, Charl. 2004. Madhështia dhe rënia e romakëve. Tiranë: Fan Noli.
61. Morgan D. L., Focus Group Guidebook. Sage, London, 1998.
62. Morgan, D. L., & Krueger, R. A. (Eds). The focus group kit. Thousand Oaks, CA: Sage. 1998.
63. Morgan D. L., Focus groups as qualitative research. Sage, London, 1997.
64. MPCSSHB, 2007. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013: Tiranë.
65. MPCSSHB, 2007. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013: Tiranë.
66. MPCSSHB, 2008, Standartet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në Qendrat Rezidenciale: Tiranë.
67. Neni 4/e I Ligj nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, “Fletorja Zyrtare nr. 132, 2006.
68. Nursing Times 1990. Into Europë Oct. 24.
69. Organizata “Të ndryshëm & Të barabartë”. 2008. Raport Vjetor 2007: Tiranë.
70. Organizata “Të ndryshëm & Të barabartë”. shtator 2006. Proçesi i riintegritimit. (Studim mbi proçesin e riintegritimit të ish viktimave të trafikimit njerëzor). Tiranë.
71. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin. 2007. Manual i IOM-it: Për ndihmën e drejtëpërdrejtë për viktimat e trafikimit, IOM; Government of Finland, SIDA, Tiranë.
72. OSCE/ODIHR. 2004. National Referral Mechanisms: Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons-a practical handbook, ODIHR: Warsaw.

- 73.** Protokoll “Kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
- 74.** Protokoll “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
- 75.** Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- 76.** Qeveria e Shqipërisë. Strategjia Kombëtare Shqipëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore: Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit. 2005-2007.
- 77.** Raymond, J. G.&Hughes, D.M. (2001). Sex trafficking of women in the United States. International and domestic trends. U.S.A: Coalition against Trafficking in women.
- 78.** Republic of Albania, Ministry of Interior. 2008. Achievements of the Ministry of Interior during the Period 2005-2008, Ministry of Interior, Tiranë.
- 79.** Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme. 2008. Raport vlerësimi për zbatimin e strategjisë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2005-2007, Zyra e koordinorit kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore , Tiranë.
- 80.** Rezoluta nr. 55/25. 15 Nëntor 2000.
- 81.** Richard A. Krueger, Developing Questions for a Focus, Sage, Thousand Oask, CA; 1998.
- 82.** Richard A. Krueger, Moderating Focus Group Kit 4, Moderating FG.
- 83.** Richard A. Krueger, Developing Questions for Focus Groups, Kit 3, Sage, 1997.
- 84.** Rome, in RomanSexuality, edited by Hallett et.al, USA,Princeton: Princeton University Press, pp.66-95.
- 85.** Rush, F.1980.T he best kept secret:Sexual abuse of children.New York: Mc Graw Hill Book Company.

- 86.** ScotW. Vanderstoep, Deirdre D.Johnston, Research Methods for Real Life: Blending Qualitative and Quantitative Approaches, Jossey Bass, San Francisco, 2009.series, Brussels: KBF.
- 87.** Sokoli . Lekë , 2006a Babai dhe vajza e trafikuar/2006. Integrimi dhe morali tradicional.
- 88.** Sokoli. L., Gëdëshi I., -Trafikimi, Rasti i Shqipërisë, Tiranë, 2006.
- 89.** Sokoli. Lekë., 2005b. Prostitucioni profesionist në Shqipëri dhe debatet rreth vlerësimit. Revista “Të drejtat e njeriut”. Nr.2.
- 90.** Somach, S.&R. Surtees. (2005) Anti-Trafficking Programmes in Albania-an Evaluation. Tiranë, Albania: USAID.
- 91.** Strategjisë Kombëtare Shqiptare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2001-2003).
- 92.** Strategjisë Kombëtare Shqipëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2014-2017).
- 93.** Strategjisë Kombëtare të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2008-2010; Ministria e Brendshme, 2008b).
- 94.** Surtees, R. (2007b) Handbook on anti-trafficking data collection in SE Europe: developing regional criteria. ICMPD: Vienna.
- 95.** Surtees, R. (2008 Second Annual Report on Victims of Trafficking in South-Eastern Europe. Geneva: IOM.
- 96.** Surtees, R.&S. Somach (2008) Methods and models for mixing services for victims of domestic violence and trafficking in Europe and Eurasia. Washington: USAID, Creatives Associates, JBS International & NEXUS Institute
- 97.** Surtees, R. (2006a) An Evaluation of Victim Assistance Programmes in SE Europe. Belgium, Brussels: King Baudouin Foundation.
- 98.** Surtees, R. (2008a)Re/integration of trafficking persons-handling “difficult”cases. Brussels: KBF and Vienna: NEXUS Institute.
- 99.** Surtees, R. (2008f) Ehy Shelters? Considering Residential Approaches to Assistance. Vienna & Washington: NEXUS Institute.

100. Surtees, R. (2010) Taking stock. Evaluating KBF's Trafficking Victims Re/integration Programme (TVRP) in the Balkans, 2006 to 2010. KBF and NEXUS Institute.
101. Surtees, Rebeca. 2007. Listen to the victims. Experience of identification, return and assistance in South-Eastern Europe.
102. Surtees,Rebecca (2008) Re/integration of trafficked persons: How can our work be more effective. Issue paper 31. KBF and NEXUS Institute
103. Surtees, Rebecca (2008) Re/integration of trafficked persons: Handling "difficult" cases. Issue paper #2. KBF and NEXUS Institute
104. Surtees, Rebecca (2010)Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual. KBF and NEXUS Institute.
105. Surtees, Rebecca (2012) Re/integration of trafficked persons:Supporting economic empowerment. Issue paper #4. KBF, GIZ and Institute.
106. Surtees, Rebecca (2013) Ethical principles in the re/integration of trafficked persons. Experiences from the Balkans. KBF, GIZ and NEXUS Institute
107. Surtees, Rebecca (2014)Re/integration of trafficked persons:Working with trafficked children and youth. Issue paper #5. KBF, GIZ and NEXUS Institute.
108. Surtees, Rebecca&Fabrice de Kerchove (2014) 'Who Funds Re/integration? Ensuring sustainable services for trafficking victims, Anti-Trafficking Review.
109. Surtees, Rebecca(2009) Re/integration of trafficked persons: Developing monitoring and evaluation mechanisms. Issue paper #3. KBF and NEXUS Institute
110. Surtees, Rebecca(2015) Beyond Trafficking. The re/integration of trafficking victims in the Balkans, 2007 to 2014.KBF and NEXUS Institute.
111. Surtees, Rebecca. 2008. Re/integration of trafficked persons: how can our work be more effective. NEXUS Institute.
112. Surtees, Rebecca. 2008. Re/integration of trafficking persons:how can work be more effective. NEXUS Institute.
113. Thomas McGinn-Prostitution, Sexuality and the Law in Ancient Rome, Oxford University Press, January, 2003

- 114.** UNHCR. (2002) Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking. E/2002/68/Add.1. Neë York: United Nations.
- 115.** United Nations. (2000a) Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons. New York: UN General Assembly.
- 116.** Urdhër i Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005 “Për mënyrën e funksionimit të Njësisë Antitrafik”.
- 117.** Urdhër nr. 782, datë 04.04.2006, i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale “Përtarifat e Sistemit të Formimit Profesional”.
- 118.** Urdhër-shërbim i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 871, datë 27.12.2007, “Mbi procedurat që duhet të kryhen për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera”.
- 119.** USAID Office of Women in Development. (2005) The Rehabilitation of Victims of Trafficking in Group Residential Facilities in Foreign Countries. Washington, DC: USAID.
- 120.** USAID. 2008. Methods and Models for Mixing Services for Victims of Domestic Violence and Trafficking in Persons in Europe & Eurasia, Creative Associates International, Inc.
- 121.** USAID. 2008. The State of Efforts in Albania to Combat Trafficking of Persons 2007-2008, Creative Associates International Inc. Tiranë.
- 122.** Vatra. Raporti Vjetor 2004. Tiranë: “Vatra”, 2005.
- 123.** Vatra. 2008. Raporti Vjetor: Vlorë.
- 124.** Vatra-Qendra Psiko-Sociale. 2002. Vajzat dhe Trafikimi. Vlorë: Vatra.
- 125.** Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 195, datë 11.04.2007, “Për Miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi”.
- 126.** Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 8, datë 05.01.2002, ”Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, ndryshuar në vendimin nr. 8, datë 05.01.2002, “Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, të ndryshuar”.

- 127.** Vendim i Keshillit të Ministrave, nr. 913, datë 19.12.2007, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- 128.** World Health Organization. (2003) Ethical and safety Recommendations for Interviewing Trafficking Women. Geneva: WHO.
- 129.** Zholi, Albert. 2002. Greqia, tregu illegal i prostitutave shqiptare. Gazeta Ballkan: 15 dhjetor.
- 130.** Zimmerman et al.(2003). The health risks and consequences of trafficking in women and adolescents. Findings from a European study. London School of Hygiene & Tropical Medicine (LSHTM).
- 131.** Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. ëë.ë.moi.gov.al/images/pdf/buletini/